

Bashkia Shkodër
Biblioteka “Marin Barleti”

Gegnia
E përkohshme kulturore-artistike

21-2023
Vjeti VIII i botimit,
Shkodër

Gegnia

E përkohshme kulturore-artistike

21-2023

Vjeti i VIII i botimit,

Redaksia:

Ledia Dushi, Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija

Redaktor gjuhësor: Erzen Koperaj

Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër dhe Bibliotekës “Marin Barleti”

ISSN: 2519-73-91

Adresa e redaksisë: Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

info@bibliotekashkoder.com

Shënim: *Pikëpamjet e artikullshkruesve nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

Përmbajtja

▪ Përvjetorë përkujtimorë▪

Skënder **TEMALI** (1946-2021) Vehbi Bala, një zë i veçantë dhe gjithëpërfshirës

Vehbi **BALA** (1923-1990). Dy çaste letrare

Filip **FISHTA** (1904-1973) Leonardo DE MARTINO (1830-1923)

Leonardo **DE MARTINO** Tingëllim. (poezi)

▪ In memoriam▪

Isida **HOXHA** Selami Tabaku, pedagogu dhe studiuesi i letërsisë.....

Spiro **LL. KALEMI** Me Zef Grudën.....

▪Gjuhësi▪

-Ermira **ALIJA** Botohen dy vepra me rëndësi për studimet albanogjike: “Fjalori i gjuhës së Ndre Mjedës” dhe “Rimari i Ndre Mjedës” të Kolë Ashtës.....

-Tefë **TOPALLI** Gjuha poetike në poezitë e Arben Prendit.....

▪Kritikë dhe studime letrare▪

-Arben **PRENDI** Ndërthurja e elementëve komikë dhe tragjikë në dramën e S. Çapalikut.....

-Ermira **ALIJA** Përballja me të shëmtuarën në romanin “Zambaku i kanionit” të E. Bazes.....

-Edon **BUSHAJ** Një vështrim mbi romanin “Korridorët e gjelbra” të Agim Gjakovës.....

▪Letërsi▪

-Nikolin **SH. LËMEZH** Ai më dërgoi. Cikël poetik.....

- Brikena **LAZRI** Recension për librat “Pika vese” dhe “Kur heshtja flet” të N. Sh. Lëmezhit....

- Lorela **SINANI** Sokrat i vëjtun apo derr i kënaqun?.....

▪Tradita familjare shkodrane▪

Zenepe **DIBRA** Familja Bekteshi.....

▪Filateli▪

Besnik **FISHTA** Qarkullimet postare në kampet fashiste gjatë Luftës Dytë Botërore.....

▪ Recension▪

Gjovalin **ÇUNI**. “Gjuhadoli”. Pjesë e randësishme e qytetit të Shkodrës.(bot.II).....

▪Përvjetorë përkujtimorë▪

PROF. DR. VEHBI BALA (1923-1990)



Skënder TEMALI¹

(1946-2021)

VEHBI BALA, NJË ZË I VEÇANTË DHE GJITHËPËRFSHIRËS.

Nuk qenka dhe aq e lehtë të shkruash për një njeri me të cilin ke ndenjur e biseduar kushedi sa herë ndër vite dhe, kur ai është larguar nga kjo botë, e ke kuptuar se nuk e paske arritur ta njohësh. E kam fjalën për Vehbi Balën, njeriun, profesorin, poetin, studiuesin, mbi të gjitha, Njeriun.

Jam njohur me profesor Vehbiun kur unë isha një letrar i ri gjimnazist dhe ai kryetar i degës së lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shkodrës. Që në takimin e parë e kuptova se mbi të gjitha

¹ skendertemali in Blog, Posted November 21, 2017.

ai ishte njeri në kuptimin e vërtetë të fjalës. Ia pata dhënë me ndrojtjen e fillestarit disa poezi që të m’i lexonte dhe të më jepte mendim nëse ia vlenin apo jo për t’i dërguar në ndonjë organ letrar. E takova rastësisht në rrugë, shikoi orën, tha “po” me vete dhe më mori për krahu e më futi diku në një klub të piacës së Shkodrës. Ndoshta tek “Bar imperio”. Impresioni im që po rrija në një kafe me të ishte i madh dhe ai u rrit edhe më shumë kur nisi të flasë për poezitë e mia. Qenë fjalë zemre. Të thjeshta, të qarta, të kuptueshme, inkurajuese. Kisha nevojë për to. I nxori nga çanta dhe m’i ktheu. Aty-këtu kishte bërë ndonjë shënim, ndonjë redaktim.

Thellësinë e thjeshtësinë e një njeriu të mirë nuk e sheh vetëm në një rast. Rast pas rasti jo vetëm unë, por edhe plot vërsnikë të mi krijues, e ndjenin përkujdesjen e tij. Madje, ajo i kalonte edhe kufinj të detyrimit që ai kishte ndaj nesh, si kryetar dege shkrimtarësh që ishte për të mbajtur afër e nxitur talentet e rinj. E ku ta dija unë asokohe se Vehbi Bala, kur kishte punuar në gjimnazin “Asim Zeneli” të Gjirokastrës, si mësues letërsie i sapo diplomuar në Rumani, në rrethin letrar të asaj shkolle kishte afruar nxënësit e tij më të talentuar si Dritëro Agollin, Ismail Kadarenë e të tjerë, që shpejt do të bëheshin zëra të përveçëm të letërsisë shqipe.

Qershor 1964. Takohem me profesorin në shkallët e Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës. “Oh, sa mirë që të pashë, – më thotë. – Urime për hartimin! E lexova tek “Mësuesi”. Të lumtë!”.

Sapo kisha dhënë provimin me shkrim të letërsisë në maturë. Hartimi im qe vlerësuar dhe pas dy ditësh gazeta “Mësuesi” kishte botuar një pjesë të tij.

Por hartimi mund të botohej në gazetën “Mësuesi”, organ i ministrisë së arsimit të kohës dhe të ndodhte absurdi, që të drejtën e studimit për në universitet po kjo ministri të ma nxirrte jo për letërsi, madje as në fakultetin filologjik të Tiranës, por në Ekonomik, edhe pse në shkencat e natyrës si nxënës nuk kisha pasë kurrfarë shkëlqimi, madje isha nxënës nën mesatar.

U trondita sa s’ka! Ngaqë s’kisha miq që të ma ndërronin degën, mora nga shtëpia e profesor Vehbiut. “Si dreqin, – tha me atë ngurrimin që kishte hera-herës në të folur, ndoshta më të theksuar kur diçka nuk shkonte. “Si dreqin e kanë bërë këtë?!”), përsëriti. Më vuri dorën në sup dhe më tha: “Mos u mërzit, do ta rregullojmë, ti do të shkosh të studiosh për letërsi. Nesër nisu në Tiranë. Unë po të jap një letër për zëvendësministrin e arsimit, Bedri Dedjen e do t’ia çosh. Sonte, e shumta deri nesër në mëngjes, pa mbriritë ti në Tiranë, unë do të lidhem në telefon me të...Ai është shkrimtar dhe do të na kuptojë. Ka për të na ndihmuar”.

Ngjarjet ndodhën ashtu siç profesor Vehbiu kishte menduar, shpirti i tij njerëzor e poetik gjeti të njëjtin akord me atë të Bedri Dedjes, një tjetër njeri i mirë i kulturës shqiptare.

Më pas, kontaktet e mia me profesor Vehbiun kanë qenë më të shpeshta, por gjithnjë përmes një respekti të ndërsjellë, aq sa më dukej pak që në 50-vjetorin e ditëlindjes së tij, që ne shkrimtarët e artistët shkodranë ia patëm festuar në shtëpinë e kulturës e të krijimtarisë popullore, unë nuk

diskutova për vlerat e Vehbi Balës si krijues, por recitova një poezi që ia kushtova atij, me titullin “Monologu i Vehbi Balës në 50-vjetorin e lindjes”, të cilën, natyrisht e kam të plotë dhe e kam ruajtur, ashtu siç e kishte ruajtur në kujtesë edhe poeti Visar Zhiti, asokohe student në Shkodër, që ma përmendi kur u takuam pas gati tri dekadash. Po sjell për lexuesit strofën e fundit:

“Eh, çdo desha unë kësaj nate,

Kur dritë e shpirtit zë e flet:

Në çdo hap që të hedh në jetë

Të jem ky që jam: njeri dhe poet!”

Shkodra, në veçanti dhe kultura shqiptare, në përgjithësi, e kanë të fiksuar në memorien e tyre historike figurën komplekse të Vehbi Balës: atë të antifashistit, të poetit me shpirt të ndjeshëm, më shumë lirik se sa epik, të monografit të disa prej figurave më të spikatura të kulturës shqiptare të Rilindjes e të Pavarësisë, të historianit e të studiuesit të letërsisë shqipe, si autor e bashkëautor në shumë tekste mësimore të arsimit të mesëm e të lartë, si një nga themeluesit e arsimit të lartë në Shqipëri, të Institutit të Lartë 2-vjeçar në Tiranë e më pas, më 1957 të Institutit Pedagogjik në Shkodër, duke drejtuar për disa vite katedrën e gjuhës shqipe e të letërsisë tok me emra të tjerë të ndritur të arsimit e të shkencës shqiptare si Jup Kastrati, Kolë Kamsi, Kolë Ashta, Fadil Podgorica, Neki Lezha etj.

Unë, si krijues, e çmoj Vehbi Balën për thjeshtësinë e brishtësinë e ndjenjës poetike që nga vëllimi i parë i tij “Shtigje drite”, botuar në vitin 1946 e deri tek “Përsiatje” e “Vallja e luleve”, e botuar katër dekada pas vëllimit të parë. T’i rezistosh poezisë deri në moshën e tretë, madje poezisë lirike, është shprehje e një shpirti të ndjeshëm, të një bote që ka hapësira rudine me lule gjithfarësh poetike, të një poeti melankolik e vizionar, herë përfaqësues besnik i traditës poetike e herë modern në figuracion.

Kam ndejtë kushedi sa herë me profesor Balën, sidomos kur isha redaktor në Radio Shkodra e në gazetën “Jeta e re”, por asnjëherë nuk ishte mburrur për kontributin që kishte dhënë në shtypin ilegal e sidomos në atë letrar gjatë luftës kundër nazifashistëve, edhe pse mua për profesionin që ushtroja e emisionet e rubrikat që përgatisja tema e episode nga ajo periudhe më interesonin e më kërkoheshin për pasqyrim, ndaj edhe me të drejtë studiuesi i huaj Robert Elsie, në veprën e tij “Historia e letërsisë shqiptare” (fq.327) “ndër shumë poetë para ardhjes në pushtet të komunistëve, krahas Kristaq Cepës, Vedat Kokonës, Petro Markos, etj., rendit edhe Vehbi Balën”.

Tani atë e gjejmë në enciklopeditë e vlerave të mirëfillta, siç është “Fjalori enciklopedik” i vitit 2002 (Shtëpia Botuese “Baechus”, Tiranë, fq.65) e po kështu me foto e tekst edhe tek “Fjalori enciklopedik” i gazetarëve e publicistëve shqiptarë (Botim i Entit Botues “Gjergj Fishta”, 2005).

Mes gjithë botimeve për të vjen e konfigurohet portreti i profesor Balës: që në Gjimnazin e Shtetit në Shkodër ai fillon të shkruaj e të botojë. Nisi studimet e larta në Universitetin e Barit (1943), por i ndërpreu dhe mori pjesë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në vendlindje. Pas luftës, studioi në degën e filozofisë në Universitetin e Zagrebit (1946-48) dhe vijoi e përfundoi studimet në degën e gjuhëve dhe letërsive neolatine në Universitetin e Bukureshtit në vitet 1948-1952.

U shfaq si poet me 8 vëllime. Veçanërisht pati jehonë poezia e tij “Doli nana në çardak”, e përfshirë në mjaft antologji dhe e muzikuar nga Çesk Zadeja. Fëmijët e kohës domosdo nuk kanë se si ta harrojnë për krijimet që u adresoi atyre. Monografitë për Elena Gjikën, Pashko Vasën, Nolin, Migjenin, Viktor Eftimiun e Gjergj Fishtën (kjo e fundit e shkruar në vitin 1961 dhe e botuar pas vdekjes së V. Balës, në vitin 1998). Kontributi i tij spikat edhe në studimin e marrëdhënieve shqiptarorumune e në përkthimet nga letërsia rumune.

Qe me titull profesor, i lauruar me çmimin e Republikës së shkallës së parë, por mbi të gjitha qe njeri i klasit të “zotnive” të Shkodrës. Vënia tani e një rruge të qytetit me emrin “Vehbi Bala” duhet çmuar, edhe pse të një rrugëze, por them se është ende pak për gjurmën e pashlyeshme që ai ka lënë në kulturën shqiptare.

Vehbi BALA

DY ÇASTE LETRARE



I.

Një ditë të vitit 1933, një i ri mësues letrar, vajti dhe u takue në dhomën e punës, me poetin Ndre Mjeda, i cili në atë kohë ishte 67 vjeçar dhe jetonte në Shkodër. Poeti e priti mirë. I riu i paraqiti poetit një përkthim shqip të poezisë së njohun të Xh. Karduçit *Vaj i vjetër (Pianto antico)*. Mjeda e lexoi, e rilexoi, fiku cigaren “Tarabosh” që kishte ndezë më parë dhe i tha përkthyesit të ri, se kishte mujtë me i ndejë besnik origjinalit.

Pastaj, për të dëshmue që mund të bahej një shqipërim më besnik ndaj origjinalit, mori dhe shkroi, aty për aty, me tekstin e Karduçit të mbajtur në mend, këto vargje:

Pema mbi të cillën shtrishë

Doren e njomë një herë,

Shega të tanë jetë e blerë

Hieshëm me lule të kuqe,

Në heshtin të lulishtës se veçueme

Lulzoi persri tash sá;

Qershori vjen pa dá

E vapë e dritë tui i sjellun.

Ti lule e landes s’ême

*Së vrame e perthá nper mote,
Ti e i jetes sé kote
Lulja e mbrame e vetme*

*Jé mbrenda tokës së ngrime
Jé nen dhé të zi si thëngjilli,
Pa té këndellun ma kurr dielli
Pa té zgjue dashtnija kurr ²*

Simbas mendjes sime, ky shqipërim, që po botohet për të parën herë ka mjaft randësi. Poezia origjinale, e sjellun shqip lirisht, do të tingëllonte kështu:

*Pema, sé cilés i shtrije
Dorën e njomë,
Shega e blerëme
Me lule té bukura té kuqe.*

*Në kopështin e heshtun vetmitar
Teksa bleri përséri
Dhe qershori e përtëriu
Me drit e ngrohtësi.*

*Ti, lule e landës sime,
Rrahé e përtha.
Ti, e jetës sé pa dobishme
E mbramja e vetmja lule.*

*Je né tokën e ftohtë,
Je né token e zezë;
As dielli mâ s'té gézon
As të zgjon dashunia*

Në çfarë i ka qëndrue Mjeda besnik origjinalt, dhe në çfarë jo? Nga ana teknike, poeti ynë ka rithanë katër strofat, vargjet shtatërokëshe, rimat e vargjevet të dyta dhe të treta të strofave,

² Sp. Dorëshkrimi të Ndre Mjedës , ruejtë nga Teufik Gjyli.

mendimin, fjalorin, tue shtue vetëm “një herë” (tek vargu i dytë), “të tanë jetë (tek vargu i tretë)” nper mote (tek vargu i dhjetë), “si thëngjilli” (tek vargu i katërbëdhjetë).

Përveç kësaj shtesës së fundit, të tjerat besoj se i kanë dhanë shqipërimin mjaft forcë. Mjeda nuk i asht përmbajtë origjinalit vetëm në rimën e vargut të fundit të çdo strofe (fior, calor, amor, që në shqip janë lule, ngrohtësi, dashuni).

Mund të besohet se poeti ynë, po ta kishte mâ gjatë në dorë shqipërimin e kësaj poezie, do ta kishte nxjerrë mâ të goditun, mirëpo, siç u tha në krye, ai e improvizoi, shqipërimin në fjalë. E, megjithatë, në të shihet dora e një mjeshtri së sprovuem në skalitjen e vargut dhe në punën me shqipërimin. Sç fundi, nuk mund të mos kujtomë këtu edhe poezinë, që lidhet me poezinë e Karduçit, elegjinë *Shegës së kopshtit* të Hilë Mosit, e cila nis me vargjet e njohuna

Pak vjet, o shegë, që t'mbolla

E ti je rritë e shkue...

Em bir me duert e njoma

M'ndihmoi pleh n'rrâjë tue lëshue...

Edhe këtu, shega lulëzon përsëri, ndërsa fëmija kalbet në dhé. Por ndryshe nga origjinali i Karduçit dhe shqipërimi i Mjedës, ka diçka të veçantë, shqiptare, vehtjake, ndonëse ndikimi karduçian asht i qartë në parafytyrën e përgjithshme poetike dhe disa nga mjetet e saja shprehëse.

II.

Në fushën e poezisë shqiptare Mjedja doli ma parë me poemën romantike *Vaji i bylbylit*, më 1887, kur ishte në moshën 21 vjeçare, një vit pas botimit të poemës së Naim Frashërit *Bagëti dhe bujësia*. Vepra e parë poetike e Mjedës sjell shumë çështje për tu diskutue. Një ndër to asht lidhja që ka ajo me vjershën e Leonard de Martinos *Zogu në kafaz t'horiatit*, shkruar në dhjetor të vitit 1878, gjashtë muej pas Lidhjes së Prizrenit dhe frymëzue nga kjo ngjarje e shënueme historike, do me thanë nandë vjet para se ta krijonte Mjedja poemën e vet.

De Martino, në vjershën e përmendun alegorike, e paraqet shqiptarin me figurën e zogut. Shpendi asht i ndrymë në kafaz të horiatit (koprracit). Me horiatin nënkuptohet Turqia. Siç vihet në dukje në *Historinë e letërsisë shqipe*, vëllimi II, f. 227, kemi të bajmë, këtu, me motivin e zogut, që del nga kafazi dhe fiton lirinë në qiellin shqiptar. Pasi trajtohet parafytyra e vuajtjes së zogut në robni, poeti arbëresh e mbyll vjershën me mendimin atdhetar optimist, se zogu shpërthen kafazin dhe merr malet fluturim, i lirë.

Pa dyshim, për krijimin e poemës *Vaji i bylbylit*. Mjeda asht mbështetë tek vjersha në fjalë e L. de Martino-s, qoftë në mbrendinë ideore, qoftë edhe në shtjellimin e përgjithshëm figurativ. De Martino shkruen:

*Çka ke, zog-o që vajton?
-Jam tri vjet si qen i lidhun
Shpirti e zemra më lingon*

*M'apin veç pak ujë e mel,
Mel e ujë me t'vogël masë.
Si një ditë, një tjetër del,
Ma s'po mui, jam kah pëlsas.*

*Dhe Mjeda:
A thue po kjan, se çerdhen
Ta ka shkatrrue skyfteri?
A thue po kjan, o i mjeri,
Se me rrnue gjallë s'kë mal?*

*Ndrronjë edhe stinët e motit,
E për gjith ças ndrron era
Mbas dimnit vjen prendvera
Mbas borës blerimi del.*

Kemi të njajtën trajtë të kuvendimit të poetit me shpendin, pyetje të ngjashme, mendim të përbashkët atdhetar optimist, se, pas robnisë shekullore, do ngadhënjëjë liria e dëshirueme. Por, tek Mjeda, bilbili ka një vështrim ende ma të thellë se zogu i L. de Mortino. Bilbili mishnon, në rend të parë, Shqiptarin e robnueme, të “voglin”, i cili e fiton lirinë tue rrxue “të naltit”.

*Bylbyl, ky shekull orë e ças ndrrohet:
Bijnë poshtë të naltit, i vogli çohet;
Edhe natyra po don m'u ndrrue;
Fillo me gëzue*

Mendimi demokratik, së vegjëlja do të ngadhënjëjë mbi parinë shtypëse, mlekset edhe mendimin se pushteti i “krajlnive të moçme” nuk asht i përjetëshëm dhe se popujt e robnuem do ta fitojnë lirinë e meritueme. Bilbili i Mjedës personifikon, në rend të dytë, vetë poetin, që kërkon qiellin e haptë të atdheut, për të këndue i lirë kangët e zemrës:

*Mbas vajit t'tashëm ke me ardhë shendi,
Ka me ta shëndoshun zemren gazmendi;
Për mall, si motit, zanë ke me e lëshue;*

Fillo me gëzue.

Motivi i zogut, që ka shtegtue në parafytyrën e shumë popujve me anë të letërsisë gojore, asht rrahun nga disa poetë tanë në shenjë. Që heret, motivin e përbashkët të “zogëzës kriezezë” u vu në dukje Dora D’Istria dhe gjikue nga të tjerët si një alegori e trajtueme me një notë të veçantë kthjelltësie. E hasim, përveçse në poezinë tonë gojore, sidomos në parafytyrën burrërore të shqiponjës ase në parafytyrën, e butë të bilbilit, në figurën e zogut të malit tek poema e G. Darës së Ri *Kënga e spasme e Balës*, tek lirika e Serembes, tek i cikli poezive të Shirokës për dallandyshen, tek *Zogëza kryezezë* të L. Gurakuqit etj. Përshtatja e Shirokës *Shko, dallandysh* nga poezia e T. Grosit asht një vazhdë e përshtatjes që i kanë bamë kësaj Serembe dhe L. de Martino (*Vaji i harpës, 1868*). Por secili i dha notën vehtijake përshtatjes, në kushet e vendit dhe në rrethanat e veçanta historike. Siç shihet, pra, *Vaji i bylbylit* i Ndre Mjedës, me paraftyrën e bilbilit të robnuem, që kërkon lirinë, në kuadrin e lëvizjes politiko-kulturore të rilindjes shqiptare kundër sundimit turk dhe shtypjes së egër feudale ban pjesë në qerthullin e përgjithëshëm të motiveve të zogut, motive të trajtueme nga muza popullore dhe nga shumë poetë, sidomos në epokën romantike përparimtare të letërsisë sonë së shkrueme.

▪In memoriam▪

Isida HOXHA

SELAMI TABAKU, PEDAGOGU DHE STUDIUESI I LETËRSISË

“...Ndaj ia vlen të përkujtohet, është detyrë dhe nder për mendimin intelektual shqiptar, në përgjithësi, dhe shkodran, në veçanti, të përkujtohet profesor Sela. Vlen dhe është detyrë, sepse vlen për breznitë që vijnë të njihen dhe shpalosen vlerat jo të vogla të këtij studiuesi të palodhur, pedagogut të devotshëm, intelektualit të kompletuar”³.

I lindur dhe i rritur në një familje shkodrane, ku dashuria dhe përkushtimi për profesionin e mësuesisë ishte e trashëguar, Dr. Selami Tabaku vazhdoi traditën familjare, duke lënë gjurmë me veprimtarinë akademike dhe shkencore në fushën e letërsisë.

Për të kuptuar lidhjen e tij me profesionin e mësuesisë, është e nevojshme të evidentohet se i ati, Musa Tabaku, dha një kontribut të vyer në fushën e arsimit. Ai ishte një ndër mësuesit e parë të shkollave laike të Shkodrës, drejtues në shkollën e Ajasmës, protagonist për përhapjen e arsimit te djemtë dhe vajzat, duke e vlerësuar atë si një ndër elementet më të rëndësishme për përparim. Për kontributin e tij të çmuar, në vitin 1993, Musa Tabaku iu dha titulli “Mësues i Merituar” (Bala, 2011: 81). Dr. Selami Tabaku e njohu pak babain e tij, pasi ai u nda shpejt nga jeta. Nëna e tij ishte një zonjë nga familja Hoxha, e njohur për tregti, por dhe për këngëtarin reformator të këngës popullore shkodrane, Sait Hoxha. Vlerat e trashëguara nga familja, dashuria për arsimin, pasioni për folklorin, ishin bashkëshoqëruese në rrugëtimin e Dr. Selami Tabakut. Ai kreu arsimin fillor dhe të mesëm në Shkodër, më pas vazhdoi studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Filologjisë - Dega e Letërsisë.

Fillimisht u emërua mësues i letërsisë në Shkollën e Mesme Veterinare (1957-1961), drejtor i shkollës Jordan Misja (1961-1964), mësues letërsie në Shkollën e Mesme Pedagogjike (1964-1965), pedagog i jashtëm (1958) në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, që në vitet e para të themelimit të tij dhe që nga viti 1965 deri me 1993 pedagog i brendshëm në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë. Për një periudhë të gjatë kohore profesori ishte anëtar i Këshillit Artistik të Teatrit, duke ndikuar në procesin e përzgjedhjes së veprave që u vendosën në skenën e teatrit “Migjeni”.

Rrugëtimin e tij profesional në auditoret e Universitetit “Luigj Gurakuqi” e ndau me kolegë, profesorë të nderuar, për të cilët Dr. Tabaku në vitin 2005, në Seminarin “Shkodra në Shekuj”, vëllimi I, shprehej në këtë mënyrë: “*Kjo shpreh dhe respektin për të gjithë ata që punuan me zell e pa u*

³ Marrë nga ligjërata e profesor Fadil Krajës në ceremoninë e lamtumirës të Dr. Tabakut.

lodhur për të çuar përpara Universitetin tonë të Shkodrës, që si arsim i lartë mbush 45 vjet. Si një ish-pedagog që nga vitet e para të themelimit të tij, i uroj nga zemra gjithë të mirat". (f. 231)

Gradat shkencore të fituara përgjatë viteve të karrierës së tij konsistojnë në: “Kandidat i shkencave”, “Docent” (dramaturgj) dhe në fillim të viteve ’90 “Doktor i shkencave”.

Në katedrën e letërsisë kontribuoi si pedagog i disa lëndëve: *Letërsi Greko-Romake, Letërsi Ruse, Letërsi e Huaj, Letërsi e Komunës së Parisit*. Më pas u bë titullar i lëndës së *Folklorit* për një periudhë afërsisht 10 vjeçare, deri në vitin 1993, me daljen e tij në pension. Mbyllja e këtij rrugëtimi të gjatë të Dr. Tabakut në auditoret e universitetit, u shoqërua me përfshirjen e një brezi të ri pedagogësh. Një ndër emrat e rinj ishte Entela Tabaku, vajza që përfaqëson denjësisht vazhdimësinë e vlerave të kësaj familjeje në fushën e letërsisë, në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Veprimtaria shkencore

Në aktivitetin shkencor të Dr. Selami Tabakut, përfshihen një sërë artikujsh dhe studimesh, kumtesa, monografi, recensione, redaktime dhe përgatitje e veprave për botim. Gjatë viteve në të cilat ushtroi aktivitetin e tij akademik dhe shkencor botoi në një ndër organet periodike më të rëndësishme të Universitetit të Shkodrës, në “Buletinin Shkencor të Shkencave Shoqërore”, por jo vetëm. Firmën e tij e mbajnë artikuj të botuar në revistën “Skena dhe ekrani”, “Kultura Popullore”, “Studime shqiptare”, “Drita”, Vjetorja “Shkodra”, “Nëntori” etj. Në këtë artikull është gjykuar të mbledhim dhe të kategorizojmë veprimtarinë shkencore, për të evidentuar punën dhe kontributin e këtij studiuesi.

Seminaret “Shkodra në shekuj”

Dr. Selami Tabaku dha një ndihmesë në Muzeun e qytetit, pasi ai ishte studiues i mirëfilltë i folklorit. Dr. Selamiu ishte pjesëmarrës në një ndër aktivitetet shkencore të rëndësishme ndërkombëtare, të organizuar disa herë rradhazi, në seminarin “Shkodra në Shekuj”. Artikujt “Kasem Taipi, mbledhës i njohur i visarit popullor”, “Pasqyrimi i folklorit të trevës së Shkodrës” në “Visaret e Kombit”, “Revistat “Hylli i Dritës”, “Leka” dhe folklori”, si dhe “Fjalori etno-folklorik i Fadil Podgoricës”, një vepër me vlerë në fushën e folkloristikës shqiptare”, janë studime që tregojnë për formimin dhe njohuritë e Dr. Selami Tabakut për folkloristikën tonë, në raport me “mbledhjen, sistemin dhe studimin e veprave të krijimtarisë popullore ku përfshihen veprat e letërsisë gojore, të muzikës, të valleve e të arteve tjera”. (F. Leka, F. Podgorica, S. Hoxha, 1972, f. 73).

Qëllimi i këtyre studimeve ndryshon në varësi të objekteve studimore, mbi treva, folkloristë që meritojnë të zënë vendin e duhur në folkloristikën shqiptare, apo studime mbi organe mediatike të rëndësishme si “Hylli i Dritës” dhe “Leka”, në raport me materialet e botuara, zonat ku u mbledhën, përmbajtjen e tyre dhe autorët që bënë të mundur botimin e kësaj pasurie kombëtare.

Në Seminarin e Dytë Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”, vëllimi II, i vitit 1999, Dr. Tabaku mori pjesë me artikullin “Kasem Taipi, mbledhës i njohur i visarit popullor”, autor i një prej përmbledhjeve folklorike më të shquara të Veriut. Me rëndësi për Dr. Tabakun është evidentimi i aspektit sasior të punës së Kasem Taipit, mbledhja e një mijë këngëve me rreth njëzet e dy mijë vargje, si dhe studimi mbi përmbajtjen e kësaj pasurie folklorike, ku vendin kryesor e zënë këngët lirike të llojeve të ndryshme, të dasmës, të dashurisë, të valleve etj. Në raport me vendin që zë Taipi në folkloristikën shqiptare, Dr. Tabaku thekson: “Si konkluzion mendoj se në planin shkencor kemi të drejtë të themi se Kasem Taipi e meritoi të radhitet denjësisht pranë folkloristëve më të njohur të vendit tonë”. (f. 158)

Në Seminarin e Tretë Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”, vëllimi I, i vitit 2000, Dr. Tabaku mori pjesë me studimin “Pasqyrimi i folklorit të trevës së Shkodrës në “Visaret e Kombit”” (ff. 419—423). Ai shkruan mbi serinë e botimeve “Visaret e Kombit”, të cilat me përjashtim të vëllimit të 12-të, 15-të dhe ndonjë botimi tjetër, pjesa tjetër e serisë përmban folklor kryesisht të veriut. Dr. Tabaku ndalet tek emrat e njohur si Vinçens Prendushi, Zef Jubani, Donat Kurti, Bernadin Palaj, Shtjefën Gjeçovi dhe tek roli i tyre në folkloristikë.

Në Seminarin e Katërt Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”, vëllimi II, i vitit 2003, studiuesi Tabaku ka zgjedhur të studiojë dy nga revistat e njohura të shtypit në Shkodër, “Revistat “Hylli i Dritës”, “Leka” dhe folklori”.

“Historia e botimit të vlerave folklorike në Shqipëri flet se më herët janë botuar këngët lirike dhe këngët e epikës historike. Këto janë më të përhapura, janë ende në proces krijimi të vazhdueshëm... Kështu ka ngjarë edhe në trevën tonë duke filluar në vitet ’70 të shek XIX... Një nga vlerat shumë të rëndësishme të këtyre organeve është botimi i epikës legjendare.. Në mënyrë të veçantë i atyre këngëve që i përkasin ciklit të Mujit e të Halilit.” (f. 217)

Tematikë e rëndësishme e Dr. Tabakut është dhe evidentimi i punës dhe kontributit të figurave të njohura si K. Kamsi, D. Kurti, etj., në mënyrë që të zënë vendin që iu takon në folkloristikë.

Epika legjendare, baladat, vajet, këngët epike historike, proza popullore, si pjesë përbërëse e folklorit shqiptar, ku përfshihen përrallat, legjendat, tregimi popullor, dhe fjalët e urta dhe gjëgjëzat, zënë një vend të madh në këto organe. Fokusimi i Dr. Tabakut te treva folklorike e Shkodrës nuk është një rastësi, sepse përveçse njohës i mirë i saj, një kriter tjetër është rëndësia e kësaj treve në folkloristikën shqiptare. Në artikullin “Mendimi shkencor në trevën folklorike të Shkodrës”, e botuar në “Albanologu i shquar austriak Norbert Jokli”, Studime Shqiptare 12, në vitin 2003, Dr. Selamiu shkruan: “Ky mendim i kësaj treve zë një vend me rëndësi në shkencën folkloristike shqiptare. Këtu një rol të rëndësishëm ka luajtur fakti pse dhe mbledhja, studimi, botimi i vlerave folklorike, ka filluar po në këto vise që në vitin 1871 me përfaqësues të tillë si Zef Jubani” (f. 257).

Në Seminarin e Pestë Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”, vëllimi I, i vitit 2005, Dr. Tabaku në kumtesën “Fjalori etno-folklorik i Fadil Podgoricës”, një vepër me vlerë në fushën e folkloristikës shqiptare”, i bën jehonë rëndësisë që mbart ky fjalor “i pari i llojit në vendin tonë për këtë sferë të kulturës sonë kombëtare”. (ff. 228-231)

Artikujt në faqet e “Buletinit Shkencor të Shkencave Shoqërore”

Në “Buletinin Shkencor të Shkencave Shoqërore”, profesor Tabaku ishte një ndër emrat që publikoi artikuj në mënyrë të vazhdueshme deri në fillim të viteve 1990. Në librin “Bibliografi e artikujve të Buletinit Shkencor” të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” 1964-2004, emri i studiuesit Tabaku shfaqet në rubrikat e klasifikuara nga autorët, si më poshtë:

Pedagogjia, Mësimdhënia, Didaktika (1 artikull)

Teori e letërsisë, Letërsi e huaj (1 artikull)

Letërsia shqipe (5 artikuj)

Kronika (1 artikull, bashkautor)

Pas një analize të kësaj bibliografie, peshën më të madhe në raportin sasior e mbajnë recensionet. Përgjatë viteve të bashkëpunimit të tij me “Buletinin Shkencor të Shkencave Shoqërore”, ai botoi 16 recensione mbi materiale të ndryshme tekstore, duke u shfaqur plot 24 herë si autor në faqet e këtij organi.

Librat studimorë dhe përmbledhës

Tre librat, Kasem Taipi “Këngë popullore shkodrane” (1998), Kolë Gurashi “Shkodra e baballarëve” (2002), “Seit Hoxha Këngëtar i shquar reformator i ahengut shkodran” (2004), përbëjnë një kontribut në folkloristikën shqiptare. Kolë Gurashi njihet si një nga reformatorët kryesorë të këngës popullore shkodrane, ndërsa Kasem Taipi njihet si autor i veprës “Zana Popullore”, e cila është një ndër përmbledhjet më të shquara folklorike të veriut.

Nëse i referohemi metodës së mbledhjes së folklorit mund të pohojmë që “është e nevojshme që pasi të mblidhet teksti, të jepen elemente të gjera informative pranë çdo teksti apo grumbull tekstesh: rreth këngëtarit, virtuozeitetit të tij, kur e ka mësuar tekstin, nga kush, sa vjeç ka qenë ai që ia ka mësuar? Këto të dhëna na japin mundësi të dimë moshën e këngës dhe shtegtimin që ka bërë ajo që nga koha e krijimit” (f. 258). Kasem Taipi dhe Kolë Gurashi shkruajnë se Seit Hoxha i ka ndihmuar shumë në mbledhjen, sistemimin dhe botimin e këngëve popullore shkodrane, prandaj vepra e Selami Tabakut mbi këtë figurë është e rëndësishme. Vështirësitë për të ndriçuar rolin dhe kontributin e Seit Hoxhës, autori Tabaku i evidentoi që në krye të herës: “... Fatkeqësisht ai ka lënë pak gjurmë të shkruara për vete dhe krijimtarinë e tij. Megjithatë hulumtimet nxjerrin në pah shumë

vlera, dhe të japin mundësi për ta zbardhur pak a shumë këtë figurë për ta vendosur në vendin që i takon, në historinë e folklorit qytetar, të këngës popullore shkodrane”. (2004: 14)

“Fjalori etno-folklorik i Fadil Podgoricës”, i pari i këtij lloji në lëmin e shkencave folklorike dhe etnologjike, u redaktua dhe u përgatit për botim nga Dr. Selami Tabaku. Kjo vepër me peshë të veçantë ishte produkt i një pune 30 - vjeçare të profesor Podgoricës, por dhe produkt i një pune të gjatë, serioze dhe të përkushtuar nga profesor Tabaku, i cili shkruan:

“Pasi e mora në dorë veprën, pasi i hodha vështrimin e parë, pashë se kam të bëj jo vetëm me një vepër voluminoze, rreth 1400 faqe, por kishte edhe probleme të tjera, që kërkonin një punë të përkushtuar dhe me përgjegjësi për ta përgatitur për shtyp... Vepra duhej lehtësuar nga elemente jo shkencore, propagandistike, hymnizuese, që kanë gjetur vend pa dëshirën e autorit por që i kërkonte koha... Me sa kam patur mundësi dhe formim shkencor në këtë fushë, jam përpjekur ta ruaj veprën në tërësi, jo vetëm në thelb, por edhe në shtrirje, dhe kam vënë dorë vetëm aty ku kërkohej që vepra të merrte karakter sa më shkencor.” (“Shkodra në Shekuj”, V. I, 2005, ff. 228-231)

Redaktimi i veprës “Mjeda” 1 të Mentor Qukut

Mjedologu, studiuesi, kritiku dhe letrari i shquar Mentor Quku vlerësoi punën e bërë nga miku dhe kolegu i tij Dr. Tabaku. Vlerësimi i Qukut për Tabakun reflektohet në rreshtat e autografit: *Prof. Selami Tabakut, mikut dhe kolegut tim. Në shenjë falenderimi për kontributin e tij të shkëlqyer. Me respekt të veçantë, Mentor Quku. Shkodër, 27.7.2004.*

Literaturë:

F. Leka, F. Podgorica, S. Hoxha, 1972, ”Fjalor shpjegues i termave të letërsisë”, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Sektori i Terminologjisë.

F. Podgorica, 2004, “Fjalor etnofolklorik”, Camaj-Pipa, Shkodër.

M. Hoti, GJ. Çuni, NJ. Kazazi, 2004, “Bibliografi e artikujve të Buletinit Shkencor” të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”1964-2004, ULG, Shkodër.

S. Bala, 2011, “Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës”, V.2, Rozafat, Shkodër.

S. Tabaku, “Fjalori etno-folklorik i Fadil Podgoricës”, një vepër me vlerë në fushën e folkloristikës shqiptare” në Seminari i Pestë Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”, vëllimi I, 2005.

S. Tabaku, “Kasem Taipi, mbledhës i njohur i visarit popullor”, në Seminari i Dytë Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”, vëllimi II, 1999.

S. Tabaku, “Mendimi shkencor në trevën folklorike të Shkodrës”, në “Albanologu i shquar austriak Norbert Jokli”, Studime Shqiptare 12, ULG, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Shkodër 2003.

S. Tabaku, “Pasqyrimi i folklorit të trevës së Shkodrës në “Visaret e Kombit””, në Seminari i Tretë Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”, vëllimi I, 2000.

S. Tabaku, “Revistat “Hylli i Dritës”, “Leka” dhe folklori”, në Seminari i Katërt Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”, vëllimi II, 2003.

S. Tabaku, 2004, “Seit Hoxha Këngëtar i shquar reformator i ahengut shkodran”, Volaj, Shkodër.

K. Taip, 1998, “Këngë popullore shkodrane”, Tiranë.

K. Gurashi, 2002, “Shkodra e baballarëve”, Botime Françeskane, Shkodër.

Spiro LI. KALEMI

ME ZEF GRUDEN

Në mars të vitit 1964, me inisiativen e Ansambilit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve dhe pjesëmarrjen e ansambleve të shumë qyteteve të vendit, në Tiranë u organizua festivali i këngës popullore. Ngjarja kryesore e festivalit, qe koncerti i Shtëpisë së Kulturës të Kukësit, i drejtuar nga Zef Gruda. Në atë koncert, programi i të cilit mbështetej në folklorin tradicional të përpunuar, spikaste roli i orkestrës me vegla të temperuara, e menduar dhe e realizuar nga drejtuesi i saj. Pas një mungese të gjatë, muzikanti i njohur i viteve pesëdhjetë, kthehej në skenën e kryeqytetit si kultivuesi rezultativ i traditës muzikore veriore. Student në konservator, kam qenë dëshmitar i një prej arritjeve më rezultative të atij procesi shumë të debatuar, që kishte vënë temperimin e veglave popullore në qendër të vemendjes të institucioneve artistike dhe të specialistëve, të cilëve u qe besuar realizimi i tij.

* * *

I lindur në Shkodër, më 8 prill të vitit 1926, jetim në moshën 3 vjeç, Zefi kishte njohur herët varfërinë, privacionet e vështirsitë e jetës. Po aq herët kultivoi muzikën e instrumentin. Në moshën 10 vjeç mësoi klarinetën e me moshatarët e tij shkodranë: T. Rrota, T. Harapi, C. Zadeja, S. Gjoni, T. Daija mori pjesë në orkestrën frymore të "Shoqënisë Antoniane", të drejtuar nga Prenkë Jakova. Ajo qe përvoja e parë në ato veprimtari që e çuan Zefin, nga lëvizja amatore, në institucionet profesioniste. Punoi si instrumentist në bandën e qytetit, më pas në orkestrën frymore të ushtrisë në Tiranë e në kuartetin shkodran të radios, drejtuesi i orkestrës së Estradës së Shtetit dhe oboist në orkestren e Filarmonisë Shqiptare. Në vitin 1956, veprimtaria e Zef Grudës ndëprietet papritur. Arrestohet dhe dënohet njikohësisht me shkrimtarë, artistë dhe titullarë të lartë të Partisë e të shtetit, të akuzuar si kundërshtarë politikë dhe armiq të sistemit. Pasi kishte vuajtur më shumë se gjysmën e dënimit, një amnisti i dha mundësi Zef Grudës t'i rikthehet jetës normale dhe veprimtarisë artistike. I emëruar përgjegjës i muzikës në Shtëpinë e Kulturës, në Kukës, ai u mor me organizimin e drejtimin e veprimtarive muzikore të qytetit verior. Pikë kulmore e asaj veprimtarie, qe krijimi i kompleksit kuksian me vegla tradicionale krahinore të temperuara. Vite më parë, një përpjekje e tillë që bërë në Tiranë, në Ansamblin Shtetëror të Këngëve e Valleve Popullore. Me inisiativën e kompozitorit Çesk Zadeja, udhëheqës artistik i Ansambilit, u eksperimentua temperimi i instrumenteve me tela të tipit të çiftelisë. Ndërkohë, në orkester, krahas me veglat e temperuara, luanin edhe klarineta, oboja, dajre, lodra, violina e fizarmonika. Zef Gruda veproi ndryshe. Ai përjashtoi krejtësisht instrumentat "industriale" dhe favorizoi veglat popullore, sepse sipas tij, vetëm ato ishin dëshmi e kulturës rajonale dhe si të tilla përfaqësonin traditën kuksiane. Me këtë synim iu përvesh krijimit të kompleksit

instrumental krahinor, që u konkretizua me temperimin e disa veglave me tela, me frymë e me perkusion. Sipas informacionit të dhënë nga vetë Zefi (dorëshkrim i ruajtur nga familjarët), ai mori si model familjen e harqeve të orkestres simfonike (me pikë referimi edhe regjistrat e zëreve të korit). Shkruan Zefi: “..Nga çiftelia, nxora katër regjistra tingëllues. Çiftelinë e vogël që i përgjigjet regjistrin të violinës (soprano), çiftelinë e madhe në regjistrin e violës (tenor, bariton), sharkinë, një tjetër tip çiftelie me funksion kryesisht shoqërues, në regjistrin e violinçelit dhe së fundi, çiftelinë bas. Kështu, plotësova familjen e veglave me tela". Ndër to, shtrirjen më të madhe e kishte çiftelia e vogël, e quajtur nga krijuesi i saj "çiftelina". Ky instrument ishte i pajisur me katër tela të ndarë në dy grupe, me një shtrirje që niste nga nota "do" e oktavës së parë dhe arrinte në notën "re" të oktavës së tretë. Me përjashtim të intervalit të parë prej një toni, të tetëmbëdhjetë nëndarjet (apo perde si i quante populli) e tastierës së çiftelisës, ishin në largësinë e semitonit. Mbështetëse për familjen e veglave me tela e njëkohësisht për tërë kompleksin instrumental të ideuar nga Zef Gruda, ishte çiftelia bas e emertuar nga ai "basi çift". Shtrirja e këtij instrumenti që e kufizuar dhe niste nga nota "do" e oktavës së parë dhe përfundonte në notën "re" të oktavës së dytë. Prandaj në orkester ai luante kryesisht rolin e pedalit harmonik. Po aq vemendje Zefi i kushtoi temperimit të atyre instrumenteve të frymës, që në traditën kuksiane kishin përparësi. Tingëllues e të fuqishëm, ato jo vetëm pasuronin timbrikën e kompleksit instrumental, por luanin edhe rolin e solistit në orkestracionin, që tashmë po ravijëzohej në mendjen e tij.

"..Më kishin mbetur dy vegla aerofone për t'u stilizuar, fyelli dhe cyrlja. Kjo e dyta më mundi së tepërmi, ngaqë më mungonin mjetet që më duheshin për punimin e tyre..." shenon autori.

Në rolin e prodhuesit artizan të veglave muzikore, Zef Gruda iu kthye mjeteve primitive me të cilat paraardhësit vendas kishin punuar. Sipas rastit e nevojës përdori hekurin e skuqur, telat gozhdat. Ashtu ishin punuar dikur veglat që ai kishte gjetur në Kukës, ashtu e realizoi edhe ai atë proces. Rezultati që i paparashikueshëm e befasues. Nga mendja e Zef Grudës dhe nga duart e mjeshtrit vendas, që vuri në jetë udhëzimet e tij, u përgatitën tërë veglat me tela, me frymë e me perkusion të formacionit instrumental kuksian, që u prezantua në skenën e kryeqytetit për herë të parë.

Inisiativa e Zef Grudës ngjalli habi e admirim. Veglat e temperuara tingëllonin mirë, madje shumë ma mirë se çdo vegël tjetër e temperuar që ishte prodhuar deri në atë kohë. Falë edhe orkestracionit e përpunimit të bërë me shumë shije nga ai vetë⁴, tingulli dhe timbri i instrumentave

⁴ Zef Gruda bëri përpunimet muzikore: 1. suitë vallesh lumjane 2. suitë vallesh kosovare 3. More djalë jezit (petrit) 4. Buçetë këngësh lumjane 5. Lut e lut ashikun 6. Mori cuc me mafes të saritë 7. Do të dal në stan 8. Na u shemb tufa 9. Cen Maxhunit 10. Bajram Curri i ri 11. Ç'ka po duhet mëndili (kosovare). 12. Prej Podrimje na vjen haberi 3. Kënga e Skernderbegut (kosovare). 14 Të fala katundi (arbreshe). Ka mbledhur dhe transkriptuar këngë e valle të folklorit kuksian me titull: "Ushton Gjallica" të përgatitur për botim. (Janë të ruajtura në letër kalk). Ka mbledhur dhe transkriptuar pjesë të ndryshme të folklorit shkodran të debatuar në festivalet kombëre të Gjirokastrës.

harmonizohesin drejtë me këngët e vallet krahinore.

Ishte një arritje e shënuar, njëkohësisht një rezultat bindës i një procesi për të cilin qenë përpjekur specialistë të shumtë dhe si e tillë u vlerësua nga artistët e studiuesit e muzikës. Kështu, Zef Gruda rehabilitohej në mënyrë publike dhe i kthehej skenës së koncertit. Gjatë viteve, arritja e tij u konsolidua, kompleksi karakteristik kuksian mori pjesë në festivale e veprimtari të shumta kombëtare. duke u bërë i njohur në mbarë vendin. Tamam në këtë periudhë u njoha me Zef Grudën dhe nga goja e tij mësova për procesin e nisur nga ai, për përvojen e fituar dhe për synimet në respektivë. Ai dëshironte ta fuqizonte tingëllimin e kompleksit instrumental duke dyfishuar apo trefishuar instrumentet e formacionit ekzistues e krahas kësaj të stilizonte të tjera që ende i mungonin dhe të pasuronte më tej timbriken e tyre. Por vështirsitë e pengesat që i dolën përpara qenë të pakapercyeshme. Nuk i munguan vetëm mjetet, por edhe lënda e nevojshme. Më kishte treguar se trungun e kishte gjetur rastësisht në depon e godinës së Shtëpisë së Kulturës në Kukës. I mbetur aty, ndoshta që nga koha e ndërtimit të godinës, ai trung ishte stazhionuar mirë dhe kjo, simbas tij, kishte bërë të mundur që çiftelitë e punuara me atë lëndë të tingëllonin bukur, fort e qartë. Mungesa e një lande të tillë, e bënte Zefin të dyshonte në mundësinë e arritjes të të njejtit rezultat, në qoftë se do të tentohej të punoheshin vegla të reja. "Unë edhe mund të bëj çifteli të tjera, po ku të gjej trungje të tjera si ai", më pat thenë.

Në situatën në të cilën ndodhej, në pamundësi për ta studiuar më thellë fenomenin duke vënë në jetë zgjidhje teknike të avancuara, atij nuk i mbeti tjetër veçse të mbështetej në përvojën e mjeshtrave popullorë vendas dhe në praktikitetin e tyre. Sa mund të ishte rezultative ajo, nuk vonoi ta perceptonte.

Në perspektivë, Zef Gruda shihte të mundshëm temperimin e një radhe veglash të tjera të krahinës, duke filluar nga kavalli, zumarja, fyelli me sqep i Kosovës, gjethi, lahuta, bishnica. Por shpejt u ndërgjegjsua se për t'ia dalë mbanë këtyne synimeve, nuk mjaftonte përkushtimi i tij. Nevojiteshin investime në materiale e në njerëz, pa të cilat nuk ishte e mundur të çohet përpara ai proces. Dhe kur e kuptoi se ajo çfarë kërkonte nuk do t'i jepej, ndoshta sepse nuk kërkohet më shumë prej tij, ai u tërhoq.

Gjithsesi, vepra dhe rezultati që arriti nuk mund të nenvleftësoheshin. Në procesin e temperimit të veglave popullore tradicionale, Zef Gruda mbetet një nga realizuesit e parë dhe më të suksesshëm. Ai krijoi një kompleks me vegla popullore të temperuara, duke vënë në jetë një praktikë instrumentale të mbështetur ekskluzivisht në elementet tingëllues timbrikë e gjuhësorë të traditës vendase. Pa tjetërsuar veçantinë e asaj tradite, solli edhe risi, të cilat nxorën edhe më shumë në dritë vlerat cilësore të saj.

Inisiativa e Zef Grudës dhe arritja e tij në fushën e temperimit të veglave popullore, nuk qe e vetmja. Në kohën kur vëmendja e strukturave të shtetit, në mënyrë të veçantë, atyre të artit e kulturës, qe përqendruar te folklori e te kultivimi i traditave kombëtare, muzikantë në rretrhe e krahina të tjera të vendit iu kushtuan temperimit dhe përpunimit të veglave. Në Dukagjin, duke shfrytëzuar pikat e përbashkta të takimit mes lahutës, çiftelisë e fyellit, të cilave u shtoi zumaren, bilbilin e gjethin, Robert Prendushi krijoi një kompleks veçantë ku u përfshinë vegla të malsisë e të fushës, të cilat luanin zakonisht të veçuara njera nga tjetra. Grupime të tilla deri atëherë të papara e të padëgjua, pasqyronin orientimin e strukturave të caktuara për të mënjeluar individualitetet e për t'i përfshirë ato në masën kolektive, ashtu siç ndodhte në planin shoqëror. Në të njëjtën kohë, në Gjirokastër, Gjon Simoni bashkoi në një formacion të vetëm veglat tradicionale jugore, dyjaret dhe llahutat, ndërsa në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë, Pirro Misja eksperimentoi një kompleks me vegla kordofone. Më pas, pranë Ansambllit Shtetëror të Këngëve e Valleve Popullore, ai krijoi një formacion të gjërë instrumental, në të cilin bënin pjesë instrumente kordofone (6 prima, 3 alte, 2 tenor, 1 llahutë, 2 bas, 1 kontrabas), aerofone (1 fyell, 1 klarinetrë), membranofone (1 qyp Kavaje, 1 dajre, 1 sister). Përfshirja në atë formacion e instrumenteve nga treva e krahina të ndryshme (tamburatë e veriut dhe llahutat e jugut) pasuroi spektrin timbrik ekzistues, ndërkohë që studimi dhe eksperimentimi sipas kriterëve teknike-akustike të Piro Misjes, solli tipe instrumentesh të reja si: primi, alti, curlja, tenori. Kultivimi i traditës dhe përpunimi i veçantive të saj u pasqyrua edhe në tjera eksperimenti me vegla popullore si fyelli, gajdja, çiftelia, e gjethi u sollën të luajnë në koncert të shoqëruara nga orkestra simfonike.

Kompozitorë e dirigjentë me interesa në planin studimor e kritik punuan për këtë duke sjellë në skenë e pranë dëgjuesve pjesë të veçanta koncertale, ku formula melodike, ritme të thyera e të përzjera, kombinime timbrike e kadencime virtuoze, deri atëkohë të dëgjua në manifestimet folklorike u njesuan me partiturën e muzikës simfonike, në një tërësi tingëlluese të panjohur deri atëherë. Thellime e zhvillime të mëtejshme të kulturës kombëtare dhe të traditave të saj, ato qenë krijime të një lloji të ri e njëkohësisht të një fenomeni unik, që nuk pati vazhdimësi dhe ashtu si risi të tjera me intres studimor, u ezauruan së bashku me procesin që i dha nismën.

Aftësia e Zef Grudës në temperimin e veglave popullore kuksiane dhe krijimi mbi këtë bazë i kompleksit instrumental krahinor, nuk që arritja e vetme e këtij muzikanti.

Pjesëmarrës që në rini në kuartetet e ahengut shkodran, ai qe njëkohësisht njëri nga kultivuesit më cilësorë të atij fenomeni muzikor në ezaurim e sipër. Notizimi i melodive të shumë prej atyre të këngëve të lujtura nga kompleksi karakteristikë shkodran i Radio Tiranës, qe vepër e tij. Besimi e bindja në saktësinë e Zef Grudës, më shtyu t'i referohem transkriptimeve të tij për të bërë krahasimet mes varianteve tradicionale e atyre të kënduara nga këngëtarja Marije Paluca Kraja. Në fletoret ku

ishin meloditë e këngëve, që kisha analizuar, ndodheshin edhe peçrefet e taksimet (interludet e postludet) që altonoheshin me melodinë e kënduar. Më tërhoqi sidomos mënyra me të cilën transkriptuesi kishte fiksuar në pentagram veçoritë e hollësishme të asaj muzike instrumentale, që në alfabetin e njohur të muzikës së kultivuar nuk njihen. Prandaj me të drejtë më lind pyetja: ku ndodhen sot ato punë dhe a është kujdesur kush që ta ruaj veprën e Zef Grudës? Ai pat shfaqur mendimin se ajo lloj muzike priste profesionistët të merreshin me të. Dhe vërtet, në përpunimet e orkestrimit të Çesk Zadejës, Tonin Harapit e Gjon Simonit, ndër më të shquarit në këtë lëmë, kënga e ahengut qytetar tingëllon me një potencial emocional e muzikor të ri, shprehës e njëkohësisht artistik. Edhe më intriguese janë orkestrimet e këtyre këngëve për formacionin e kuartetit dhe të orkestrës së harqeve. Të kryera nga muzikantë, për të cilët kënga qytetare ishte pikë referimi e një tradite të patjetërsueshme e shumë të çmuar, ato renditen ndër shembujt më interesantë të muzikës së kultivuar shqiptare. Interpretuesit e aftë e të kulturuar sot nuk mungojnë, ashtu siç nuk kanë munguar edhe më parë. Atyre i takon të përcjellin variante të reja nga repertori shumë i pasur i këngës qytetare, për të ringjallur kështu interesin e dëgjuesve e njëkohësisht për të ndikuar me përparësi në përpunimin e shijes së tyre drejt muzikë kombëtare shqiptare, me vlera të konsoliduara në traditë.

▪Gjuhësi▪

Ermira ALIJA

DY BOTIME ME VLERË PËR STUDIMET ALBANOLOGJIKE

-“Fjalori i gjuhës së Ndre Mjedës” dhe “Rimari i Mjedës” të Kolë Ashtës-

“Fjalori i gjuhës së Ndre Mjedës” i Kolë Ashtës, përgatitur për botim dhe plotësuar me shënime nga prof. dr. Artan Haxhi, prof. dr. Mimoza Prik, dr. Erzen Koperaj, dr. Zamira Shkreli, doc. Bora Logu dhe botuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave Sociale, Qendra e Studimeve Albanologjike, është punuar mbi dorëshkrimin e vitit 1955: “*Fjalori i plotë i nxjerrun nga shkrimet e Ndre Mjedës dhe rimari*”. Ky dorëshkrim është vijim i punës që Ashta bëri me dokumentet e para të gjuhës shqipe, me veprën e Buzikut, Matrangës, Budit, Mazrrekut, Bardhit, Bogdanit, Kuvendit të Arbnit, Da Leçes, Kazazit, Varibobës, Kavaliotit, Voskopojarit dhe Meksit. I gjithë ky fond i vyer leksikor është vënë në qarkullim prej vitit 1996 gjer në vitin 2018 nga QSA e USH, përmes veprave në seri: “Leksiku historik i gjuhës shqipe” I-VII.

Përgatitja për botim nga QSA e pasuroi Fjalorin me shënime e sqarime të hollësishme që shënojnë rreth 1086 footnota. Saktësimet shoqërohen me të dhëna nga tradita letrare e gjuhësore shqiptare, me citime nga studimet albanologjike, me shembuj nga fjalorë enciklopedikë të gjuhës shqipe e asaj italiane apo me krahasime nga fjalorë dygjuhësh, si dhe me sqarime të vetë autorit Kolë Ashta.

“Fjalori i gjuhës së Ndre Mjedës” përmban 5682 njësi leksikore. Parimi i studiuesve që e përgatitën për botim ka qenë mosndërhyrja në pikëpamjet e autorit për çështje të gjuhës, edhe kur qëndrimet kanë ndryshuar si dhe ruajtja e modelit gjuhësor të shkruar nga Ashta. Në rastet e mospërputhjeve janë bërë sqarime përmes footnotave.

Fjalori konsiderohet nga studiuesit pasuri e paçmuar për leksikografinë e shqipes e veçanërisht për thesaurusin e saj, si event i antropologjisë kulturore.

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Kolë Ashta

Rimari
i **Ndre Mjedës**

*Përgatitur për botim dhe plotësuar
me shënime nga dr. Ermira Alija
dhe prof.dr. Alfred Çapaliku*

Rimari i Ndre Mjedës, përgatitur për botim dhe plotësuar me shënime nga dr. Ermira Alija e prof. dr. Alfred Çapaliku dhe botuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave Sociale, Qendra e Studimeve Albanologjike, është pjesa e pestë e studimit dorëshkrim: “*Fjalori i plotë i nxjerrun nga shkrimet e Ndre Mjedës dhe rimari*” të Kolë Ashtës, përfunduar në vitin 1955. Ai ka në bazë të konceptimit *tingëllimat rimuese* të fjalëve (që variojnë nga një fonemë, deri tek një fjalë e plotë) dhe *fjalët-rimë* që vendosen alfabetikisht në shtyllë nën tingëllimën e përbashkët rimuese. Kjo metodë i mundëson të japë disa të dhëna të rëndësishme, si: titullin e poezisë a poemës, numrin e vargut dhe librin nga është marrë, kur gjykohet e nevojshme. Ky konceptim është interesant edhe sot, pasi jep të dhëna të plota për shumë lloje analizash.

QSA me plotësimin me shënime, e ka pasuruar botimin me rreth 40 fjalë-rima, që përbëjnë më pak se 2% të tërësisë së fjalëve-rimë të Rimarit, të cilat të marra bashkë janë mbi 2000. Ndryshimet nga lapsuset, harresat e skedave apo probleme të tjera të vogla në dorëshkrim, janë shënuar me footnote. Numri i footnotave të botimit është 227.

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

KOLË ASHTA

FJALORI I GJUHËS
SË NDRE MJEDËS

*Përgatitur për botim dhe plotësuar me shënime
nga prof. dr. Artan Haxhi, prof. dr. Mimoza Priku,
dr. Erzen Koperaj, dr. Zamira Shkreli dhe doc. Bora Logu.*

Çështjes se, nëse ia vlen t'i shtohen Rimarit edhe rima të tjera (nga krijime të Mjedës, të pamarra në konsideratë nga prof. Ashta, të përmendura në parathënie), QSA ka menduar t'i përgjigjet me respektimin e origjinalitetit, duke i hapur rrugë studiuesve të tjerë që mund të hartojnë rimarë të

tjerë, më besnikë të të gjithë krijimtarisë së Mjedës, apo edhe me këndshikime dhe objektiva më specifike.

Rimari është një nga punët e shumta dorëshkrim, që ka lënë prof. Kolë Ashta. Ai është pjesa e pestë e studimit: “*Fjalori i plotë i nxjerrun nga shkrimet e Ndre Mjedës dhe rimari*” dhe është mbaruar në vitin 1955. Ai ka në bazë të konceptimit *tingëllimat rimuese* të fjalëve (që variojnë nga një fonemë, deri tek një fjalë e plotë) dhe *ffjalët-rimë* që vendosen alfabetikisht në shtyllë nën tingëllimën e përbashkët rimuese. Kjo metodë i mundëson të japë disa të dhëna të rëndësishme, si: titullin e poezisë a poemës, numrin e vargut dhe librin nga është marrë, kur gjykohet e nevojshme. Ky konceptim është interesant edhe sot, pasi jep të dhëna të plota për shumë lloje analizash.

Tefë TOPALLI

GJUHA POETIKE NË POEZITË E ARBEN PRENDIT

* * *




Arben Prendi është tashmë një zë i njohur në poezinë tonë bashkëkohore. Prej më se 25 vjetësh ai ka publikuar përmbledhjet me poezi: *Thirrja e horizonteve* (1989-95); *Të shtunën ndeze një qiri* (1996); *Vashat nguten me u ba gra* (1998); *Qirinj të ndezun për të gjallët* (2000); *Akuarelet e jetës dhe të vdekjes* (2008-2015); *Fushnajave të amshimit* (2010) dhe *Pasqyra e kohës* (2015). Duke qenë pedagog i Departamentit të Letërsisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” prej rreth tre dhjetëveçarësh, ai ka edhe tregues mjaft të lartë të veprimtarisë studimore kushtuar veprave letrare dhe autorëve në zë të letërsisë shqiptare në Shqipëri e Kosovë, nga trashëgimia artistike e traditës si dhe kjo bashkëkohore. Si lektor i letërsisë gojore, ai ka sjellë këndvështrime të reja për vendin që zë kjo prodhimtari në gjerdanin e kulturës sonë kombëtare. Në vitin 2011, poeti ynë i ri doli para studiuesve me përmbledhjen "*Tekste në kontekste*"⁵, ku me një paraqitje të thukët e aq të kursyer në planin e gjuhës, arriti të ravijëzojë kuintesencën e 24 shkrimtarëve: prozatorë e poetë, nga më të mirët - të ligjëruar e të ndaluar pothuajse për gjysmë shekulli në fondin e letërsisë e kritikës letrare. Vetë disa vjet më vonë, A.Prendi u radhit ndër studiuesit me autoritet të shumë autorëve dhe i veprave të tyre, si kritik edhe ridimensues i vlerave artistike, duke thënë fjalën e tij si kritik i matur, me studimin “Ndërthurja e poetikave dhe çkodimi i realiteteve metafizike në romanin bashkëkohor”⁶ si dhe me vëllimin studimor "Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia bashkëkohore - studime."⁷ Ai po dallohet në lëmë të botimeve edhe si kurator i krijimtarisë vetjake: ka përzgjedhur frymëzimet më të mira prej të gjithë krijimtarisë, në Vëllimin I "Vepra poetike".⁸

⁵ Arben Prendi, *Tekste në kontekste*, Shtëpia Botuese "Naimi", Tiranë, 2011.

⁶ Arben Prendi, *Ndërthurja e poetikave dhe çkodimi i realiteteve metafizike në romanin bashkëkohor*, Shtëpia Botuese Fiorentia, Shkodër, 2015.

⁷ Arben Prendi, *Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia bashkëkohore - studime*, Fiorentia, Shkodër, 2017.

⁸ Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I*, Fiorentia, Shkodër, 2018.



I. Kredoja gjuhësore

1. Veçoritë e vjershërimit

Në këtë shkrim do të ndalemi vetëm në veçoritë e vjershërimit të këtij poeti, për të cilin mendojmë se ka gjetur e do të gjejë hapësira jo aq të rrahura nga krijues bashkëkohës të talentuar që po begatojnë letërsinë tonë në gjininë poetike. Në vështrimin e tij fokusohet koha, e sotmja dramatike e tragjike, perspektiva me dritë dhe errësirë, hovet shpirtërore dhe zhgënjimi, buzëqeshja e lotët, dënosa dhe euforia, psika shoqërore dhe individualiteti i vlarë. Në këtë vështrim, rrafsh me realitetin, ai është përpjekur ta prekë atë, ta godasë për ndryshim e të mos vishet asnjëherë me rrobën e të fantaksurit ëndrrimtar, larg asaj që sheh syri, që gjykon mendja në fluturim dhe grishin sirenat....Puna e shkrimtarit, dëshmojnë stilistët, më së pari, është punë me gjuhën, si zgjedhje e menduar që do të veshë idetë dhe shpirtin e krijuesit. Lindur bash në vitin e kodit drejtshkrimor dhe normës standard të shqipes letrare, A.Prendi, nuk mungon ta shpallë atë që në këtë syth po e quajmë *kredo gjuhësore* të krijimit. Në këtë kohë të amullt - *edhe të vetëgjyqësisë së paanë* - liria pa kufi, ka prekur edhe fushën e krijimtarisë: sipas standardit, *antistandardit*, idiomës së përzier dialektore, deri edhe në shëmti gjuhësore, që nuk kanë asgjë të përbashkët me stilin, estetikën dhe shprehësinë. Prandaj dhe poeti i ri e ndjen se duhet të deklarojë diçka, përndryshe të shpallë kahjen gjuhësore, nga do të mbajë në këtë udhëkryq: vetë i formuar kulturalisht benda njësisë linguistike të normuar, ndërkohë që shpallet folës i lindur i dialektit të gegërishtes! Shtojmë se këtij statusi i shtohet edhe njohja e thelluar dhe studimi që u ka bërë autorëve gegë të traditës. Të gjitha këto kanë ndikuar që A.Prendi, në krye të herës, kur merr të hartojë vargje, të ngulet tek problematika që ka ai dhe duhet të ketë secili bashkëkohënik i tij: "*Çështje problematike e poezive mbetet gjuha e shkrimit. Strukturat gjuhësore shkojnë gjithmonë kah strukturat e gegnishtes. Gegnishtja është gjuha e tyne e natyrshme, e leme, për shkak të formimit në gjuhën standarde shqipe, shkollimi, leximi i letërsisë së shkrueme me këtë normë, ndodh fenomeni i përziemjes herë-herë mes gegnishtes e gjuhës standarde.*"⁹ Ky pohim i Arben Prendit është larg gjykimit të bërë para një shekulli nga Faik Konica se proza qenkësh shartuar për toskët, kurse poezia vetëm për gegët! Atij i duket se kjo është gjendja ku ndodhet gjuhësisht: midis një dialekti dhe standardit, ndër të cilët, të parin e quan *të ndëshkuem*, kurse të dytin *të detyrueshëm*. Ai ka lindur bash në vitin kur u sanksionua gjuha letrare, por ka mësuar se po në atë vit, shkrimtari Kolë Jakova, pas dy vëllimeve të romanit satirik "Fshati midis ujërave",¹⁰ në variantin e shkruar të veriut, të tretin e

⁹ Po ai, po aty, f. 7.

¹⁰ Kolë Jakova, Fshati midis ujërave/ujërave, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1972.

hartoi sipas shqipes së njësuar, ashtu edhe me jo pak "shartime" trajtash sintagmatike e leksikore jo aq të natyrshme, gjeneruar prej një dramaturgu me vepra skene në dialekt. Me siguri, kështu shpjegohet pse autori përdor atributet *të detyruem* e *të ndëshkuem* - si dy pamje që qenë shfaqur njëherësh në jetën e gjuhës sonë. Ky fakt mund t'i kujtojë atij edhe kohën kur artistë të Estradës së Shkodrës nisën të performojnë skeçe, kuplete¹¹ e komedi në normën e folur, kur vetë ky interpretim bëhej burim humori për konglomeratin fonetik të kolazhit të idiomës shkodranishte me njësinë e normës! Veçse, zënia e këtij pozicioni, për poetin, nuk është qëllimkeqe, mbasi ai kthehet të nënvizojë se nuk i ka shkuar ndërmend se me këto poezi po mkamb dialektin gegë, as nuk ka shkruar të përmbysë gjuhën standarde, por është udhëheqë prej ndjenjës së leme gjuhësore dhe nga shprehja e përfutueme prej letërsisë së autorëve të mëdhenj gegë, prej Buzukut deri te Camaj. Letrari ynë flet për vete, për një përzgjedhje të tijën, edhe pa qenë konseguent në mbarë krijimtarinë dhe nuk shpreh mendime kategorike që duhet bërë ndryshe, por, si gjithë geni i poetëve, dëshiron të gëzojë lirinë e frymëzimit sipas kodit të tij, pa droje për kanonet e normës....megjithëqë sikur e ka rënduar veten me shfaqjen atavike të shenjës diakritike të hundorësisë, të shkurtësisë e të zgjatësisë, për zanoret *â, á* (të bājë, mâ shpesh, i rëndë, âsht, asgjâ, thám) dhe *ê, é* (brëj, njëni, ndëjë, me lé, me blé), *î* (flî, mbî). Nuk e quan *mëkat* se i shtron vargjet në idiomën standard apo gegnisht, nuk vuan qoftë edhe kur në mes të poezisë kërkon e gjen shprehësi stili me fjali a fraza dialektore, jo rrallë edhe me leksema apo paskajoren e *qitun përjashtë* standardit, si në strofën e vjershës "Në ndërrim të motit":¹²

"Kërmijtë dhe doktorët e shkencave enveriste
hyjnë në guackat e zyrave
me mbledhë mazën e parimeve
të shkrime
ndër shkrime....(1996)

Tek stilema *mazë e parimeve*, autori pëlqen sinonimin e fjalës "ajkë-a", jo vetëm për të sjellë një leksemë të gegnishtes, por për ta përdorur atë si shprehëse edhe në pajtim me indin e paskajores *me mbledhë*, ashtu edhe me fjalët homofone *të shkrime* dhe *ndër shkrime*. Në mbyllje të këtij sythi, pohojmë se vjershërimi i poetit A.Prendi, anon më tepër nga lëvrimi i vargut në idiomën gege, pa e kundërvënë as me prodhimin letrar të vetes gjatë fillesave të artit të tij, as me ndonjë krijues të kësaj kohe mjaft të begatë me botime në këtë gjini. Ai nuk mund të quhet prijatar i vjershërimit në idiomën gege, por ecën pas tyre, me individualitetin e tij, që rreket të jetë vetëm i tij, në këtë akt të ringjalljes së fjalës, si mund të thirret ky anim gjuhësor në lëvrimin e artit në dialektin e veriut. Prandaj dhe në

¹¹ Ferdinand Leka, Fjalor i termave të letërsisë, Infobotues, Tiranë, 2013, f. 221. [Shkruan autori: "*Kuplet-i...këngë e ndarë në strofa, me karakter humoristik ose satirik, që këndohet në estrada, opera e vodëvile.*"]

¹² Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Të shtunën ndize një qiri), f. 117. Fiorentia, Shkodër, 2018

fjalësin e poetikës së tij gjejmë leksema të tilla të cilat jetësohen më tepër në arealin gjuhësor verior, si:

blatoj, njomzak, sheston, ligsht, rrajëzon (nxjerr rrënjë), u mitos (u bë mit), kundron, dënesë, kuiste, hukat, pendla, shkapet, i epshëm, rreket, rrokatet, e ajtun, uron, përzhitje, vorbullojnë, thalb, kapërdij, skamnor, zynti, lëmekem, vrik, atbotë, përhiq, guf, i gufmuem, dorcë, i ndragun, humneros, rubë, i kërthnestë, idhtësina etj.etj.

2.Në kërkim të poetikës

Në mënyrë të figurshme, ashtu si fëmijët duan e kërkojnë hapësirë, kur hedhin hapat e parë, ashtu edhe poetët në vjershat e fillimit sikur i thërret muza poetike të dalin në horizonte, në rrafshet pa kufi të frymëzimit, mbasi vetëm kështu krijojnë edhe një marrëdhënie me fushën e lirë të artit. Në këtë çapitje jo aq të sigurt, poeti Prendi është orientuar nga kodi standard i gjuhës dhe është përpjekur t'i qëndrojë besnik në të gjitha nivelet që kërkon stili vetjak i tij, me të cilin, në vëllimin e parë të veprës poetike ka zënë plot 100 faqe me vargje. Këtu ka gjetur ai shprehjen poetike dhe poetizimin e fjalëve, një kërkesë bazë e poezisë, që nis me stilema të tilla, si: *mik i horizontit, stis kod marrëveshjeje, mitër krijimi, mëngjes i lagur, galopon mjegullës, qerre akulli, yje bizhu, të puthura rrëqethëse, të gëlltiti rruga, qiell lakuriq, tërhuzje¹³ e vetullave, musone e dashurive, kurm i virgjër, veton buzëqeshja, zë i burgosur, panxa perandorish, hundore naive, frushullimë urdhërash, tym i ozontë, guacka fjalësh, ndërmendje diskrete, shi peniciline, u ngërdhesha miqësisht, dimër mornicash (krhs: mornica dimri), fëmijë plak, smeralde harrese, kostum me lara dielli, gjak i së panjohurës, ëndrra të plogështa, veshje hibride, buis shiu, fëmijërisht e brishtë, dimër harrimi, netët e sedefta, ditë hirnake, erë e lagur, qen i zemërimit, gjamime të mysta, fusha të djerra, dëshpërime kukuese, shpërtheu dritshëm, thellësitë e gërmadhta, mokra trishtimesh, qeshnin fëminisht, ishuj mendimesh, prishur duhet, tym i fildishtë, humbja e fituar, burrec politik, mbramje e mufatun, shije eterike, rreze të pluhurta, drojë e vestë, qetësi anemike, kafkë e xhamtë etj. etj. Edhe në një titull vjershe, si "Jeta asht e shkurtë./ Bora ra gjithë ditën", ngjet e papritura e ngjizjes së përbërësve në stilemë: lexuesi mund të shqiptojë menjëherë sentencën latine "ars longa", nga thënia proverbiale e Hipokratit dhe përmendur nga filozofi romak, Seneka, *Vita brevis est, longa ars.**

Prania e ndërtimeve stilemore brenda vargut, grupeve të tyre, apo në shtatin e tërë poezisë, sjell ngjyresën stilistikore të krijimit, ndikon në shprehësinë dhe ngre nivelin e vjershërimit. Na

¹³ tërhuzje-ja, fjalë e rrallë e dialektit të gegërishtes, tek Fjalori i vitit 1954, me kuptimin: tremb, tërhuz - përdoret për kalin kur e zë rrebulli e nuk i shtrohet kalorësit e hidhet përpjetë; thuhet edhe për njerëz kur u hipen damari e zemërohen: tërhuzet. Fjalori i vitit 2006 shton edhe kuptimin: tremb kalin, e bëj të mos i shtrohet kalorësit; në kuptimin figurativ, edhe tërbohem, turfulloj nga zemërimi.

mjafton të shënojmë se në frazën e fundit të vjershës "Shurdhëri"¹⁴, emri "tejjetë" dhe ndërrimi i rendit të drejtë të përbërësve të folja "prishur duhet" (duke kaluar theksi ritmik e semantik mbi pjesorën), e bën këtë strofë aq të veçantë në gjithë trupin e poezisë.

Ndaj si në një tejjetë të shkretë,
gjithçka të duket;
dhe për të jetuar përsëri,
kjo shurdhëri e para, prishur duhet..." (1995)

Me këtë botim të parë, lexuesi do të ndahet me mbresa të veçanta për poezinë kushtuar motrës (motrave- cilatdo të jenë!), një krijim i frymëzuar, protestë sociale për vendin e femrës në shoqëri, shtypur e diskriminuar nga punët e rënda në shi e në erë, ngarkuar me dru dhe *e mardhur*, që pret me sëpatë shkurre e cungje dhe e çon jetën e kërrusur nga pesha; ndërsa njeriu i sotëm ka shkuar në hënë e për në Mars bën gati anijet kozmike! Është një motiv ndocgjetician, ku motra e Ndocit ul kokën nga nyjet e Kanunit,¹⁵ që e përshkojnë edhe në dasmën e saj; kurse *motra* e Arbenit përkulet më dysh nga barra e rëndë e jetës.

Në vëllimin ku jehojnë thirrjet e horizonteve, poeti i ri Prendi ngjet me versnikët e tij: do të përfshijë gjithçka, hap krahët si vargjet, pa lënë t'i ikën asgjë nga Toka e Qielli, Dielli e Hëna, stinët dhe ëndërrat, era e deti; por në qendër ka njeriun, nga fëmijët e të rinjtë, moshat e mesme dhe pleqtë - burra e gra, që përballen me gëzime e fatkeqësi, lot dhe brenga, vuajtje e dëshpërime, duke humbur shpeshherë edhe shpresën. Rrallë, autori merr joll¹⁶ e i këndon gjuhës shqipe, Buzukut, alfabetit, Gj.Fishtës, Samsonit e Dalilës, deri edhe Dylqinjës së Tobozës. Në këtë qerthull të ngatërruar të jetës, ai ka vënë në qendër dashurinë - si leitmotiv të qenieve njerëzore, si e vetmja forcë eprore që do ta çojë përpara njerëzimin. Nuk mungojnë në këtë vëllim edhe pak vjersha me nuancë politike, por me një sharm therës. Madje, dashurinë, ai e kthen në kredo të jetës së njeriut:

Të gjithë nga pak tashmë kemi kuptuar:
Puna, shkathtësimi i gjymtyrëve ndihmuan vërtetë,
po dashuria, e para...e fundit...
ajo na kthen në njerëz. (pa datë...) ¹⁷

* * *

¹⁴ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Thirrja e horizonteve), Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 105.

¹⁵ Ndoc Gjetja, Biri i njeriut - Poezi të zgjedhura (Në dasmën e mortës), Toena, Tiranë, 2004, f.44.

¹⁶ joll (tq.), udhë, hov (marr joll).

¹⁷ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Dashuria më bën njeri), Fiorentia, Shkodër 2018, f. 96.

3. Takimi me rimën...

Ose më mirë: rimat që takojnë poetin...

Arben Prendi i takon brezit të poetëve "të çliruar" nga kanonet e rimës, të cilat edhe i kanë quajtur "shtrat të Prokustit"; krijojnë pa numëruar rrokje e gjysmëtinguj, jo rrallë edhe pa iu bindur shenjave të pikësimit ! Dukuria e këtij drejtimi letrar e ka zanafillën tek formalizmi rus dhe themeluesi i saj Viktor Shklllovskij, 1914.¹⁸ Janë shkolla poetike, që tek ne kanë zbritur dhjetëvjetëshat e fundit në mbretërinë e vjershërimit. Kështu, tek krijimi në vargje i përmbledhjes që po shohim, gjejmë tek A.Prendi poezi pa asnjë rimemë, vargje që rimojnë tepër rrallë, ashtu edhe pak vargje me asonancë apo afri rime. Natyrshëm që kjo teknikë vargëzimi, si liri poetike e pakufizuar, i ndihmon krijuesit që të shtohen variantet e fjalësit të rimemave, larg atyre foljore dhe modeleve klishe, që e zbehin vargun dhe gjuhën poetike, e atrofizojnë përgjithësisht atë. Kështu, tek poezia "Baladë e sandaleve të prishura", brenda një strofe, dalin dy ndajfolje: njëra mënyre, tjetra ndajfolje pyetëse, një kombinim jo i lehtë në një strofë me rimë të rreptë:

Të dashurat e mia lëkurore
si më braktisët papritur *kështu?*
Rripat, mbërtheckat fine,
u këputën, humbën, *ku?*¹⁹

Mirazheve, mirazheve, vërtitemi,
e s'dimë ç'duam e ç'bëjmë në këtë *jetë*,
e s'dimë në jemi ata që jemi
në të *vërtetë...*²⁰

Nuk mund të takojmë, brenda këtij vëllimi strofa radhazi me rimema, ka kalime nga rima të rregullta, në asonancë, në strofa katërshe pa asnjë rimë, pa mundur t'u përcaktojmë skemat tradicionale, siç jemi mësuar nga vjershërimi i traditës sonë.

Sot duhet të shihemi *patjetër*,
se, o ç'mërzi, jeta pa *ty* .
Më ngjan bota krejt *e vjetër*,
Më ngjan bota krejt pa *sy*.²¹

Kaherë, shumë kohë *ka*,
një vashë që e doja e më donte,
flokët m'i përkëdhelte me joshje.
Do t'i pres, më thosh *paprá*.²²

Në këtë mënyrë, poeti ynë sjell modele ndërtimi të strofës, sipas skemave që i gjen vetëm tek ai, si:B.....B; ...B.....B; por nuk mungojnë as strukturat ABBA:

Unë thyeja ca amfora me kujtime në vetminë *time*
vozitja mes rektimesh, hutohesha nga zëra *vezullues*.
Në zhurmën e heshtjes ngrihej një tym i fildishtë *avullues*,
Unë isha zjarri që digjej ulëritës në erë, mbi *burime*.²³

¹⁸ Ag Apolloni: Dashunia fillon prej gjysmës (P.Shllaku), Prishtinë, 2019, f. 5.

¹⁹ Po ai, po aty, f. 46.

²⁰ Po ai, po aty, f. 102.

²¹ Po ai, po aty, f. 102.

²² Po ai, po aty, f. 101.

²³ Po ai, po aty, f. 95.

Është veçori e poetikës së A. Prendit që, më së shumti, në vargjet e lira, të sjellë rimema të puthura, edhe në vargje pa metër, si:

Poezia duhet të jetë e bukur,
Duhet të jetë më e bukur se dje,
Po sot jam më i pafuqishëm se dje,
copa-copa shpirti është duke më *rënë*,
prej fjalës së *pathënë*²⁴

Shikimi përplaset në dritë,
thyhet në njëmijë cifla,
majemprehta,
therëse, vetëtitëse,
ngado.
Vetëm unë *i shoh* ! ²⁵

Ndodh që në pak vjersha, autori "i kripëzon" (*jo sheqeros*) vargjet edhe me asonanca edhe me rimema, pothuajse në gjysmën e shtrirjes së saj, si në poezinë "Shpresa lakuriq",²⁶ku në 13 vargje, gjashtë janë të rimuar:

Mbetet shpresa
- fije e kashtës në thonjtë e të mbyturit
edhe kur kafka e fatit
krip me trutë e veta dheun.

Nuk çaj krye për fatin.

Në fushë qiti kryet shpresa *e blertë* AA
dhe jam krejt *i qetë*,
se shpresa prapë diku mbetet,
diku i çel lulekaçet e saj *gjëmbore*, BB
shpresa në çapojt e humbjes s'*humbet prore*.

Me këpucët godas një *gur*, CC
që më ka zënë rrugën,
dhe ec si *dikur*. (1993)

²⁴ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Art poetik), Fiorentia, Shkodër 2018, f. 48

²⁵ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Heshtje), Fiorentia, Shkodër 2018, f. 86.

²⁶ Po ai, po aty, f. 45.

Te Arben Prendi, ka modele rimemash edhe nga strofa në strofë, të cilat sikur mbajnë drejpeshimin e gjithë tekstit poetik dhe i trokasin lexuesit në procesin e receptimit se është brenda poezisë, si në vjershën "Baladë e re për dashurinë",²⁷ nga 5 vargjet e para, tek strofa II na tingëllojnë fjalët-rima:

.....
 Eh, sa herë qeshë mburrur mendjelehtë,
 Se i paprekshëm isha nga shigjetat e *dashurisë*.

.....
 Në oaz të syve robërues të së dlires
 M'u bani të fala miqve të *rinisë*.

Rrallëherë, poeti ynë gjen prehje në pak vjersha ku struktura na kujton strofat me 4 vargje klasike, lyer me rimë, së paku në dy prej tyre, si në v.II dhe IV te vjersha "Pleqtë".²⁸

U zhgënjyen nga jeta lavire,
 Njeni - tjetri dhe miqtë e *tjerë*;
 Kafe zehër në mëngjes herët, pa feksë,
 Kujdes gjatë ditës gjendja e *tyne, e nderë*.

Andruen për një botë të bukur,
 ku njeriu t'i blatohej njeriut *njeri*.
 Eh, andërr e brishtë, e lashtë,
 Tash vërtiten pa motiv nëpër *shtëpi*.

Veçse poeti A.Prendi nuk është *i përбетuar* të mohojë rimën; sepse ajo i vjen herë-herë aq natyrshëm edhe në vargjet e lira, pa metër e masë, si te "Loti i paramë",²⁹ ku gjen vend edhe asonaca:

Edhe këtë javë,
 Lot i paramë prej *synit*
 Jam,
 Nën futën e *trishtimit*
 Dhe kthehem
 Si krimineli me pa
 Në vendin e *krimit*....

E5, 2, 2

Jo rrallë, ajo, asonanca, vjen e bëhet po aq e fuqishme sa dhe rima, si te vjersha "Histori me këpucë":

Tash do të kalbeni në plehna,
 Nën trishtime *zbutës*;
 Na njerëzit mosmirënjohës,
 S'e ndërtoem një muze për *këpucët* !

Imagjinata e autorit sjell në skenë edhe kohëra me këpucë, matur e përcaktuar prej vargjeve të plota-stileme: "*Koha e këpucës së randë me gozhda hekuri, / koha e këpucës së lehtë me llustër*." Njeriu që i bart, mund të jetë i diktaturës së përgjakshme të pushtimit, ashtu edhe i një diktature demagogjike!

Nuk ka vende të caktuara ku poeti ynë të na afrojë rimema në klauzolat e vargjeve; muza e tij krijuese gjen fjalë-rima në strofën e parë, në dy vargje të puthitura, në strofa sipas një skeme ABA, ngjet që teksti poetik të hapet me rimë, ose, ose të mbyllet me dy vargje të tilla, si tek vjersha "Ikja",³⁰ ku shprehja "me iiiiiiikë *more*" vjen e jehon si thirrja e maleve "*Ooo, ç'asht pushka, more!*"

²⁷ Po ai, po aty, f. 138.

²⁸ Po ai, po aty, f. 123.

²⁹ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Lot i paramë), Fiorentia, Shkodër 2018, f. 120.

³⁰ Po ai, po aty, f. 167.

Po, tash nxitoj me ikë,
Asnjë minut kohë të merrem me *asgja*.
Siç janë më duhet t'i la të gjitha,
As kryet të mos e kthej *mâ*.

Atdheu i ftohtë si *gur*
Trandafili i horizontit në dritare.
Librat, portretet në *mur*
..... Me ikë, me iikë, me iiiiiikë *more*,
Si i dalun *fare*.

Ky vend m'i han gëzimet e pakta,
E si kaproll, ndjekë nga egërsinat,
Më ban me *ikë*,
Lamtumirë kujtime, imazhe, *grafikë*..!

* * *

II. Sintaksa e vargjeve

1. Shtrimi teorik i problemit

Do të provojmë në këtë segment të sjellim një vështrim gjuhësor, në planin sintaksor, për veprat poetike të Arben Prendit, duke e shoqëruar këtë përpjekje tonën edhe me një paraqitje teorike të sintaksës së vargjeve, përndryshe, të ligjërimin poetik. I pari ndër gjuhëtarët tanë që ka dhënë disa karakteristika të qenësishme të ligjërimin poetik në vargje, është prof.Xhevat Lloshi, tek teksti universitar “Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika”.³¹ Gjuhëtari ynë vë në dukje se shfaqja më eprorë e organizimit dytësor tek poezia është paraqitja e gjuhës së tyre, si organizim në të gjitha nivelet, ku marrin vlerë përfatesat *fonetike, prozodike, shkrimore, leksikore, semantike, sintaksore e mbisintaksore*. Krijimet poetike, sipas Xh.Lloshit, kanë si parim drejtues ritmin,

- i cili organizohet ose mishërohet në vargje,
- vargjet janë njësi të barasmatshme,
- ato kanë theksa pak a shumë të rregullt.

Autori nënvizon se zbatimi i organizimit me njësi në bazë të gjatësisë së rrokjeve, sipas gjuhëve klasike, nuk ka zënë vend në gjuhën shqipe.³² Nga ana tjetër, ritmi është:

- pikënisje për harmoninë tingëllore të poezisë,
- për të arritur muzikalitetin,
- muzikaliteti shoqërohet me emocionalitetin.

³¹ Xhevat Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika, Albas, Tiranë, 2012.

³² Po ai, po aty, f. 272.

Në nisma si kjo, duhet pasur parasysh se deri më sot, kërkimet stilistike të studiuesve të ndryshëm, kanë objekt një tjetër poezi: vjershërimin tradicional, vargjet e metruara rreptë, shpesh struktura strofash katërshe apo gjashtëshe, ku përbërësit dalin sipas parimit "varg e fjali". Rastet e shmangies së këtyre ndërtimeve e kalimit përtej këtyre kufijve, janë parë si figura sintakse, çka nuk mund të flitet për natyrën e poezive të Arben Prendit e brezit të tij. Prandaj dhe shkrimi në vijim do të jetë një përshtatje e rregullave sintaksore të vjershës me kostumin e këtyre vargjeve.

Ka poezi të A. Prendit që i bartin shumë apo disa nga këto karakteristika përnjëherësh. Nuk themi "të gjitha" sepse gjuhëtarë e stilistë si Xh. Lloshi e kanë fjalën, kryesisht, për poezitë tradicionale, sonetet, vargjet safike me rima dhe të thurura sipas ligjeve metrike, një atribut që nuk mund të kërkohet tek prodhimi letrar i autorit tonë. Teorikisht shkruhet e flitet për modele metrike shumë të rralla, gjendur vetëm tek poetë të njohur, si Naimi, Mjeda, Asdreni, Fishta e pak të tjerë, që provuan tetë rrokshin.

Në poezinë "Me mikun e kthjem nga mërgimi", ka ritëm që mbërrin muzikalitetin, i cili na prek emocionet, se tban³³ e vjetër nuk ka ndryshuar, krimbat po brejnë dërrasat e çatia pikon muresh. E gjithë kjo pamje që vret, është shtruar në "varg e fjali" përgjatë strofës pesëshe, ku vetëm vargu II rimon me të V:

Nuk e di ku mund të ulesh miku im,
këtu siç e sheh âsht shumë rrëmujë;
jo, jo, asgja s'ka ndryshue që atëherë,
dërrasat e derës të krimbura janë,
muret djersijnë dimnit ujë.³⁴

Ndoshta, autori zihet ngusht se ndodhet në atë gjendje përpara mikut që ka emigruar; mbase edhe është penduar se nuk emigroi vetë, të mund të ngrinte një shtëpi të re... Përftesat poetike na i sjell përsëritja e tingujve: *r*, *rr*, *m*, si dhe zanorja *e*, me të cilat ndjehet harmonia tingëllore, duke krijuar një tablo pikturë të varfërisë, që i bren jetën vetë poetit!

"Pushteti i rreptë i rimës", dhe "etaloni i metaltë i metrikës" i bëjnë poetët "të vuajnë" në ndërtimin e strukturave të sintaksore; shto këtu edhe "vendin e detyruar" të theksave ritmikë, tregues që brenda intonimit dhe muzikalitetit, vijnë e përftohen edhe dukuri jo të lehta për t'u pranuar nga krijuesit e vjershës; është fjala këtu për shfaqjen sintaksore të asaj që quhet

³³ tbanë-a, banesa, shtëpia; fjalë e vjetër dialektore e Malësisë së Madhe.

³⁴ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I, Fiorentia, Shkodër 2018, f. 146.

"l'enjambement" - tejkalim, siç e quajnë gjuhëtarët: kur semantika brenda një vargu, strukturë fjalië qoftë apo bashkim sintagmatik, nuk mbushet, por kërkon plotësinë edhe në vargun pas; veçse kjo shfaqje e sintaksës së vargjeve, që ndeshet aq dendur në poezinë klasike edhe në traditën tonë, në shkollën e sotme poetike, ku bën pjesë edhe vjershërimi i A.Prendit, *tejkalimi a kapërcimi* nuk dalin si nevojë e domosdoshme përdorimi, si e gjejmë në poetikën e soneteve të Mjedës, në krijimtarinë e Fishtës, apo në ditët e tashme, tek B.Londo. Në vjershërinë e brezit të sotëm, kjo shfaqje sintaksore shkon deri në mosnjohje, megjithëse ne po e vëmë në dukje, sepse formalistët janë "të lirë" të shkurtojnë apo të zgjasin vargje pa fund....Por ndodh që përgjatë poezive të poetit tonë, brenda këtij vëllimi, të gjejmë edhe vjersha ku në secilën strofë të vëmë në dukje tejkalimin, si te "Kohë është edhe tash",³⁵ apo "Buzëqeshje e hidhun":³⁶

Jeta kalon si ujnat,
nën kambët e urës së Buenës
së amshueshme të kohës....

Shoh sendet dhe njerëzit tash,
përmes një buzëqeshjeje të hidhun ironike,
në mëngjesin e pushtuem
prej reve zymtake.

S'ka asgjâ të panjohun,
në këto sende e shpirtën,
fronin e magjisë,
e zuni përsëritja,

Largohem rrugës,
tue fikë,
një buzëqeshje të hidhun,
ndër shqisa,
se e di:
rrufeja shpejt ka me ra
nder brej e lisa.

Në begatinë e vargjeve e të formave të shtruara me anë të strofave nga A.Prendi, gjen këtu-atje edhe vjersha në *kornizë*, që nga stilistët shpjegohet si rimarrje strofe, por autori i kësaj përmbledhjeje që po shfletojmë gjen një trajtë origjinale për ta kornizuar poezinë: jo mes dy strofave të njëjta, siç gjendet në stilin e Martin Camajit, por mes dy vargjeve, edhe këtë me topikë jo të njëjtë, si te "*Miku im, nuk u pamë ma*",³⁷ në "*E ma s'u pamë*" - varg që mban tragjedinë e madhe të humbjes së një miku të poetit, në vitin 1993:

Ti ike, o mik,
matanë detit,
deshta me thanë.
...Në fund të detit, më thanë
E ma s'u pamë.

Edhe kur nis e projekton korniza poetike, siç përshkruhen me rregull, ai gjen rastin e "dredhon" prej tyre, i prirur nga një strukturë origjinale, që kërkon të jetë e tija, vetëm në vjershërinë e tij,

³⁵ Po ai, po aty, f. 266.

³⁶ Po ai, po aty, f. 194.

³⁷ Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I*, Fiorentia, Shkodër 2018, f. 171.

si tek poezia intime "Ti po qan",³⁸ ku korniza i ravijëzohet edhe me nga dy vargje në hyrje e në mbyllje të frymëzimit:

*Unë e di se ti po qan,
Me lot të valë pendimi.*

Të ëmblat puthje përmes i ndamë,
Me dimre harrimi.

Dhe shpirtrat tanë që aq u deshën,
Shtegtuan skajesh diku larg.

Tani veç andrrat na kanë mbetur,
Sa të kota andrrat, sa tradicionale!

*Unë e di se ti po qan,
Me lot të valë pendimi.
E zu vendin e shpresës,
Mërzia dhe strishtimi ?!*

Edhe më e bukur e poetike na vjen vjersha në *kornizë*, për dashurinë, me titullin "Shfaqje", f. 78; por jo me dy strofa përsëritje: vetëm me nga dy vargje të fillimit e mbylljes:

*Ti më shfaqesh përsëri,Ti më shfaqesh përsëri,
imazh i ëmbël dhe i butë..... imazh i ëmbël dhe i butë,
Besomë, desha, Por ndarja është mes nesh,
veç të jesh e lumtur..... e thyer si një urë...*

Duke vijuar eksplorimet për gjuhën poetike të A. Prendit, është mirë të ndjekim klauzolat-rima në vjershërinë e autorit, sa ka mundur ai t'i qëndrojë shumësisë së fjalëve sipas klasave të tyre; p.sh.: në poezinë me 7 vargje të thyera, "Kumti i mbramjes", na shfaqen dy herë distikë me rimë të puthur: AA, BB, ka 4 rimema shprehur me 4 emra: dy në rasën kallëzore (E4) dhe dy në E3 dhe E2.

Demat e tredhun
tërheqin
qerren,
fshatarin
dhe *barin*.
- Kështu i kumtoi rrota e majtë *baltës*,
në vigjiljen e *natës*.³⁹

Pra, nuk janë rima uniforme në ndarjen që u bëjmë klasave të fjalëve, gjë që na bën të mendojmë se pasuria apo sjellja e fjalëve gjithnduerësh në shtatin e poezisë, edhe pse ithtarët e këtij drejtimi letrar nuk i përulen pushtetit të saj, rritin shprehësinë e naltojnë mjeshtërinë artistike. Në poezinë "Loja e mjegullës",⁴⁰ megjithëqë me rimë të puthur, ndjehet se autori po zgjedh ndër klasa të ndryshme fjalësh:

Mjegulla e marrë,
valët e detit në mall,
krejt harrim,
në Shëngjin
copëtoheshin.
Fytyra jote,
Endej këso bote,

³⁸ Po ai, po aty, f. 74.

³⁹ Po ai, po aty, f. 211.

⁴⁰ Po ai, po aty, f. 245.

Dhe prapë mungonte,
Kur mjegulla luate lojë

Por ka raste që përdorimi i një trajte të fjalës, siç është paskajorja geqe, megjithëse në folje të ndryshme, vjen e bëhet kakofone brenda një strofe apo edhe në mbarë vjershën, si te "Marrëzi cerebrale",⁴¹ku gjenden 9 folje të ndryshme në 9 vargje, për të cilat përherë në studime për poezinë, bëhen raporte me klasa të tjera fjalësh:

...prandaj nuk mundem ma *me dëgjue*
nuk mundem me folë, as *me shkrue*.
Nuk mundem *me lexue*,
as *me fjetë*
as *me ndejë zgjue*;
as andrra nuk mundem *me pá*
nuk mundem as *me qa*;
nuk mundem *me dashunue*
as *me krijue*.....

Na mjaftojnë dy strofa ku rimemat e vargjeve nuk janë folje po emra, si vijon, për të rrokur e ndjerë kumbimin e efektit-rimë, ndryshe nga ajo që mund të presim nga rimat-folje:

...të thotë si apostull edhe bariu në brigjet e Buenës,
tue kullotë ditët e tij - *edha*,
përmes mjegullës ku qesin shkëndija legjendat e reja...
atje ku Drini plak e i përrallshëm,
fillon e bân *dredha*. (f. 271)

E₄ }
E₄ }

S'mundem m'e marrë një lundër,
të bâhem Noe i *botës*,
ndaj rri e sodis i pafuqi,
me vënë fundin e *gotës*. (f.273)

E₂ }
E₂ }

Mund të vërehet lehtë se vargun e fundit këtu e bën poetik jo aq rima, sa rendi i gjymtyrëve; pas foljes "sodis" sipër tij, lexuesi do të priste vendosjen: ...*fundin e gotës me venë*, ndërsa gjen tjetër rend, jo të detyruar në kërkim të rimës, por lirinë për të rënë në sy, për të tërhequr vëmendjen.

Edhe më tepër rritet tingëllimi poetik, kur në klauzolat me rimema fjalët shënuese (kuptimplota) dalin të kombinuara me fjalë shërbyese, si në terciën e mëposhtme:

Miku që iku prej *këtej*,
kryet mbas e *kthej*
derisa mbeti *pa kokë*,
dhe shpirti i fluturoi në atë *botë*. (f.261)


Më duhet mendjen kot *ta vras*:
Çka do të bâhet me ata
që e kanë kohën përpara
dhe me ata që e kanë kohën *mbas* ? (f.270)

Në të rrallë, autorit tonë-pedagog letërsie, i troket apo i kumbon në vetëdijen krijuese edhe ndonjë fjalë poetike nga Mjeda, edhe prej Lazgushit, të marra, jo si plagjiat i fshehur, por duke gjeneruar sipas modelit të tyre, b.f., në vargun e bukur për *Drinin plak*, duke i afruar


⁴¹ Po ai, po aty, f. 236.

karakterizimin e bukur "i përrallshëm" - siç pat bërë Poeti i Pogradecit: "Ku Drini plak e përrallor/Buron prej Shëndaumi." ⁴²

Të tre mbiemrat e prejardhur nga rrënja "përrallë-a", ndahen në smantikën e tyre, sipas emrave me të cilët bashkohen në valencë: ⁴³



Ndodh në krijesat - vjershë të A.Prendit që struktura poetike e vargjeve të dalë me varësi vetëm tek një folje dhe gjithë teksti të marrë trajtën imagjinare të një vile rrushi, si tek "Më lini vetëm me diellin" (f.63):



2.Fraza - tekst

Në studimet tona sintaksore të traditës dhe në Gramatikën shkencore të Akademisë së Shkencave, ⁴⁴shkruhet: "Tani po bëhet fjalë edhe për njësi më të mëdha sintaksore se periudha. Është pak a shumë e njohur qenia e njësisë semantike-strukturore të përbërë prej fjalish të mëvetësishme a periudhash të ndryshme, e cila ka një përmbajtje të lidhur, të organizuar zakonisht me mjete gramatikore. Mund të quhet *thënie e lidhur*." Por, në rrafshin e kërkimeve gjuhësore europiane, gjenden hulumtime të këtij lloji që arrijnë deri tek marrëdhëniet e frazës me tekstin, madje flitet edhe për sintaksë teksti. Këtë vështrim të ri, sjellë sipas gjuhëtarit italian Stefano Telve, ⁴⁵ po përpiqemi ta ndjekim në poetikën e A. Prendit. Për të qenë më konkret lidhur me këtë risi në studimet neolatine, po marrim një model sintaksor të Ndre Mjedës, përndryshe një fragment tekstor nga poema "Andrra e jetës", pjesa IV- Zoga. ⁴⁶ Gjithë poema është shkruar me rimë të rregullt: ABAB, ABBC, me vargje safike që mbajnë skemën AABB; ka edhe vargje të rimuara në fundet e secilës strofë, si te pjesa II, III e këngës Tringa, f. 75 -

⁴² Lasgush Poradeci, Vepra letrare, Kombinati Poligrafik "Shtypshkronja e Re", Tiranë, 1990, f. 284.

⁴³ ASHSH, Leksikografia shqipe-Trashëgimi dhe prespektivë (Hajri Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*), Tiranë, 2005, f. 158 - 168.

⁴⁴ ASHR SH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe- II, Tiranë, 1997, f. 64. [Më tej, autorët

kanë shënuar se *kjo njësi sintaksore përgjithësisht është pak e studiuar. Në gjuhën shqipe, ajo s'është bërë ende*

objekt vizhimi të veçantë.]


⁴⁵ Stefano Telve, L'italiano: frasi e testo - Nuova edizione, Carocci editore, Bussole, S.p.A. Roma, 2013.

⁴⁶ Ndre Mjeda, Vepra letrare I, Kombinati Poligrafik "Shtypshkronja e Re", Tiranë, 1988, f. 89-90.


80. Tek kënga "Zoga", f. 89, janë 4 strofë shumë të veçanta, që nuk ngjasojnë me asnjë segment të kësaj vepre dhe në të gjithë trashëgiminë letrare të poetit. Është shembulli i shkëlqyer i asaj që u shtrua më lart për të ashtuquajturën "frazë-tekst" - nëse duam, edhe "teksti-frazë", për të cilin themi se e bën Mjedën pionier të kësaj forme poetike, dhe për të, duhet kërkuar një analizë krejt tjetër nga ajo që i bëhet periudhës.

Janë 4 strofa gjashtëshe, secila në masën e një njësie sintaksore-periudhë, me 24 vargje; e para ka ndërtim të drejtë, përmban 2 njësi drejtuese me nga 2 të varura secila; II ndërtim të zhdrejtë, me një fjali drejtuese e 3 të varura kohore; strofa III ka ndërtim simetrik: 2 fjali drejtuese me nga 1 të varur kohore, kurse strofa IV- me ndërtim të drejtë- ka strukturë të ndërlikuar, pasi njësia II drejtuese del e ndërmjetuar prej 3 njësive të varura predikative përcaktore (e veçuar ajo është: *Nuk i ngjet prilli....as fllad...foshnjës*). Këto 4 strofa janë shumë të lidhura kuptimisht me njëra-tjetrën, sa formojnë një tekst, një kuadër peizazhi ku nuk duhet të mungojë asnjë detaj: hëna me yjëzit, agimi me rruzullimin, shendi me shpend e lule, si dhe qielli me muajin prill e me lule. Në këtë parajsë tokësore, në qendër të saj, është vendosur: foshnja plot gaz me *Nënë*n e saj, kur ajo i përkulet mbi të. Por, sidomos kjo lidhje vjen e pakëputur edhe gjuhësisht, në mënyrë të veçantë mes strofës III, IV, sepse konektori (lidhëza kundërshtore) "por" duhet të lidhë dy anë të krahasueshme midis tyre. Autorja e monografisë "Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe", L. Mëniku shkruan: "*Pozicioni karakteristik i konektorit **por** është ai në mes të fjalive. Ndonëse pozicioni i lidhëzës kundërshtore **por** i përshkruar në grammatikat e shqipes, mbetet ai në mes të fjalive, në gjuhën e shkruar vihet re gjithnjë e më shumë një rritje e përdorimit të saj në fillim të fjalive.*"⁴⁷ Në pikëpamje logjike, ky konekt vë përballë kontrastin mes dy pamjeve, cilësive apo mendimeve të ndryshme, në mos, në opozicion.

Pa u larguar nga shembulli klasik i Mjedës, ja dhe pamja skematike e përbërësve predikativë që e formojnë tekstin-frazë, që sollëm për model ndërtimi të pandarë:




⁴⁷ Linda Mëniku, Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe, Albas, Tiranë, 2014, f. 122.




Dukuria me konektin "por", natyrshëm, ndryshe prej Mjedës, del edhe në vjershërinë e A.Prendit, veçse te ky poet i ri, strofat e nisura me këtë mjet gramatikor, sikur bëjnë konkluzionin e autorit, pas rreshtimit të disa shfaqjeve në vargjet më sipër, sikurse tek vjershat "Patjetër duhet të ndryshojë bota" dhe "Dylqinja e Tobozës", f. 102-103. Në të parën renditet një botë e mërzitshme, e vjetër, me vargje të përbotura, me mirazhe areale,..... është një botë, së cilës autori duhet të shprehet në mënyrë kategorike,është një strofë që nis me.....*p o r*, e cila përafrohet si varg i Internacionales, ndërsa luhet për një ndjenjë në sferën e dashurisë; dhe 5 njësitë kumtuuese, shtrirë në 4 vargje, nuk mund të qëndrojnë pa përmbytjen e strofave më sipër, duke e bërë tekstin një frazë të vetme semantike:

Por ka një gjë që nuk lëkundet më,
 Sot do të shihemi patjetër.
 Më ngjajnë gjërat pa kuptim,
 Më ngjan bota krejt e vjetër

Kurse tek Dylqinja, ajo "por" vjen në kundërti me vetë heroinën sarkastike të heroit po aq sarkast, Don Kishot!! Është një dukuri në botën fizike e shpirtërore të një personi popullor në literaturën botërore.....! Në sintaksën e vargjeve të A.Prendit na shfaqen skema laryshe, sidomos në strukturën e fjalive me shumë gjymtyrë që varen nga një folje poshtë tyre, ose anasjelltas, si në modelet e poezive "Odise i humbur", f. 44:



Anasjella e kësaj strukture del dendur, si në poezinë "Stinë e rrezikshme", f. 42, ku ndryshimi gjuhësor vjen edhe nga kundërvënia e rasave rrjedhore me ato kryesisht emërore:



vegimi i djemve dhe vajzave,
 burrave dhe grave të vramë,
 në skaje humbëtirash të shkreta,
 sipas skemash klasike.

Ndonjëherë strofat e lira, sa i takon numrit të vargjeve, jepen "mbërthyer" mes dy foljeve: në fillim dhe në mbyllje, sikur shpërndahen sa për njërën, ashtu edhe për tjetrën, në mënyrë simetrike, si e dallojmë tek vjersha "Skema", f. 30.


Fjalët janë bërë standarde si stampat,
 buzëqeshjet standarde, shpeshherë të rreme,
 shkëlqimi i gjërave dhe sendeve artificial,
 kuptimi i jetës dimër boreal
 pret të çelin krizantema.

Gjykojmë se autori ynë merr e ndërton skema të habitshme, me lidhje strofike të atillë, që vargjet sipër dhe poshtë, e kanë qendrën e varësisë të një folje në mes tyre, qoftë edhe pa simetri numerike leksemash, si të vjersha e shkurtë "Çmagjepsja", f. 137:

Si një pelë gërdallë e lodhun,
 me buzë të vyshkuna, thundra të pista,
 shikim plot qelb të ngrimë,
 brinjë të drezgosuna feminiliteti,
 tualet dhe kundërmim artificial,
ish e dashuna më kalon pranë.
 E rëndomtë,
 torollake,
 me dy pauza idiote,
 mbas koke.

Ndërtimi gjuhësor (sintaksor) i vargjeve të lira dhe i strofave të tyre amorge, siç janë dhe *parregullsitë* e këtij drejtimi letrar, e bën jo pak të vështirë të nxjerrim përfundime për strukturën e frazës, në vjershërinë e Arben Prendit, sepse krijues të tillë gjenerojnë poezi me mendime të lirshme dhe pa kufij numerikë fjalësh e pa metër; ka shumë fjali të varura, pak njësi drejtuese dhe kryesore, të cilat nuk mbajnë në varësi njësi kallëzuesore; shfaqen bashkime me parataksë, pak struktura hipotaktike dalin në indin e krijimeve të përmbledhjes që kemi në dorë. Ka pak strofa të thurura si modeli në vijim, nga poeti ynë:

"Fjalë s'u dëgjoja veç kapja të qeshurën,
 që variacione ajri dhe drite muzikonte në hapësirë,
 të kaloja pranë tyre ata do të iknin,
 ndaj ndërrova drejtim. (f.98)



Në rastet kur autori zë e përsërit vargje apo mjete të lidhjes sintaksore, nuk i sjell me topikë të njëjtë, por, duke i ruajtur marrëdhëniet e raportet midis njërive kumtuese, ndërton vetëm vendin e tyre, si në vjershën intime "Ti je fajtores", f. 100, ku vargu i njëjtë "*ti je fajtores, je pa dyshim*" dhe lidhëza e kushtit "*nëse*", edhe pse dalin dy herë, nuk e rëndojnë poezinë në tërësi:

"Kërcasin hapat e mi prizme akulli
 nga majë e gishtrinjve të flokët kjo krismë,
nëse tani ca rreca mbetën nga blerimi,
ti je fajtores, je pa dyshim.

Me atë drejt vrapit të marrë humbje
 mbi florën, faunën shpërndaje ngricë.
Ti je fajtores, je pa dyshim,
nëse akullnajat nga polet zbresin një ditë



Bie në sy që strukturimi i vargjeve në sekuenca të ndryshme tekstore, si në ato dinamike, përshkruese apo statike, autori ia del të përshtasë e të zgjedhë mjete gjuhësore, të sjellë me shumicë klasa fjalësh që shprehin veprime, siç janë foljet, emrat prejfoljorë, kurse, kur ravijëzon një tablo jete të qëndrueshme, nuk i sjell ato të pranishme, deri edhe ndërton strofa me një folje, të shtjelluar, si në vjershën "Ndërmjet dy botësh", f. 296:

Tue u kalamendë nëpër brenga,
shoh pamje, fytyra të njajta e të ndryshme,
 e ata sy me shikime të zverdhuna e hileqare,
 përgojuese të vështrimeve të të tjerëve,
 në një pazar të madh teshash të përdoruna,
 ndjenjash e mendimesh,
 ndërmjet dy botësh:
 Orient e Oksident.

Për skemat e ndryshme gjuhësore-sintaksore, studiuesit e sotëm kanë shprehur bindjen se ato shfaqin skema të të menduarit logjik. Psikolinguisti amerikan, Fodor, këmbëngul se është "forma logjike" e shprehjes në gjendje të luajë një funksion interfaqës, pasi, në trurin e njeriut ndodhet një modul specifik, i aftë të udhëheqë proceset e përmbajtjes, duke shndërruar tingujt në domethënie; e mund ta bëjë këtë falë relacionit të ngushtë që ka forma logjike nga njëra anë, me sistemin e tingujve dhe, nga ana tjetër, me strukturën sintaksore të mendimit."⁴⁸ Prandaj dhe në punën me gjuhën, është gjykuar prej kohësh që strukturat e frazës, në një masë jo të vogël, të shoqëroheshin me skemat përkatëse, duke i quajtur ato pasqyrime të strukturës së të menduarit. Strofa më sipër shfaq një formë të menduari poetik, individualisht, të A. Prendit, kur ai do të sjellë disa të dhëna, nëpërmjet enumeracionit, si një inventar sendesh e cilësish që do t'i rreshtojë në realitetin që vëzhgon....

Ky *ligjërim i shpejtuar* (në mund themi me këtë atribut), është i pranishëm në mjaft krijime poetike të poetit, madje kjo mënyrë të thëni, duke zbratur përnjëherësh çka mbahet ngërthyer, vjen e përdoret edhe në rastet kur vargnimi *si breshëri*, del në masën e *tekstit-frazë*, kësaj radhe jo me konektin e analizuar më sipër tek Mjeda, por me "E pra", i cili duhet shfaqur vetëm në vijimësi të një teksti, si në strofën II të një poeme,⁴⁹ f. 306 dhe asnjëherë në fillim; gjithashtu as vargjet në vazhdim nuk mund të qëndrojnë të shkëputur nga 6 vargjet, para konektit të dhënë me të zeza:

Adoleshentët hanë patatina,
 dhe lexojnë lajmërimet e vdekjeve,
 në stendat e shpalljeve
 dhe qeshin me fytyrat solemne në fotografi;
 ec e merr vesh/a është përqeshje apo qeshje normale

⁴⁸ Francesco Ferretti, *Alle origini del linguaggio umano - Il punto di vista evoluzionistico*, GLF Editori Laterza, Roma-


Bari, 2017, p. 37.

⁴⁹ Arben Prendi, *Vepra poetike*, Vëllimi I, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 306.

e moshës/që çdo gjë e merr për lojë, pra dhe vdekjen.

E pra, kjo mund të jetë shenjë

ose se ata do të jetojnë gjatë,
dhe do të jenë trima në jetë;
ose se do të jetojnë vrullshëm
dhe viktima do të jenë shpejt;
ose ky është shekulli i adoleshencës,
që s'do t'ia dijë për gjanat,
që edhe për brezin tonë janë ende serioze,



Fjvpr. Fjvpr.

siç janë:
Dashunia,
Familja,
Jeta,
Vdekja.

Gjuhëtari dhe stilisti Xh.Lloshi ka vërejtur se qysh me krijimtarinë e Migjenit “ka zënë vend të qëndrueshëm vargëzimi i mbështetur në ritmin e të folurit emocional sipas stilit të gjuhës bisedore, me elementë të ritmit lirik dhe nëpërmjet pyetjeve ose dialogut “,⁵⁰ duke sjellë si shembull të kësaj dukurie fillimin e Poemës së Mjerimit: *Kafshatë që s’kapërdihet asht, or vlla, mjerimi...*; është një nisje me disa vargje që kanë tipare bisedimi. Mendojmë se pamje të tilla, në letërsinë tonë kanë zënë fill me krijimtarinë e Mjedës; mjafton të krahasojmë nisjen e poemës “Andrra e jetës”:

“Molla t’kputuna një dege,
Dy qershija lidhë’n’nji rrfanë,
Ku fillojnë kufijt’e gege,
Rrinë dy çika me një nanë”

Janë vargje poetike që na ngjajnë si rrëfimi i një përralle, ose kur duam të tregojmë ku banojnë dy a më tepër njerëz. Në të folmen bisedore përdoret më së shumti folja “rri”, si në replikat e mundshme: “rri në Shkodër”, “rri në fshat”, “rri në malësi” etj. Pra, kjo folje vjen në vend të foljes “banoj”, ose “jetoj”: “jetoj/banoj në Shkodër”, “jetoj/banoj në fshat, malësi” etj. Sipas studiuesve, mendimi poetik lëviz me masa ritmike, në organizime tingëllore, fushë me të cilat merret metrika dhe ku kanë dhënë ndihmesën e tyre autorë të tillë, si: Dh.Shuteriqi, Gj.Zheji,⁵¹ e tash së voni, edhe gjuhëtari Mina Gero, me veprën unike në llojin e saj “Fjalori rimor i Dritëro Agollit”.⁵² Ky strukturim ritmik vjen për të gjitha nivelet e gjuhës: në fonetikë, gramatikë, leksik e sidomos në sintaksë, ku kërkojnë vëmendje të posaçme:

- sintaksa poetike,
- leksiku poetik, - figurshmëria.⁵³

Motiv mjedian do ta quaja poezinë *Plaku i braktisun*,⁵⁴ e cila ngjan aq shumë me *Molla t’kputuna* e krijime të tjera të Poetit të madh, duke përmbushur njëherësh 3 kërkesat më lart dhe ka një ritëm të mrekullueshëm, edhe pse autori nuk është ruajtur aspak të mos dalë nga hulla e 8-rrokëshit, që vjen e zotëron; ka në këtë vjershë edhe ndikim e pak "plagjiat" - me

⁵⁰ Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Albas, Tiranë, 2012, f. 272.

⁵¹ Gjergj Zheji, *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1988.

⁵² Gero, Mina, *Fjalori rimor i Dritëro Agollit*, Toena, Tiranë, 2013.

⁵³ Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Albas, Tiranë, 2012, f. 273.

⁵⁴ Arben Prendi, *Vepra poetike*, Vëllimi I, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 331.

dashje - nga *pisi plak i Tulës!*⁵⁵ Një vendosje e dy teksteve pranë e pranë, do ta bëjë lexuesin të përfarohet në figuracion: gotën e arit me putirin, si dhe dy vargjet: Mbreti i Tulës: "*Fikun syt' e s'pau ma kurr/ edhe kurrë ma nuk u çue*" (Plaku i braktisun). Nga leksiku poetik, zgjedhim si vijon: *hije peme, putiri* (leksemë folklorike - jo gotë), *ditë jete, i molisun, arratia, lëndina, ngau e ngau, i shkreti, nëpër andërr, nuk u çue*. Është një nga poezitë më të frymëzuara të përmbledhjes që kemi në dorë: dramatike dhe tragjike për gjendjen e vendit, që po plaket e vdes pa u ndjerë....

Plaku fjet nën hije t'pemës,
raki piu ai me putira,
ndër sa ditë që pati jetë,
kjo veç është më e mira.

Përmbas fëmisë që s'i ka afër,
as nuk din se ku kanë shkue;
ngau e ngau i shkreti plak....
edhe kurr'ma nuk u çue.

Studiuuesi dhe shkrimtari Gj.Zheji, në një syth të veçantë, ka trajtuar liritë popetike, të cilat i ndan në dy grupe: a. Ato që pakësojnë rrokjet, si: *afereza, sinkopa, apokopa, sinalefa* dhe b. Liri poetike që shtojnë rrokjet: *proteza, epenteza, paragoga, diereza dhe hiatusi*.⁵⁶Për të gjitha këto dukuri, poetët e drejtimit letrar, ku krijon edhe A.Prendi, janë të pandjeshëm, pasi nuk praktikojnë metrin në poezi, veçse herë-herë, për arsye ritmi, ato duhen përdorur.

.....

Sipas studiuesve, *sintaksa e vargjeve u nënshtrohet kërkesave, që nisin nga rima e theksi e vijnë deri tek llojet e strofave, kështu që përmban shmangie nga sintaksa e zakonshme, gjë që ka sjellë nocionin e "lirive poetike."*⁵⁷ Për këtë nivel të gjuhës, stilistët dhe gjuhëtarët përgjithësisht, kanë arritur në përfundimet se, për poezinë, sintaksa ka disa përkatësi, që nuk i përmban ajo e prozës apo dramës, në tekstet përkatëse; kështu, ajo (sintaksa e vargjeve):

- është faktori veprues kryesor në vargje,
- ajo bashkërendon elementet e tjerë,
- ndërton grupet e krahasueshme ose paralele.

Arben Prendi ka fituar prej vitesh përvojën *ta zotërojë* vargun dhe gjithë tekstin poetik, t'i japë kahun drejt synimit të idesë dhe të ngjyrimit të kohës, por jo vetëm të një kohe të caktuar, por ai arrin të ndërkeqemjë tregues kohorë, të bëjë paralelizma, siç bënte Noli ynë te *Krishti me kamxhik* kur ia dhunuan vendin e shenjtë. Kështu, edhe autori i kësaj tube bukur të bashme, bëhet *Mësues*, vetëquhet siç e quajtën Apostujt Mesinë kur jetuan dhe u ndanë prej tij....Është leksiku që i prin poetit në vjershën e realizuar "Miniaturë" - një titull që ka përmasat e Madhështisë, për realitetin shqiptar që prek, për shqetësimin e njeriut largpamës...edukator dhe Mësues-Pedagog. Ja fjalësi që na sjell kohën e *Erës së Re*: dishepull, pergamenë, parashoh, rreket, gjykim (Dita e Gjykimit), Juda, Mësuesi para tij - i mohuar e tradhtuar përjetësisht! Poeti-Pedagog përjeton në auditor autorë e personazhe botërore, nga *Romeo, Idioti, Tre shokët; Beatriçja e Madam Bovari* - i zë në gojë se i njeh ata, sepse nga aulat universitare si studentët e tij kanë dalë; në krahun tjetër sjell ndër mend Abelin e pafajshëm- vrarë nga Kaini, që mungon atë ditë mësimi - Shën Pjetrin apostull, Shën Jozefin e Marijës, Sarën e Dhiatës së Vjetër dhe Madalenën mëkatnore, që falet nga Jezusi...! Autorin nuk e shqetëson fakti si janë studentët e tij, por si do të jenë në jetë,*dikur* - është dhe fjala e fundit e poezisë:

Bota në miniaturë

Juda nuk mungon,

⁵⁵ Ndre Mjeda, Vepra letrare-1, Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja e Re, Tiranë, 1988, f. 151-152.

⁵⁶ Gjergj Zheji, Bazat e vargëzimit shqiptar, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1988, f. 77.

⁵⁷ Lloshi, Xhevat, Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika, Albas, Tiranë, 2012, f. 273.

janë studentët e mi,
dhe unë dishepull i harruem...
Fytyrat e tyne - pegamenë të hapun
kur parashoh të ardhmen,
ndaj më përqeshin.....

në bankën e fundit,
por mbas puthjes,
ai ka me e tradhtue prapë Mësuesin...
Dhe Mësuesi do ta falë...
me shpresë se
ka me ndryshue dikur.....

* * *

3.Poezitë - pikturë

(Peizazhe)

Janë karakteristike mjaft krijime të këtij poeti, të cilat, në vështrimin gjuhësor dalin të tilla: me elipsë të theksuar kryesisht të foljeve, me emëzim tej mase në numër të fjalive, si të ishin vizatime me penelin disangjyrësh të autorit. Aq më tepër se vëllimi që u bë këtu objekt vështrimi analitik, përmban edhe një tubë të emërtuar "Akuarelet e jetës dhe të vdekjes",⁵⁸ me poezi të tilla, si: *Paskajore*, f. 270, *Zoja Morde*, *Me zemrën e mbushun me pikëllim* etj.

Në shfaqje si këto krijohen rrethana ligjërimore që diçka të bjerë në sy ose të shquhet; edhe në një vjershë panoramike, pikturë për një pamje ekzotike, ku duhet ta kthejnë shikimin të gjithë ata që kanë në dorë fatet e një populli, siç shikohet tek poezia me 9 vargje, edhe njëfjalëshe; janë vetëm dy folje: njëra në aorist, tjetra të kohë të tashme; e para që ndiqet nga disa objekte homogjene, tjetra që ka ka përpara ato. Është një "ngjeshje" sintaksore dhe një topikë poetike e vendosjes së përbërësve gjymtyrorë, si te vjersha "Ciganët",⁵⁹ me rimë të largët.

E pava prapë atë popull fantastik,
mushkat, çadrat, arushat, qentë, kazanët, shtrojet,
djepat, fëmijët dhe pleqtë,
me eshtrat e stërgjyshëve në *shpinë*.

Ciganët,
një atdhe,
një tokë,
mbartin ngado:
L i r i n ë.

Ose, edhe pa asnjë folje, si strofa e fundit e vjershës *requiem* "Ditë zije"⁶⁰ për miqtë e mbytur bashkë me anijen në det, apo në peizazhin "Deti" (f. 61):

.....
Në TV, muzikë e hareshme,
dekrete qeveritare, delegacione shpëtimi
filma optimistë me fund të lumtun,
deklarata partiake lufte dhe pajtimi,
dukumentarë për mbarështimin
e brumujve dhe kërmijëve.

Trumba me guaska,
të kuqërreme, të gjelbra, të hirta,
të bardha,
në breg,
si kabinat telefonike,
në sheshet kryesore të një qyteti.

⁵⁸ Arben Prendi, *Vepra poetike-I* (Akuarelet e jetës dhe të vdekjes, f. 259-276), Fiorentia, Shkodër, 2018

⁵⁹ Arben Prendi, *Vepra poetike-I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 159.

⁶⁰ Po ai, po aty, f. 144.

Edhe portrete njerëzish, madje i nënës, vjen e pikturohet si një gravurë, me ngjyrat-fjalë, nga autori, duke zgjedhur një leksik me të cilat ravizohet shpirti e vuajtja gjatë gjithë jetës, me sintagma, si: duar të rreshkura, duar me damarë, palcë druri, e fortë si asht, etj.:

N a n a ...⁶¹

*Nana,
me duart e rreshkura plot damarë,
si harta e mundimeve dhe vuajtjeve,
nga koha e egër,
e fortë si ashti,
palcë druri e butë,
nën fodullëk të diellit përvëlues rrëmih,
ende dheun e çarë,
pranë bimëve në fushë,
si një gravurë,
që koha e gdhendi
në kujtim.*

Edhe strofa të tëra me shumë vargje krijohen tablo pikturë, që fokusohen vetëm nga një folje (je -ndodhesh), por që vijnë e mbështeten nga mbiemra prejfoljorë, të cilat e kanë në semantikën e tyre veprimin e foljeve që mungojnë (e fshehun - *që fshihet*; e mbrojtun - *që mbrohet*):

Sa mirë që larg je !
*Sa dashunisht je larg,
e fshehun,
e mbrojtun,
nga kërcimi somnambul i figurinave të vapës,
trompat e pashmangshme të mushkajave dhe grethave,
nudoja molisëse
e dashunisë sime
të alivanosun
nga ândrrat.*⁶²

Klasat e fjalëve që u japin ngjyrë *poezive-piktura* në disa vjersha vijnë e bëhen emrat prejfoljorë, me prapashtesat - *im*, - *esë* dhe - *je*, si: shterrim, harresë, kthim, shikim, izolim, zvarritje, thirrje, shurdhim, dyshim, rrënim, si dhe ndonjë pjesore e mbiemër i panyjshëm prejfoljor, si te poezia "Rrënimi":⁶³

Në fillim, shterrimi i ideve të reja,
pastaj harresa e kufijve diku,
kthimi i shikimit vazhdimisht pas
e ftohta në tru.

Izolimi në zvarritje,
nën banderola optimiste thirrjesh,
fosilizim i llahtarshëm i indeve,
shurdhimi i plotë.

Kështu përfytyrova një ditë hirake,

⁶¹ Po ai, po aty, f. 142.


⁶² Po ai, po aty, f. 127.

⁶³ Po ai, po aty, f. 85.

karfosur nga dyshimet dhe të ftohtit,
rrënimin e mekanizmit orientues,
të kombit. (1990)

Përftesa me rendin është një mjet i përhershëm stili gjatë hartimit poetik, megjithëse liria e krijimit, domosdo që përfshin edhe lirinë e vendosjes së gjymtyrëve funksionale sintaksore. *Loja me rendin*, siç mund të shkruhet për vargnimin, kthehet në mjet shprehësie, kur ka mjeshtërinë e përdorimit, si në distikun që kemi dhënë më lart tek fjalia njëshe, ku gjithçka varet tek endiada "rri e sodis"⁶⁴

".....ndaj rri e sodis i pafuqi,
me vënë fundin e gotës"



Por, tek poezitë e vargut të lirë të Arben Pprendit dhe brezit të tij, përftesa me rendin duhet të quajmë edhe vendosjen e foljes-kallëzues të fjalisë, në raport me gjymtyrët e dyta, edhe me kryefjalën, siç thuhet dendur vendosje "*majtas dhe djathtas*", pamje që vjen e shfaqet në dy vargjet vijuese:

Në lumin e njerëzve t'qytetit,
Shuej etjen e vetmisë (f. 224)

ku radha e gjymtyrëve në vargun e parë (rrethanori me përcaktorin) dalin para foljes, ndryshe nga kundrina dhe përcaktori i saj, që vendosen pas saj. Edhe më tepër bien në sy ndërtimet emërore, pa folje, në të cilat kryefjala vendoset në fund të strofës, si poezia "Njollë antropologjike":⁶⁵

E brengosun, e zhvoshkun,
lavire memece,
mbramja jonë kombëtare. (f. 220)

Ka raste kur edhe një gjymtyrë krahasimi zë pozicionin mes dy foljeve, duke bartur theksin logjik dhe tërhequr vëmendjen e gjithë ndërtimit të strofës:

.....Sot, mbi varr të mëngjesit
Po këlthasin gjith' telefonat e botës,
si zogjtë e Stimfalit,⁶⁶
me lajmue
vdekjen e tij...(f. 217)

Krijuesit e çfarëdo shkolle a drejtimi letrar, duhe ta ndjejnë edhe pa dashur se në gjuhën tonë, realiteti i njësive predikative njëshe, kaq të pasura në variante ndërtimore, të cilat janë quajtur e përfshirë në ato attribute që përmbledh "*natyra e shqipes*", veprojnë bukur mirë edhe në përftesat me rendin sintaksor të saj, si në vargjet më poshtë, ku kryefjala mungon për natyrë të gjuhës sonë:

Bjer ku të mundesh,
ku ta marrë mendja

Largohem rrugës,
tue fikë,

⁶⁴ Justin Rrota, Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 405.

⁶⁵ Arben Pprendi, Vepra poetike, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 220.

⁶⁶ Stimfal-i, në mitet greke, zogj monstruoze të liqenit me të njëjtin emër, me fletë e krahë metalikë, që ushqeheshin me mish njeriu; edhe emër qyteti në Peleponez.


se dhimbje të pamatë qet. (f. 188)

Këtu merret frymë për brinjësh,
E thonë përherë të pavërteta!
Këtu veç një herë dimë me vdekë.

një buzëqeshje të hidhun,
ndër shqisa,
se e di:
rrufeja shpejt ka me ra
nder brëj e lisa.... (f. 194)

Përftesa me rendin duhet marrë në këtë varg, edhe disa ndërtime të rralla, ku autori ndan nga fraza- tekst një ind të saj, që del më vete, edhe pse nis me një mjet lidhjeje sintaksore - shenjë të hipotaksës. Para shumë viteve, këtë dukuri që po përhapej, gjuhëtari M.Domi⁶⁷ e ka quajtur *parcelizim* ose *segmentim* të një njësie superfrastike, e cila, më tepër se në vjershëri, i takon letërsisë në prozë. Këtë strukturë të tekstit poetik na e sjell autori ynë te vjersha "Se vjen një orë e mbrame",⁶⁸ ku strofa II nuk mund të organizohet gjuhësisht më vete:

E mjegulla shpirtit m'i ka ra,
E ndëjt' me ditë e me net,
Lypte një flî, ti ishe tepër e brishtë
me u flijue,
e u flijova vetë.



Se vjen një orë e mbrame pa çudina,
një orë e mbrame si pyll i premë,
kur ujk të uritun të kthen vetmia,
e n'hanë të kujtimeve ulëron pa prâ.
(f. 174)

* * *

P ë r f u n d i m e

Poeti Arben Prendi vjen në poezi i formuar në arsimin filologjik; ai afrohet aq shumë me lëndën që i duhet një krijuesi në këtë fushë, sa na jepet të lëmë në hije talentin e tij të lindur, kur ka nisur të shkruajë, siç bëjnë jo pak admirues të artit në moshën e poezisë.

1. Ai doli në lëmë të poezisë në kohën kur liritë e krijimit jehuan pa kufij në botën e letrave të shkrimtarëve shqiptarë, të cilët po përjetonin çka kishin të ndaluar deri në vitet 1990.

2. Motivet e vjershërisë së A. Prendit janë po kështu të paskajuara: nisin me njeriun e brezit të tij, që duhej të thoshte fjalën e vet për këdo e për gjithçka, prandaj dhe poetika e këtij autori përmbledh jetën e gjerë kur po merrte një kthesë aq të vrullshme dhe shpesh të paorientuar.

3. Ai lëvront vjershërinë në standard, në variantin e zgjedhur të gegërishtes, por edhe me elemente nga dy dialektet, pa droje se po bën sakrilegj, ashtu si i vjen frymëzimi para fakteve që e shqetësojnë.

4. Në qendër të motiveve të poetikës së A. Prendit janë hijedritat e kohës nëpër të cilën kalon subjekti lirik por edhe banori i kësaj kohe, i vendit dhe i botës ku jetojmë. Ndërkaq këto motive përshkohen nga dy ndjesi: nga ndjesia e një parajse të humbur nga njeriu, s' dihet se kur

⁶⁷ Mahir Domi, Studime filologjike, Tiranë, 1984/4, f. 61, 65.

⁶⁸ Arben Prendi, Vepra poetike I, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 174.

dhe si, (ndjesi e cila e bën atë në vetvete të palumtur filozofikisht); dhe nga pikëllimi që buron nga vetë përkohësia e qenies.

5. Fakti që vjershërisë së këtij poeti, mund t'i bëhet një analizë gjuhe dhe stili deri në rrafshin e paraqitur këtu, tregon se ai është sot një nga emrat e njohur dhe më të realizuar të poezisë bashkëkohore shqiptare.

* * *

Bibliografi

- Arben Prendi, Tekste në kontekste, Shtëpia Botuese "Naimi", Tiranë, 2011.
- Linda Mëniku, Konektorët e tesktit në gjuhën shqipe, Albas, Tiranë, 2014.
- Ndre Mjeda, Vepra letrare I, Kombinati Poligrafik "Shtypshkronja e Re", Tiranë, 1988,
- Arben Prendi, Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia bashkëkohore - studime, Fiorentia, Shkodër, 2017.
- Arben Prendi, Vepra poetike-I, Fiorentia, Shkodër, 2018.
- Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I, Fiorentia, Shkodër, 2018.
- ASHR SH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe- II, Tiranë, 1997.
- ASHSH, Leksikografia shqipe-Trashëgimi dhe prespektivë, Tiranë, 2005.
- Ferdinand Leka, Fjalor i termave të letërsisë, Infobotues, Tiranë, 2013.
- Francesco Ferretti, Alle origini del linguaggio umano - Il punto di vista evoluzionistico, GLF Editori Laterza, Roma- Bari, 2017.
- Gero, Mina, Fjalori rimor i Dritëro Agollit", Toena, Tiranë, 2013.
- Gjergj Zheji, Bazat e vargëzimit shqiptar, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1988.
- Justin Rrota, Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
- Kolë Jakova, Fshati midis ujënave/ujërave, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1972.
- Lasgush Poradeci, Vepra letrare, Kombinati Poligrafik "Shtypshkronja e Re", Tiranë, 1990.
- Mahir Domi, Studime filologjike, Tiranë, 1984/4.
- Ndoc Gjetja, Biri i njeriut - Poezi të zgjedhura (Në dasmën e motrës), Toena, Tiranë, 2004.

- Stefano Telve, L'italiano: frasi e testo - Nuova edizione, Carocci editore, Bussole, S.p.A. Roma, 2013.
- Xhevat Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika, Albas, Tiranë, 2012.

▪ KRITIKË DHE STUDIME LETRARE ▪

Arben PRENDI


NDËRTHURJA E ELEMENTËVE KOMIKË E TRAGJIKË NË DRAMAT E STEFAN ÇAPALIKUT

Stefan Çapaliku (1965) vjen në dramën e pasrënies realizmit socialist në Shqipëri, si dramaturg me individualitet të spikatur dhe origjinal. Disa prej dramave të tij janë shfaqur disa herë brenda dhe jashtë vendit, si dhe janë vlerësuar me çmime letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Me dramat e tij të botuara më fillim të shekullit XXI dëshmon për një qasje serioze e të thelluar artit dramatik e teatrore, për një frymë e cila shquhet me origjinalitetin e perceptimit, vizionit dhe të modelimit krijues⁶⁹.

Përveçse janë luajtur në skenë këto drama janë botuar edhe si tekste letrare në formën e përmbledhjeve të tyre, si: “Pesë drama dhe një korn anglez (2004), “Utopos” (2004), “Allegreto Albania” dhe drama të tjera” (2006), “Pesë komedi të përgjakshme” (2010), “Tri drama” (2014). Me këtë rast, për shkak të mundësisë së kufizuar të një artikulli për të analizuar të gjitha dramat e autorit, janë zgjedhur disa drama të botuara në përmbledhjet “Pesë drama

⁶⁹Besim Rexhaj, Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore 1948-2008. Vëllimi II, Prishtinë 2009, f. 287.

dhe një korn anglez (2004) dhe “Tri drama” (2014).



Vlera e vërtetë artistike e dramës shpaloset në teatër, megjithatë teksti letrar i saj mbetet një element shumë i rëndësishëm i saj. Një nga veçoritë thelbësore të tekstit të dramave të autorit tonë, është ndërthurja mes elementëve komikë dhe tragjikë, madje mënyra se si realizohen këto ndërthurje e bëjnë këtë autor të dallueshëm nga dramaturgët e tjerë bashkëkohorë shqiptarë. Përmes kësaj ndërthurje, dramaturgu ka hyrë në thellësi dhe në gjerësi të problematikës komplekse të individit, familjes dhe shoqërisë shqiptare të tranzicionit dhe më tej.

Lidhjet paradoksale të elementëve tragjikë dhe komikë që krijojnë “humorin e zi”

Le t'i shohim më konkretisht disa raste të ndërthurjeve të përmendura. Kështu në dramën “Provat e një vdekjeje të paralajmëruar” situata, si pasojë e lidhjes paradoksale të elementeve tragjikë⁷⁰ dhe komikë, prodhon të ashtuquajturin “humor i zi”. Në skenë përshkruhet loja e aktorëve, të cilët interpretojnë tekstin artistik. Në tekstin artistik, personazhi kryesor Xhelal Dridha, ish-sigurims i regjimit komunist, i cili flet vetëm në fund, është duke vdekur. Situata është komike, por edhe tragjike për lexuesin, sepse një pjesë e aktorëve e lartësojnë figurën e ish-sigurimsit si njeri me ndjenja e me vlera të larta morale e profesionale, ndërsa po ata, kryesisht Kori tregon për të kundërtën, krimet dhe mizoritë e tij, si vegël qorre e regjimit, ndaj njerëzve të pafajshëm. Kulmi kuptimor dhe skenik, por edhe i paradoksit, është momenti kur thuhet se xhelati i djeshëm, ateist, e shumta me prejardhje nga një familje myslimane, në prag të vdekjes, thuhet se kërkon një prift, për të shfaqur pendesën e tij dhe ndërkaq një komision shtetëror ia beh për ta bërë shtëpinë e tij muze, duke konfiskuar shtëpinë dhe nxjerrë jashtë trashëgimtarët e tij. Merret vesh se vdekja e Xhelal Dridhës nuk ka asgjë tragjike, por tragjike është gjendja ku ndodhet shoqëria e cila, vuan sindromën e Stokholmit, të simpatisë ndaj xhelatit, por edhe të amullisë etiko-morale dhe ligjore ku ndodhet, vite pas rënies së regjimit komunist. Është e kapshme ironia e tekstit për këtë gjendje, e cila, në fakt na del sa komike aq edhe tragjike. Viktimat e Xhelal Dridhës duhet të nderojnë shtëpinë muze të xhelatit dhe publiku duhet të çlirohet emocionalisht nga pendesa hipotetike e xhelatit, pendesë e cila ngre lart vlerat e tij të presupozuara. Teksti krijon asosacione me gjendjen kaotike të tranzicionit, ku shumë gjëra kanë humbur kuptimin e mëparshëm dhe nuk kanë fituar ende të riun. Edhe në replikën që mbyll dramën, aktori që luan personazhin Xh. Dridha, pasi kërkon regjisorin që nuk i ka dhënë udhëzimet e duhura si duhet ta luajë momentin e vdekjes, provokon lexuesin/publikun: “Si vdiset? Më thoni ju. Si vdiset? Si do ju pëlqente që të vdes?! Këtu askush nuk të tregon si vdiset. Kulmi! Ky është një vend i çuditshëm... Askush nuk thotë se si... E pra... kjo punë vetë nuk bëhet...”⁷¹. Si do të na pëlqente një xhelat, një persekutor?! Pyetje e vështirë për lexuesin dhe për publikun duke pasur parasysh se një pjesë e mirë e publikut e ka provuar në kurriz dhunën e sivillezërve të tij.

Edhe në tekstin tjetër “Fausti prej Tirane” mbizotëron gjendja tragjike, por nuk mungon komikja që lind nga paradoksi. Fausti mediton për vdekjen e Margaritës, por edhe për vdekjen e tij hipotetike ndërmjet viteve kur po binte Muri i Berlinit, në Evropën Lindore. Vdekja e saj

⁷⁰ Për kuptimin e termave “tragjik” dhe “komik” në literaturën në gjuhën shqipe u jemi referuar shpjegimeve të tyre në: Çausi, Tefik. *Fjalor i estetikës*. Tiranë 1998, “komikja” f.201-203; “tragjikja” f. 366-367; Leka, Ferdinand. *Fjalor i termave të letërsisë*. Tiranë 2013, “komik”, f. 208; “tragjik f. 398-399.

⁷¹ Çapaliku, Stefan. “Tri drama”, Prishtinë 2014, f. 66.

është pasojë e jetës në regjimin komunist, por edhe disa vetëvrasje të disa njerëzve të njohur të kulturës shqiptare që paraqiten në vijim, janë pasojë e jetës nën regjimin komunist dhe në shoqërinë e tranzicionit. Përballë tragjicitetit të këtyre akteve, reagimi i mjedisit është komik dhe hipokrit. Vetë Fausti vuan nga kjo gjendje tragjike: “Dhe mua tanimë nuk më duhet një motiv i përshtatshëm për të jetuar. Mua më nevojitet një motiv i shëndetshëm për të vdekur”⁷². Fausti i trembet pyetjes që e shpreh Mefistofeli: “Si keni duruar? Si ia keni dalë të duroni?”⁷³. Kjo pyetje shpreh thelbin tragjik të të jetuarit të shoqërisë shqiptare nën diktaturën komuniste. Zgjidhjen për këtë pyetje e gjen tek vdekja, me qëllim që t’i shmanget asaj: “Nuk ka mbetë gjë tjetër përveç vdekjes, që të paktën ata që do të vijnë pas nesh të mos na thërrasin aq kollaj fajtor”⁷⁴. Në këtë gjendje të fajit tragjik si durues i të jetuarit nën regjimin komunist, hyn episodi komik me një ish-student të Faustit që e njofton se në pamundësi të gjejë vendin e tij në shoqëri ka vendosur të bëhet politikan. Ky lajm e hidhëron Faustin dhe i shkruan një letër të gjatë për t’i vënë në dukje se çfarë tjetërsimi do t’i ndodhë atij nëse i hyn kësaj rruge, ndaj e këshillon të ndjekë rutinën e përditshme të jetës: “Mjaft! Marin! Lëri budallallëqet. Thjesht kthehu...Kthehu te dhjetë punët e tua të përditshme: Kthehu te rutina e lumtur”⁷⁵. Situata tragjikomike rikthehet përsëri në fund të dramës ku Fausti besoj shpreh gjendjen pa rrugëdalje dhe tragjikomedinë e njeriut të kulturës dhe ideve por edhe të mjedisit: “Ky vend nuk e meriton që ne të jemi, por ky vend nuk bëhet hiç më i mirë nëse ne ikim. Të nesërmen e ikjes tonë heroike të gjithë do vazhdojnë jetët e tyre të zakonshme. Ne e kemi humbur shansin të jemi shembuj”⁷⁶.

Ndërkohë në tekstin “Një zjarrfikës në oborrin e teatrit” na shpaloset ana komike dhe tragjike e jetës së një aktoreje të shpërfillur nga regjisorët e teatrit, por edhe nga burrat që dikur e dashuronin. Në monologët dhe dialogët e saj ajo shpreh shqetësimin për humbjen e seriozitetit të teatrit, në një kohë kur publiku kërkon pjesë vetëm për të qeshur pa menduar: “...Përfundimisht. Tanimë më duket më i pashpresë se kurrë. Dikur edhe luhej ndonjë gjë tjetër, si tip drame, për shembull. Jo të gjithë kishin nevojë atëherë për t’u zgërdhirë. Dikush kishte ende nevojë të mendonte. Të shkretët aktorë, u kthyen në lolo, arlekinë e kllounë”⁷⁷; nga ana tjetër vuan për faktin se ka mbetur e vetme dhe sepse kujton premtimet e shumë burrave për ta kaluar jetën me të, por në fakt ata janë zhdukur të gjithë nga jeta e saj: “E lanë të gjithë për më vonë sepse... sepse... aso kohe të gjithë ishin të zënë. Njëri ishte pak i sëmurë, tjetrit i duhej të

⁷² Çapaliku, Stefan. “Tri drama”, Prishtinë 2014, f. 85.

⁷³ Po aty, f. 86.

⁷⁴ Po aty, f. 87.

⁷⁵ Po aty, f. 83.

⁷⁶ Po aty, f. 91.

⁷⁷ Po aty, f. 97.

kthehej në atdheun e vet, një tjetër që i martuar, dikush ishte shumë më i ri se unë, një tjetrit ashtu i doli një punë e kështu me radhë”⁷⁸. Komike dhe tragjike është kriza e teatrit, por komike dhe tragjike është edhe hipokrizia dhe humbja e vlerave etiko-morale të mjedisit ku femra jeton. Madje për këtë, fajtor është edhe raporti tragjik që mjedisi ka me të bukurën, e përdor atë, por nuk e do mirëfilli dhe bukuria “ofrohet si një mall i ngjashëm me të tjerët”⁷⁹. Meqenëse teksti lidhet me veprimet që zhvillohen në skenë edhe përzierja e teksteve nga tragjeditë e Eskilit, Aristofanit, Euripidit, por edhe të përshkrimeve për Hitlerin dhe gruan e tij, nxjerr në pah përsëritjen e dramave dhe çmendurive të jetës njerëzore, në kohë e rrethana të tjera. Fragmentet në fakt janë tragjike në vetvete, por këtu rezultojnë komike. Në raste të tjera dialogët janë komikë në vetvete, por tingëllojnë tragjikë në kontekstin e përgjithshëm të dramës, si në këtë rast: “Antoni: Akti i fundit po luhet ngado. Jo vetëm këtu. Ne jemi aktorët e aktit të fundit”⁸⁰. Nënteksti i frazës më sipër është i dekodifikueshëm në disa shtresa kuptimore: akti i fundit, pjesa e fundit e veprës; akti i fundit, fundi i një shoqërie; aktorët e fundit, aktorët që flasin në fund të aktit, pjesëtarët e një shoqërie në grahmat e fundit etj. Aktorët fantazojnë për një teatër të ri që mund të ndërtohet vetëm duke djegur të vjetrin dhe se rolin e zjarrvënësit mund ta luajë zjarrfikësi, i cili vjen në çdo shfaqje teatrale, por zjarrfikësi preferon të jetë thjeshtë një spektator i zjarrit, domethënë, të mos veprojë për ta fikur, por as për ta ndezur atë. Situata bëhet edhe më tragjike dhe komike në fund të veprës ku aktorja e vetmuar dhe një aktor tjetër pohojnë tragjikomedinë e jetës së tyre, por edhe të mjedisit ku jetojnë, dyzimin dhe tjetërsimin e pësuar: Aktorja pohon se “unë jam maska” dhe se po vdes, por don të vdesë si njeri dhe don të luajë vetveten⁸¹ ndërsa aktori pohon se ka pasur një maskë për në shtëpi, një për në punë, një në shoqëri⁸² etj. Në skenën e parafundit Arturio, aktori, përpiqet t’ia shkulë maskën nga fytyra aktorese por nuk ia del dot, dhe ajo i kërkon lëpirësen që Arturio e mbante në xhep që në skenën e parë, bashkë me një pistoletë me mulli, me të cilën mund të luhet “ruleta ruse”. Aktorja ngatërron qëllimisht emrin e kobures me atë të lëpirëses, dhe më pas rrotullon mullirin ia shkrep vetes në ballë, dhe vdes. Edhe në këtë rast ka ndodhur kapërcimi nga komikja në tragjiken.

⁷⁸ Po aty, f. 98.

⁷⁹ Po aty, f. 101.

⁸⁰ Po aty, f. 138.

⁸¹ Po aty, f. 147.

⁸² Po aty, f. 148.



Shoqata e shqiptareve të Zagrebit "Drita" dhe Biblioteka Qendrore Shqiptare e Kroacisë organizojnë "Mbrëmje letare, me pjesëmarrjen e shkrimtarit të mirënjohur shqiptar:

Stefan Çapaliku

ditën e hënë, me 30 tetor, ora 18,30, në Bibliotekën e qytetit, Trg Ante Starčevića 6, Zagreb

Aktiviteti mbështetet nga:
Ambasada e Republikës së Shqipërisë,
Këshilli për pakicën kombëtare të RK;
Savjet za nacionalne manjine RH

Parodizimi i rrethanave absurde të ekzistencës

Në tekstin "Tri këngë dashurie" në tre akte, rrëfhet jeta e një çifti në tri periudha moshore. Në aktin e parë, dy të rinjtë Adriani dhe Eliza i rrëfejnë njëri-tjetrit, ëndrrat dhe ndjenjat e tyre. Ata gjejnë strehë tek njëri-tjetri dhe ëndërrojnë derisa bëhen komikë, me përshkrimet e ndezura, të tepruara dhe jashtë mundësive të tyre për jetën reale: "Adriani: Ah

shtëpia! Do të jetë me dritare të mëdha. Dritaret e mëdha do i bëj që të hyjnë shkrepimat e rrufeve. Kurse ne do rrimë në katin përdhes, aty ku do të jetë oxhaku dhe do shtrihemi bri tij, në dysHEME. Nuk mund të shtrihemi në studio, aty ku vetëtimat do i ndriçonin muret aq sa ta shohim veten si në radiografi”⁸³. Adriani i premton Elizës një shtëpi ëndrrash dhe së bashku plotësojnë detajet e kësaj ëndrre që në aktin e dytë marrim vesh se nuk është ndërtuar as në moshën dyzet vjeçare, madje as në aktin e tretë kur personazhet janë në moshën 60 vjeçare. Situata përmbysset në aktin e dytë duke u bërë tragjike. Adriani është i sëmurë për vdekje dhe nuk ka mundur të ndërtojë as shtëpinë e ëndërruar. Megjithatë edhe pse shtëpia nuk është ndërtuar ata grinden për detaje që i kanë ëndërruar më parë, por tani i mendojnë ndryshe dhe situata bëhet në këtë debat edhe më tepër komike, sepse personazhet janë ende në rrafshin e fjalëve dhe jo të veprimeve konkrete, por befasisht situata bëhet përfundimisht tragjike kur Adriani i rrëfëhet Elizës se ai e ka kuptuar me kohë tradhëtinë e saj me dikë tjetër. Kjo është pjesa më tragjike që shënon fundin e iluzioneve për jetën në çift. Pra magjia e jetës është prishur përfundimisht, shtëpia e ëndërruar nuk është ndërtuar, Adriani është i sëmurë për vdekje, shpallet tradhëtia e Elizës, por edhe Adrianit i cili, është marrë më shumë me veten e tij sesa me gruan e tij, dhe në aktin e fundit, drama përfundon vërtetë si tragjedi me vrasjen e Elizës nga Adriani. Nga ana tjetër vepra del si parodizim i trishtueshëm i rrethanave absurde të jetës njerëzore dhe i kthesave të papritura të saj.

Në “Ftesë për darkë” elementet komikë me atë tragjikë ecin paralelisht. Marku me bashkëshorten Anën, si dhe Ludoviku, janë ftuar në një darkë, në kullë, me rastin e datëlindjes së të zotit të shtëpisë, i cili del se feston 600 vjetorin e tij. Ai duket se është vetë historia dhe fisi i mbyllur në kullë. Diçka enigmatike ndodh ndërkohë përjashta e shoqëruar me drita të fuqishme dhe të frikshme. Të ftuarit nuk guxojnë të dalin nga kulla, ndërsa brenda hyn i paftuar edhe një djalë i ri, i cili, nga pshtjellimi ka humbur edhe të fejuarën e tij. Edhe këtu situata nga komike e parodike: gostia dhe rrëfimet e 600 vjeçarit për fisin dhe kullën; bëhet befasisht tragjike: personazhet nuk guxojnë të dalin më përjashta, provojnë, por kthehen përsëri në kullë nga frika. Mund të fantazojmë se jashtë është duke ndodhur një revolucion i furishëm, sepse djali flet për njerëz të plagosur dhe viktime. Personazhet aludojnë se diçka po ndodh, diçka po fillon, po vijon ose po mbaron: “I zoti i shtëpisë: Marrina! Këtu as po mbaron e as po fillon gjë. [...] Këtu gjithçka vazhdon. E kuptuar? Këtu gjithçka vazhdon”⁸⁴. Ata janë të mbrojtur në kullë, por nuk mund të rrinë pafundësisht aty sepse do të vdesin urie. Lexuesi dhe spektatori me siguri

⁸³ Çapaliku, Stefan. “Pesë drama dhe një korn anglez” Tiranë 2003, f. 15.

⁸⁴ Po aty, f.51.

e kanë të vështirë të kuptojnë se çfarë ndodh jashtë, por kuptojnë se çfarë ndodh brenda kullës. Ana, gruaja e Markut dhe djali i ri që ka humbur të fejuarën guxojnë të dalin jashtë, andej nga kanë hyrë, por nuk dihet më për fatin e tyre. Ndërkohë është zbuluar se kulla ka edhe një dalje tjetër, e cila, nuk ka kthim pas dhe as nuk dihet se ku të çon. Në këtë situatë pa rrugëdalje vetëm Marku, i cili, gjatë gjithë kohës pi alkool, merr guximin të zhduket nga dera pa kthim dhe me destinacion të panjohur, kurse Ludoviku futet mes spektatorëve. I zoti i shtëpisë deklaron se ata mund të rrinin fare mirë aty në kullë dhe në “mungesë të ushqimit të hanin njëri-tjetrin”, deklaratë që merr trajta të “humorit të zi” dhe tragjikes për të shprehur ato rrethana absurde dhe pa rrugëdalje, të cilat, jo rrallë i kanë çuar shoqëritë njerëzore drejt krimesh monstruoze⁸⁵. Siç shprehet me të drejtë studiuesi Gëzim Puka, në këtë tekst të Çapalikut, shprehet situata paradoksale e shqiptarit të fshikulluar në rrjedhën historike, qoftë si individ, qoftë si etni. Në secilin prej diskurseve të personazheve duket njeriu i topitur, të cilit i është vrarë liria, madje edhe vizioni për lirinë⁸⁶.

Demitizimi i miteve tragjike përmes këndvështrimit komik

Në dy dramat “Kulla e Babelit” dhe “Utopos” demitizohet miti tragjik i flijimit të njeriut, përmes këndvështrimit komik.

Elementet komike ndërthuren me ato tragjike në dramën “Kulla e Babelit”, që ka në qendër mitin tragjik të flijimit të njeriut në themelet e një ndërtimi të ri, në fakt mitin e përmbysur⁸⁷ dhe të lidhur me mitin dhe personazhe biblike. Arkitekti dhe mjeshtrat po ndërtojnë Kullën e Babelit, mirëpo kanë vendosur kundër ligjit të gravitetit që themelin e saj ta vendosin në qiell, ndërsa muret të zbresin nga lart. Situata bëhet menjëherë tragjike kur gurët pasi qëndrojnë pak në re bien sërish përtokë dhe lind kërkimi absurd për të gjetur shkakun e rënies së gurëve të themelit, shkak i cili lidhet me nevojën për të bërë një theror, një fli njerëzor si në legjendat e flijimit. “Projekti i ndërtimit të kësaj kulle të mirëkuptimit dhe të lumturisë, është një projekt i çmendur, i ngjashëm me projektin e ndërtimit të komunizmit”⁸⁸.

Fajësojnë Judën për pengim të punimeve, një nga mjeshtrat, dhe e shpallin “qingjin e flijimit”⁸⁹. Në kulmin e tragjizmit kur diskutohet për ekzekutimin e Judës, ndërhyt “humori i zi”, tallja me viktimën: “Arkitekti: Ne fundja po e nderojmë atë. Gjaku i tij do të qëndrojë ndër

⁸⁵ Po aty, f. 63.

⁸⁶ Çapaliku, Stefan. “Pesë drama dhe një korn anglez” Tiranë 2003, f.136.

⁸⁷ Puka, Gëzim. Në kërkim të një drame ndryshe. Ulqin 2017, f.50.

⁸⁸ Puka, Gëzim. Në kërkim të një drame ndryshe. Ulqin 2017, f. 50

⁸⁹ Çapaliku, Stefan. “Pesë drama dhe një korn anglez” Tiranë 2003, f. 85.

themelet e kësaj kulle, ai do të bëhet qumështi i Perëndisë. E kuptoni çfarë nderi do t'i bëjmë? PUNËTORI I: *Po ai ndoshta nuk e meriton gjithë këtë nderim, Arkitekt? [...] Arkitekti: Mos ndoshta dëshiron ndonjë prej jush ta ketë këtë nder?*"⁹⁰. Juda ekzekutohet nga kryemjeshtri sepse thotë të vërtetën për kotësinë dhe mbrapshtinë e ndërtimit të Kullës së Babelit. Juda ekzekutohet, por kthehet në një fantazëm që i çmend mjeshtrat, punëtorët dhe Arkitektin që ndërsa flenë shohin ëndrra sikur Kulla ka mbërritur te Zoti, por në skenë bie përsëri nga lart guri i hedhur për themel. Komike dhe tragjike është përpjekja për të ndërtuar një kullë deri tek Zoti, madje me themele lart, si të gjitha punët e mbrapshta të njerëzimit, por edhe të shoqërisë shqiptare. Tragjik është flijimi i Judës në themelet e një pune të mbrapshtë, por komik dhe tragjik veprimi i Arkitektit për t'i vënë themelet në hiç. Në mitin biblik kryqëzohet Krishti, ndërsa në mitin artificial të autorit, kryqëzohet Juda, pra tradhëtari të miti biblik⁹¹, bëhet heroi e martir këtu.

Mitin e ndërtimit të kullës e gjejmë edhe në dramën tjetër "Utopos"⁹² ku elementi tragjik është primar dhe ai komik sekondar. Drama është në analogji me (mitin e flijimit në kështjellë) baladën e muosjes së një nuseje të re në kështjellë. "Në dramën "Utopos" të dy planet tematike: miti origjinal që jepet përmes ndërtekstorisë së legjendës së muosjes dhe miti artificial (i paraqitur qoftë edhe me emrat e personazheve apo me vazhdimin e ngjarjes pas muosjes) nuk pëlqehen dhe përplasen me njëri-tjetrin"⁹³ Utopos dhe vëllezërit e tij Moshe dhe Krispi në përpjekje për të ndërtuar kështjellën që ndërtonin ditën dhe shembej natën, në fakt kanë bërë një krim të shëmtuar, kanë muosur nusen e Utoposit. Një komisar policie heton për krimin dhe fajëson Utoposin, i cili, sikurse vëllai i vogël i baladës nuk i ka treguar nuses së tij për atë që do t'i ndodhë. Përmes një humori të zi vihet në dyshim vetë dobia e kështjellës, e cila, vërtetë ishte ngritur për t'i mbrojtur njerëzit, por paradoksalisht kishte sjellë më shumë vdekje dhe luftëra. Heroika e ndërtimit të saj shkatërrohet në disa dialogë dhe kthehet në komike. Përfundimi i sugjeruar: do të kishte qenë më mirë që fortesa të mos ishte ndërtuar, gruaja e Utoposit do të ishte gjallë, dhe të gjithë ata që kishin luftuar për ta mbrojtur apo për ta rrënuar, do të ishin gjallë. Komisari, që më vonë, merret vesh se është një grua, arreston Utoposin si shkatëtarin e vrasjes së gruas së tij, por edhe si helmues i të tjerëve me ëndrrat e marra për një fortesë madhështore që duhej ndërtuar me çdo kusht, për të ruajtur traditën dhe

⁹⁰ Po aty, f. 85.

⁹¹ Puka, Gëzim. Në kërkim të një drame ndryshe. Ulqin 2017, f.52.

⁹² Çapaliku, Stefan. "Pesë drama dhe një korn anglez" Tiranë 2003, f. 95.

⁹³ Puka, Gëzim. Në kërkim të një drame ndryshe. Ulqin 2017, f.68.

të kaluarën e lavdishme prej të cilave ka mbetur një piring rrënojash. Ëndrra e Utoposit për fortesën merr nuanca tragjike dhe komike.

Detaje komike dhe tragjike nga rëndomtësia e të jetuarit

Komiken dhe tragjiken autori i gjen edhe në detajet më të rëndomta të jetës së përditshme si në tekstin “Këpucët”⁹⁴. Zonjusha Ana blen një palë këpucë shumë të shtrenjta jashtë serie dhe jashtë mundësisë së saj ekonomike. Blerja dhe motivi i blerjes, (për të qenë vetë ajo jashtë serie dhe unike), janë komike, por kanë edhe anën e tyre tragjike. Këpucët e shtrenjta dhe jashtë serie, pra unike, janë bërë me lëkurën e një viçi 20 kg, apo në raste të tjera me lëkurën e një qingji që është ende në barkun e nënës. Për të bërë këto këpucë duhen ekzekutuar dhe rrjepur këto kafshë të pafajshme. Në fakt, këpucët mbeten pa veshur sepse zonjusha Ana nuk e ka gjetur ende princin e saj të kaltër dhe nuk mund të shkojë e vetme në ndonjë ballo. Këpucët qëndrojnë në kuti ku dialogojnë me njëra-tjetrën dhe vendosin të ikin, por Ana i kërcënon se do t’i vrasë me thikë, kështu që detyrohen të pranojnë fatin e tyre, të qëndrojnë në kuti, me shpresën se Ana do t’i veshë ndonjë ditë.

Përfundime

Dihet se elementet komike dhe tragjike janë të pranishme në dramën bashkëkohore, por në tekstet e dramave të S. Çapalikut ato kanë rol kryesor në ndërtimin e situatës dhe atmosferës dramatike. Komikja në këto tekste realizohet shpesh përmes ironisë, sarkazmës dhe paradoksit, ndërsa tragjikja përmes të ashtuquajturit “humor i zi”. Tragjikja shpesh buron papritur, dhe menjëherë nga situata komike, por edhe komikja shpesh lind në kulmin e situatës komike. Kuptohet këtu nuk bëhet fjalë për kategoritë estetike klasike të komikes dhe tragjikes, ku ose përqeshet ose konflikti zgjidhet me vdekjen e heroit ose heronjve, por është fjala për ndërthurje të tyre, në tërësinë e tekstit. Për më tepër në këto tekste nuk kemi konflikt klasik që duhet të zgjidhet mes personazheve, konflikti i përket më tepër pjesës së nëntekstit sesa pjesës së veprimit, aksionit. Komikja dhe tragjikja të lidhura përmes paradoksit punojnë në nëntekst dhe në vetëdijen e lexuesit për të dhënë, së pari, një reflektim të lexuesit mbi gjendje, dukuri sa individuale aq edhe shoqërore në tërësi dhe gjendje të shoqërisë shqiptare gjatë periudhës në vijim të tranzicionit. Madje, për paradoks, elementi komik nxjerr më në pah elementin tragjik

⁹⁴ Po aty, f.129.

dhe elementi tragjik thekson edhe më tepër elementin komik. Madje kemi edhe fragmente tekstesh që në vetvete janë tragjike, por si pjesë e kontekstit të veprës tingëllojnë komike. Anasjelltas fragmente tekstesh që në vetvete janë komike, por në kontekstin e veprës dalin tragjike. Në disa prej këtyre teksteve autori luan me “dramën brenda dramës”. Aktorët luajnë tekstin e dramës, por edhe përjetojnë dyfish: si personazhe letrare dhe si aktorë/intepretues të tekstit të saj.

Edhe në fjalorin e këtyre teksteve, fjalët që përsëriten më së shumti janë: “e tmerrshme”, “e frikshme”, “tallje”, “përqeshje”, “komedi e përgjakshme”, “tragjike” “vdekje”, madje edhe ngjyrat që vihen në dukje për dekorin e dramave janë e bardha dhe e zeza; që shënojnë më tepër mbitheksimin e krizës së individit dhe shoqërisë sesa diçka vërtet të tmerrshme që ndodh gjatë aksionit.


Bibliografia:

- Çapaliku, Stefan. *Pesë drama dhe një korn anglez*. Tiranë 2003.
- Çapaliku, Stefan. *Tri drama*. Prishtinë 2014.
- Çaushi, Tefik. *Fjalor i estetikës*. Tiranë 1998.
- Rexhaj, Besim. *Drama Shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore 1948-2008*. Vëllimi II, Prishtinë 2009.
- Puka, Gëzim. *Në kërkim të një drame ndryshe*. Ulqin 2017.
- Leka, Ferdinand. *Fjalor i termave të letërsisë*. Tiranë 2013.

Dr. Ermira ALIJA

PËRBALLJA ME TË SHËMTUARËN NË ROMANIN “ZAMBAKU I KANIONIT”

“Zambaku i kanionit” romani i dytë e autores Eralda Baze, botimet Schnell 2023



“Zambaku i kanionit” është titulli i romanit të dytë të Eralda Bazes, që u promovua ditën e mërkurë, më 15 nëntor, nga Departamenti i Letërsisë i Universitetit të Shkodrës, në bashkëpunim me Bibliotekën Shkencore Universitare dhe botuesin Schnell.

Ky roman u shkrua një vit pas romanit të parë: “Dielli më perëndon në lindje”. Autorja erdhi përsëri pranë Departamentit të Letërsisë të Universitetit të Shkodrës për të ndier reagimin kritik mbi librin e saj të dytë.

U ndiem shumë mirë edhe me zgjedhjen e Eraldës për të riardhur në Shkodër, gjë që tregon kurajo dhe dëshirë të saj për t'u përballur, por, edhe me faktin që romani "Zambaku i kanionit" shënon një rritje të dukshme cilësore në krahasim me librin e parë.

Kam bërë një shkrim edhe për romanin e parë të Eraldës, po te Gegnia, dhe, nëse kjo ngjitje në romanin e dytë, sado pak, do i atribuohet edhe rolit të kritikës (as komformiste, as mbyhtëse) edhe të Universitetit, do të ndjehesha mirë. Pavarësisht kësaj, mendoj se Eralda është autore që ka kurajo dhe zemër. Ajo vazhdoi të trajtojë temën e realitetit të sotëm edhe në romanin e dytë, gjë që ishte një mundësi kurthesh për të. Por përballja me kurthet dhe tejkalimi i tyre e rritën profesionalisht autoren. Lirizmi i saj në këtë roman të dytë, nuk është i pakomanduar, por i drejtuar dhe i drejtpeshuar në funksion të strukturës në tërësi. Ai shënon një linjë që vendoset në roman për të pasqyruar ndjesi, mendime e kujtime të pakontrolluara; kjo linjë shënohet me korsiv dhe ka disa funksione.

Ideja e të përballurit me të shëmtuarën e realitetit bën që shkrimtarja të kapë shumë detaje nga jeta, gjë që duket si nxjerrje në pah e llumit që shoqëria ka prodhuar dhe nxjerrë përsipër nga shkundjet e përzierjet që i kanë ndodhur. Gënjeshtria dhe demagogjia, të kthyer në system, janë treguesit e lëngatës së shoqërisë. Fjalori është në funksion të kësaj paraqitjeje, që pothuajse të lodh.

Por ndoshta kjo shënon pikën kulmore. Ndoshta duhet të arrihet kulmi i së keqes, për të ndodhur kapërcimi.

Lili, personazhi kryesor i romanit, bën tre kapërcime, që shprehin edhe nyje kompozicionale:

1. Kapërcimi i parë është kur nuk pranon të marrë pjesë në projektin që do të prishte ujëvarat e Osumit. Për këtë e dinte që do të humbiste punën. Dhe e humb me vetëdije të plotë. Kapërcen, apo tejkalon veten në dëshirat materiale për jetesë.

2. Kapërcimi i dytë është edhe më i vështirë. Lili mëson të dojë vajzën e të shoqit me shembrën e saj.

...Sytë e Gentit mbi fytyrën vezake të vogëlushes nuk e trazojnë më. Nuk i kujtojnë më tradhtinë...

...Asnjë pabesi e të rriturve nuk të pengon dot të duash një kërthi të tillë, që luan e qesh në prehrin tënd...

3. Kapërcimi i tretë nuk është vetëm ndryshim brenda vetes së saj, por edhe në reagim në raport me të tjerët. Lili përdor thikën. Ajo nuk lejon Nikun të vrasë. Lili reagon, ndryshimi nuk mbetet te vetja e saj.

Kapërcimi i Lilit ndodh se ajo kultivon me vetëdije dhe pavetëdije të mirën e fjetur tek vetja, që i zgjohet nga:

- Takimi me Jenin, që përfaqëson traditën e mirë dhe i nxjerr Lilit besimin e zhytur thellë në veten e vet:

...Domethënë, edhe një kaçak i pagdhendur njëqind e kusur vjet më parë, paskësh qenë njëqind herë më fisnik se këto burrat e sodit....

Jeni e do jetën dhe kapet fort pas fuqisë ripërtëritëse që mbart vetë jeta në thelbin e vet.

...Kjo ishte mantra e saj universale përballë çdo dhimbjeje, çdo rreziku...Mjaltë e qumësht! ...sa herë jeta bëhej e hidhur...

Takimi me Jenin i përtërin Lilit shpresën. Lili i rikthehet jetës me qasje tjetër, fillon të masë jetën me kutin e Jenit.

-Takimi me natyrën e virgjër, të paprekur, duket se i tregon Lilit vetë mrekullinë e Zotit.

-Takimi fizik me tyrben e Baba Aliut dhe Kishën e Shën Triadhës kthehet në një takim shpirtëror me mistikën.

- Takimi me vajzën, që përfaqëson pafajshmërinë, edhe pse e lindur nga “faji”, e mëson Lilin ta dojë jetën edhe pa kuptuar çmendurinë e saj.

...Nuk dihet pse vogëlushja nuk e merr asnjëherë seriozisht zemërimin e Seferit, jo që nuk e frikëson, por e bën për të qeshur...

Raporti me vajzën e mëson të çmojë gjërat e vogla të bukura:

...Herë pas here e nxjerr kokën nga kapuçi për t’u siguruar që i ka ende nëpër flokë fjongot e kuqe...

Gjithë këto elemente të subjektit e veshin strukturën kompozicionalisht. Lavdërimi që i bëjnë tre gratë Shën Kozmait, Abaz Alisë apo Krishtit, teksa shohin ujëvarën e mrekullueshme, është një detaj i subjektit që shënon edhe rritjen strukturale. Natyra me përsosmërinë e vet bëhet simbol i qëndresës mbi të keqen që “*vjen me fytyrë njeriu*”.

Gjithë struktura e romanit sjell përballjen me të keqen, për të përgatitur finalen: kundërveprimin ndaj saj. Lili kupton vrasjen që kanë bërë njerëz si Rafeti që, *megjithëse ishte pa shkollë, ... ishte mjeshtër për me e kthye një njeri në hiç*.

E shëmtuara për t’u bërë kategori artistike ndoshta don pak Zotin brenda, qoftë edhe si transhëndencë. Romani nuk ka *happy end*, por ka shpresë. Nuk mbyt, por përkundrazi, kërkon parametra metafizikë për t’iu kundërvënë të keqes dhe kompromisit me të:

... Dikush do të vdesë... Të tjerë do të ndëshkohen... Jeta do të mbyllë një cikël dhe do të fillojë një të ri, si gjithmonë...

Edon BUSHAJ

NJË VËSHTRIM MBI ROMANIN “KORRIDORET E GJELBRA” TË AGIM GJAKOVËS


Agim Gjakova është një nga shkrimtarët më të mëdhenj shqiptarë në trojet shqiptare. Krijimtaria e tij shquhet për vlerat artistike që sjell në letërsinë shqipe për paraqitjen e njeriut dhe ambientit të vendlindjes së tij, mbarështimin e temave, vizionin artistik, formatimin e personazheve, ndërtimin kompozicional të veprave në prozë, për gjuhën e pasur dhe të veçantë nëpërmjet së cilës autori e krijoi perandorinë e tij letrare.⁹⁵

Por çfarë e bën të veçantë këtë roman dhe cili është qëllimi i këtij studimi? *Arsyeja është befasimi aq i këndshëm që përjetojnë lexuesit nga stili dhe formësimi gjuhësor që përcjell shkrimtaria e këtij mjeshtri.*

Agim Gjakova shquhet sidomos për njohje të mjeteve shprehëse, të cilat, të përdorura prej tij me fantazi krijuese, në përputhje me rrethanat, përmbajtjen dhe idetë, fitojnë zhdërvjelltësi dhe vlera të reja artistike e stilistike. Gjuha e këtij autori dallohet për mënyrat e veçanta të kumtimit. Ai është shkrimtari që e zgjedh mirë fjalën, në përshtatje me idetë e veprave që krijon, por edhe e peshon, e mat mirë atë, duke ia gjetur vendin me dorë të sigurtë në frazat e tij, kryesisht të mesme rrallë e tek të gjata, kurrë të stërgjatura.

⁹⁵ Titujt e veprave letrare gjenden: <https://www.shkodraweb.com/personazh-agim-gjakova-shkrimtari-dhe-skenaristi-i-perndjekur-ne-kosove-dhe-ne-shqiperi/>.

KORRIDORET E GJELBRA
KORRIDORET E GJELBRA
KORRIDORET E GJELBRA
KORRIDORET E GJELBRA



Romani “Korridoret e gjelbra” është konceptuar nga autori në tërësinë e tij si një enigmë, e cila ka mbërritur për t'u gjykuar dhe vlerësuar nga lexuesi mbi bazën e fakteve dhe hamendjeve të supozuara. Po si e realizon autori këtë proces enigmatik?

Në roman është e pranishme enigma, madje romani është i ndërtuar pikërisht sipas këtij koncepti. Zgjidhje të enigmës përfundimisht nuk ka, ndërsa që vetë enigma bëhet motivueshëm dominantja letrare e strukturës së veprës. Kështu fillon ngjarja, hulumtimi i fakteve, dëshmive dhe rindërtimi i ndodhive.

Një ndër figurat më të rëndësishme trajtohet **apoziapeza** e cila është ndërprerja e zhvillimit sintaksor të pritur, e paraqitur tipografikisht me pika heshtjeje; këtu fjalia mbetet e papërfunduar” Kjo siç shprehet Galperin është “mekanizmi sintaksor stilistik më i mirë për përcjelljen e emocioneve të forta”(Stylistics f. 236). Kjo dukuri është përdorur me mjaft efekt gjatë gjithë romanit.

*...Në mendje, në kujtesë, në ...freskinë e shpirtit! Oha! E mbylli njërin sy..e hapi...
Po e përmbys botën.....Po Vizaton kodrat, poi rrëpirë rrafshet po e spërdredh qiellin... (F.5).*

- *Si? Nuk ... nuk... Më thuaj si? – Arsa u turbullua. Ylli ia kuptoi tronditjen.*
- *Ishte vajza e Lekës dhe ..., -ai heshti se Arsa u tkurr. – Megjithëse dy vite më poshtë, mbaruam të njëjtin gjimnaz. (f. 77).*

Ky pushim i papritur na fokuson vëmendjen se çfarë është lënë pa thënë. Kështu që raporti se çfarë është thënë e çfarë është e re bëhet më shprehëse, domethënëse duke rritur shkallën e enigmës.

Teknikë shprehëse sintaksore e përdorur mjeshtrisht në roman është **fluksi i ndërgjegjes** “... konsiston në përshkrimin e drejtpërdrejtë dhe të lirë të ideve dhe ndjenjave, që nxisin në thellësi personazhin e një romani dhe që plotësohen sipas një kriteri që respekton procesin real të mendimit, për të cilin nuk nxirren lidhje logjike në ideimin dhe shprehjen, dhe vepron kështu për shoqërizime të lira të figurave në bazë të analogjisë.” Kjo teknikë narrative letrare e përdorur me nga autorët e mëdhenj Xhojsi, Kafka, etj dominon në këtë roman ku vendoset në plan të parë individi me konfliktet e tij të brendshme, emocionet, ndjesitë dhe pasionet e tij.

Karakteret paraqiten kontradiktore dhe me arsyeime herë herë të paorganizuar në mendjen e njeriut derisa konturojnë hamendësimet e sjelljes sipas një morali që është e kundërta e të përgjithshmes.

E kuptova që kjo më erdhi nga përpjekja të gjeja shkakun se përse e kisha nisur atë vartës të vëzhgonte mbesën. Mbesa, i vetmi fëmijë i motrës sime meritonte gjithcka. Duhej ta ruaja... “Nga kush!? Nga ndonjë askush”! nuk mund ta lije që kjo vajzë, mbesa ime tepër e zonja, të mos arrinte majat e shkencës, të shoqërisë, të politikës e deri në majat e udhëheqjes së shtetit. Por... Ky “askush” a mund të bëhet një ;kush:!?

Por unë cilindo kush mund ta bëj askush! I mëshova zërit të brendshëm.

Për të përshkruar një rrethanë të pazakontë, për të karakterizuar një personazh, objekt, autori përdor veç të tjerave edhe një sërë përftesash, që studiuesi Osmani i quan “*neologjizma sintaksorë*”(Gj. J. 1/1991 f.36). Këto janë krijime të vetë autorit, duke i vënë fjalët në lidhje të reja jo të zakonshme, shpesh të pakuptimshme:

*Në atë përkëndeze emocionale të papërcaktuar mbylla me rrëmbim kasafortën e m’u duk se ndryva dosjen e një “kushi”, dhe dola shpejt nga zyra. Në korridor takova **sytë e pakëndshëm të paralelit tim**. M’u desh edhe ajo **ngulfitje ngulfatëse** që ndeshtrashëm ma nxiu edhe me **sferën e murrme të askushit**. (F.8).*

*“Hapu portë e **parashikimeve gjeniale!** (f. 15).*

*“Jo. Është një **këndellje kohore?! (F. 35)***

*“Po të bëjmë një lojë, edhe liberalizimi është **rregullsi e ngurtë.**” (F. 57).*

Për të zbuluar gjendjen e rëndë shpirtërore të personazhit shkrimtari përdor edhe pranëvënien e një vargu fjalish të thjeshta.

Përmes përdorimit njëra pas tjetrës së fjalive të thjeshta, pa n/r e organizime logjike, në momente shpirtërore shkrimtari konoton idenë se mendja e shkrimtarit punon me ngadalësi, se ai s’është në gjendje nga topitja të bëjë shtjellime logjike shkak-pasojë midis sendeve e dukurive të përcaktuara, të cilat i shikon si në një film larg qënies së tij.

Vështroja retë e flokëve!

Refleks i ndriçimit engjëllor!

Kaltërsi dhe vetëm kaltërsi!

Kaltërsi dhe bardhësi!

Ku i ka ato vetulla të zeza!

Lëvarje shelgu.

Hënëza të pashkulura e pastërholuara!

Shtiza ëmbëltherëse!

... Fytyrë piktori! (f. 6).

Një dukuri tjetër me mjaft interes e përdorur në roman është edhe përdorimi i **elipsës** për të cilën konsiderohet “...si përsosje e komunikimit modern me lexuesin”. (Kërkime II f.226), Galperin “*mungesa e një mjeti shton ngjyrimin emocional dhe e bën fjalinë të tingëllojë më emfatike*”(Stylistics f. 235). Përdorimet eliptike i ndeshim kryesisht në të folurit dialogjik, por edhe përshkrimet e autorit.

- *O valëzim i trëndelinës, flurim i petaleve!*
- *Qerpikët si halë pisha!*
- *Jo si halë! Ato janë therëse!*
- *Janë përherë të gjelbra!*
- *Kanë hijeshinë e palmës.* (Koridoret e gjelbra, f. 5)

Edhe përsëritja e realizuar me rrugë të ndryshme në roman bëhet mjet i fuqishëm me ngarkesë stilistike. Përsëritja e një fjale, e një shprehjeje, një strukture edhe një ideje. Shpesh përsëritet e njëjta mënyrë e të shprehurit. Përdorimi i vazhdueshëm i fjalëve të ndërmjetme gjatë gjithë romanit është pjesë e enigmës, së paqartësisë që e ndjek autorin deri në fund të tij.

- *Duhej ta ruaja... “Nga **kush**!? Nga ndonjë **askush**”! nuk mund ta lije që kjo vajzë, mbesa ime tepër e zonja, të mos arrinte majat e shkencës, të shoqërisë, të politikës e deri në majat e udhëheqjes së shtetit. Por... Ky “**askush**” a mund të bëhet një **;kush**:!?*

- *Por unë cilindo kush mund ta bëj askush! I mëshova zërit të brendshëm.*

Autori ka dhënë dëshminë se ka intuitën e autorit që gjen subjekte të përkryera, për të dhënë kuptime të thella të realiteteve shpirtërore e jetësore. Gjakova është një nga përfaqësuesit më dinjitozë të letërsisë **bashkohore** shqiptare. Vepra e Gjakovës është shprehje e vlerave letrare, e mundësive të pakufizuara shprehëse e pasurisë, e gjallërisë dhe e forcës së magjishme të fjalës.

BIBLIOGRAFIA

1. I.R. Galperin, *Stylistics*, Moscow, 1971.
2. Elena Semino-Mick Short, *Corpus stylistics, Speech, writing and thought presentation in a corpus of English Writing*, Neë York, 2011
3. Richards Bradford, *Stylistics*, London and Neë York, 1997.
4. <https://www.kultplus.com/libri/agim-gjakova-ne-letrat-shqipe-solli-nje-pasqyrim-te-thelle-mbi-veprat-e-agim-gjakoves/>.

5. <https://www.shkodraweb.com/personazh-agim-gjakova-shkrimtari-dhe-skenaristi-i-perndjekur-ne-kosove-dhe-ne-shqiperi/>.

▪Letërsi▪

Nikolin SH. LËMEZHI

AI MË DËRGOI...

-Cikël poetik-

Nikolin Sh. Lëmezhi ka lindur, më 4 shtator 1977 në fshatin Blinisht (Lezhë), që gjendet mbi një kodër të rrethuar në çdo anë me fusha. Shkollën 8-vjeçare e kreu në fshatin e lindjes në shkollën “Pjetër Zarishi”. Shkollën e Mesme e kreu në Shënkoll të Lezhës dhe Filozofinë në Shkodër në Seminarin Papnor Katolik nga viti 1996 deri në vitin 1998. Ka jetuar në Itali nga viti 1998 deri në 2008. Në vitin 2004 përfundoi studimet e Teologjisë në Universitetin Katolik “San Tommaso” në Messina të Siçilisë.

Që i vogël i ka pëlqyer të lexojë e të shkruajë. Është i bindur se poetët e mëdhenj vijnë nga kushte të përvuajtura jete. Përgjatë viteve ka publikuar poezi, tregime, artikuj, përkthime dhe recensione tek revistat katolike “Mbas Teje” dhe “Kumbona e së Diellës” si edhe në gazeta e revista letrare. Në Tetor të vitit 2021, publikoi përmbledhjen e tij të parë me poezi, me titull: “Si pika vese”. Në shtator të vitit 2022 vjen për publikun me vëllimin poetik “Kur Heshtja flet”, një libër me poezi të shkurtra meditative që janë edhe fryt i përvojës së tij shpirtërore. Është përfshirë në Krestomacinë *Zadrima Letrare 3*. Në Janar 2023, Tom Gjokhilaj, ka publikuar një monografi me titull “I magjepsur nga Ati” për jetën dhe veprimtarinë njerëzore, kulturore dhe fetare të z. Nikolin Sh. Lëmezhi.

Koleksioni i pullave të postës, imazhet e shenjta dhe kujdesi për lulet janë disa nga pasionet që ka.

Në Prill të vitit 2023, botoi broshurën “Rruzarja e Zojës së Bekuar”, një manual praktik për të udhëzuar besimtarët në lutjen tradicionale katolike të Rruzares. Në Maj të vitit 2023 botoi broshurën *Shën Rroku nga Montpellier*.

Aktualisht merret me përkthime, publikime, grupe lutjesh, mësim feje dhe aktivitete vullnetare e bamirësie.

Ai më dërgoi...

“Ai më dërgoi t’u kumtoj të vobektëve Ungjillin,

t'u shpall robërve çlirimin...". (Lk. 4, 18)

Sa zinxhirë
po copëtoj,
përgjatë
kësaj Rruge,
e prapë
skllevër
duan të rrinë!

Shkodër, më 12. 12. 2022

Janë shqiptarët për ty Shqipëri!

Shqipëri, o Nënë e shenjtë,
n'historinë tënde të rrallë.
Do të jem unë bir i denjë,
do të jem një gur i gjallë.

Ti je Nënë gjithmonë me nder,
ti je toka e larë me gjak.
E pamposhtur je përherë,
je shqiponja mbi bajrak!

Ndaj gjithmonë plot dashuri
do të këndoj në tokën mbar':
Nëna ime, je ti, Shqipëri,
emri yt më bën krenar.

S'do të pres nga askush tjetër,
të vërë dorë mbi këtë ndërtesë.
Tokë hyjnore, kaq e vjetër,
po ta jap sot ty këtë besë.

Sa t'jen' dielli edhe hëna,
sa të jetojë kjo njerëzi,
sa t'ketë bij lindur nga nëna,
janë shqiptarët për ty Shqipëri!
Shkodër, më 28. 02. 2023

Pranim

“U bëftë vullnesa jote...”. (Mt. 6, 10)

Gjithçka
qëndron në pranim.
E, kur pranimi
bëhet me gëzim,
çdo gjë shndërrohet
në lartësim.
Aty, pastaj,
ka jetë dhe liri
në çdo drejtim.

Shkodër, shkurt 2023

Boshllëqet

Boshllëqet
vetëm Heshtja
mund t'i mbushë.

Shkodër, më 05. 03. 2023

Lajmi më i Mirë

Jam njeriu më i lumtur në botë,

sepse jam biri i Atit Qiellor.
Asnjë fije floku s'do t'më bjerë prej kresë,
të njoha Ty, o Atë, dhe Ti më mjafton.

Oh, sa e bukur jeta me gjithë këtë bekim,
tashmë të kam Ty në çdo të vështirë!
Seç ma ndërrove pikëllimin në gëzim,
o Atë Qiellor, babai im i mirë!

Ç'është gjithë kjo paqe, gjithë kjo mirësi?
Një thirrje në zemër vazhdimisht jehon:
Është Lajmi i Mirë, plot me dashuri,
që Emrin e Atit çdo ditë na e zbulon.

Lorient (Francë), më 06. 10. 2022

Mëkati dhe Jezusi...

Jeta është e shkurtër,
vdekja nuk vonon!
Mëkati është shkak,
por Krishti e shëron!

Shkodër, më 11. 03. 2023

Të ndryshëm... e të bashkuar

Seç ëndërrova një natë,
burra e gra,
të vjetër dhe fëmijë së bashku
me ngjyra të ndryshme
nën të vetmin diell!

Seç ëndërrova luftërat,
dhimbjet dhe urinë
bashkë me vuajtjet
e breznive të së kaluarës
që më nuk është!

Seç ëndërrova një natë,
se sa bukur do të ishte
të bashkonim ngjyrat
e të shikonim këtë njerëzim
si një lëndinë të lulëzuar!

Papritmas një zë më zgjoi,
duke më pëshpëritur ëmbëlsisht:
Të ndryshëm në ngjyrë
është ajo që na bashkon
dhe ylber na bën.

Marino (Romë), më 14. 10. 2004

Emri yt, o Atë!

(Kushtuar Atit Qiellor)

Atë!
Ti je Emri më i bukur
në këtë jetë
e në Përjetësi!

Atë!
Je Emri më i bukur i Dashurisë
që jetës i jep Jetë
e mund të quhesh edhe Nënë!

Atë!
Ti je Emri
që çdo krijese
i ke dhënë një emër!

O Atë i mirë!
Në Emrin tënd
gjej vetveten
dhe gjithçka që më kishte humbur!

O Atë, Babai im i dashur!
Unë, biri yt endacak,
zbulova Emrin tënd,
ndaj jam kaq i lumtur!

Mrekullisht, gjithçka më flet për Ty,
e më josh, pa shumë shpjegime,
drejt thellësive të tua të pafund:
E jam gjithmonë i lumtur!

Blinisht, më 09. 05. 2023

Brikena LAZRI

Poezia e Nikolin Sh. Lëmezhit

-recension-

Pata kënaqësinë të marr pjesë në promovimin e dy librave me poezi të vëlla Nikolin Sh. Lemezhi, “Si Pika Vese” dhe “Kur Heshtja flet”, që u zhvillua, më datën 30 maj 2023, në orën 10.00, pranë ambienteve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve në Lezhë.

Jemi pothuajse në të njëjtën moshë dhe jemi rritur në Blinisht të Zadrimës, duke kaluar një fëmijëri të vështirë në vitet e diktaturës dhe, pas rënies së regjimit, patëm fatin të edukohemi pranë kishës, me misionarë të jashtëzakonshëm, ku më së shumti spikat don Antonio Sciarra. Poezia e Nikolin Sh. Lëmezhit vjen e thjeshtë, e sinqertë dhe gati fëminore, por në të njëjtën kohë me thellësi mendimi dhe pasqyrim realiteti. Botimi i parë, “Si pika Vese”, na shfaq që në kopertinë, një foto të fëmijërisë bashkë me nënën, me të cilën ka pasur një marrëdhënie të veçantë si njëri prej fëmijëve më të vegjël të familjes (në fakt ai është fëmija i parafundit). Ka disa poezi që ia kushton nënës, të cilat tregojnë një grua të thjeshtë, besimtare, që mes shumë vuatjeve që i sjell jeta, arrin të bëhet një mbështetje e fortë për familjen dhe sidomos për fëmijët e saj. Edukimin fillestar fetar, e merr prej saj dhe që aty nis rrugëtimi i gjatë i studimeve teologjike në Shqipëri e Itali dhe përsiatjeve ku tashmë ka gjetur gëzimin e besimtarit dhe lirinë që ta jep besimi dhe për të cilën nuk ka dëshirë të bëjë asnjë kompromis. Poezia “Mbi shkopin tënd...” është mjaft e spikatur dhe shprehëse duke filluar me disa pasazhe të Biblës siç bën edhe në shumë poezi të tjera.

Mbi Shkopin tënd...

(Kushtuar nënës Luke)

*“Me gjithë shpirt duaje babën tënd
dhe mos i harro ofshamet e nënës sate!
Mos harro se s’do të kishe qenë pa ta,
e çka do t’u japësh siç të dhanë ata?”.*
(Siracidi 7, 29-30)

Shkopi ku ti mbështeteshe,
tek e shoh plot mall.
Në zemrën time prej biri,

ç'ndjenja seç më ngjall!

Shkopi ku ti mbështeteshe,
i shkurtër si ti vet'.
I heshtur dhe i palëvizshëm,
O Nënë, sa shumë më flet!

Shkopi ku ti mbështeteshe,
është i shenjtë për mua shumë.
Se aty, tashmë, o Nënë,
vazhdimisht mbështetem unë. (*Shkodër, më 07. 03. 2020*)

Tek ky libër, në fakt, gjejmë poezi të mbledhura ndër vite, që nga mosha e adoleshencës e deri në ditët e sotme, duke na sjellë një panoramë të jetës në faza të ndryshme të saj. Jemi brezi që kemi përjetuar ndryshime të mëdha edhe historike të Shqipërisë, duke u gjendur në situata ndryshimesh rrënjësore, tranzicioni të vështirë, braktisje të arsimit, luftë e pakuptimtë, një komb i copëtuar në përpjekje për t'u bashkuar, një politikë që nuk sjell progres, por bëhet pengesë, por edhe një dëshirë dhe impenjim i madh popullor për të ecur përpara.

Poezia e Nikolin Sh. Lëmezhit, na shfaqet e përsipirtshme, ku pothuajse në asnjë varg nuk mungon referenca tek Krijuesi, por edhe tek Shkrimi i shenjtë. Në fakt, nuk jemi mësuar të shikojmë të botuara poezi me temë fetare, ndoshta sepse edhe sot pas shumë vitesh lirie besimi, akoma nuk jemi në gjendje të shpallim besimin tonë, lirinë që të jep besimi dhe frymëzimin për të shkruar për Krijuesin. Të qenit një shtet laik, nuk na pengon të jemi një popull besimtar. Po zgjedh poezinë “Sa mister i bukur” për ilustrim:

Sa mister i bukur!

“...të dobët në sy të botës i zgjodhi Hyji,
për t'i turpëruar të fortët”. (1 Kor. 1, 27)

Sa mister i bukur,
Ti, o Zot,
se ëmbëlsisht
në vogëlsira
e në hollëlsira

banon,
më shumë
se kudo,
dhe bota,
pikërisht këtë,
nuk kupton!

Libri i dytë “Kur Heshtja flet” vjen më i sigurt dhe më prodhimtar, ku shikohet që poezia është një oaz paqeje për autorin, kur arrin të shprehë lirshëm mendimin dhe gjykimin. Të bën përshtypje fakti se në këtë libër, fjalën Heshtje e ka shkruar gjithkund me të madhe, si për të thënë vlerën më të madhe dhe shenjtërinë e kësaj teme.

Mendimi filozofik shfaqet kryesisht në poezitë e shkurtra, të cilat me 3-4 vargje japin mesazhe shumë të thella siç është:

Kur Heshtja flet

Kur njerëzit heshtin
dhe heshtja flet,
aty ka Jetë...

(Shkodër, më 12. 07. 2022)

Në këtë botë të zhurmshme, ku të gjithë flasin, thërrasin, duan të dëgjohen, të evidentohen në çdo formë e çdo mënyrë, Nikolin Sh. Lëmezhi na fton të kërkojmë heshtjen për të gjetur fillin, arsyen, kuptimin....

Gjithashtu, poezia e Nikolin Sh. Lëmezhit është edhe shumë edukuese, e perceptueshme për të gjitha moshat dhe me mesazhe morali, shprese dhe dashurie;

Barinjtë dhe delet

Ka barinj,
që në vend që të pastrojnë rrugët
për delet e tyre,
u shtojnë pengesa,
dhe ka dele,
që pa provuar kurrë kujdesin baritor,
bëhen barinj,
të atyre që barinj
kurrë s’ duhej të ishin,
madje ka prej atyre,

që të shtyrë nga Dashuria
japin jetën për barinj të
e nuk humbin kurrë kohë
duke u shqetësuar
se kujt i takon më përpara të japë jetën:
Bariut apo deles.
(Shkodër, më 09. 11. 2021)

Këto poezi janë vetëm një shije apo degustim dhe libri do t'ju japë me siguri efektin dehës që ka poezia.

I uroj suksese Nikolin Sh. Lëmezhit në rrugën e tij të krijimtarisë dhe them me bindje se poezia e tij ia vlen të jetë në bibliotekat tona dhe të lexohet, se kujt do t'i shijojë mjaft ëmbëlsisht dhe, e bazuar në përvojën time, mendoj se për çdo lexues, do të ndikojë pozitivisht në rritjen e nivelit shpirtëror.

▪Ese▪

Lorela SINANI

Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun?

Nuk jam e mendimit se Sokrati është i vuajtur. As e mendimit se derri është i kënaqur, nuk jam...Ne fund të fundit, është e gjitha çështje këndvështrimi...çfarë është vuajtja për Sokratin, dhe çfarë është kënaqësia për derrin?

Nëse për Sokratin do ishte i rëndësishëm vlerësimi i derrave, atëherë po, ai do vuante, do vuante shumë, se në fund të fundit, kush është ai derr, që vlerëson Sokratin? Derrat as nuk e kuptojnë Sokratin, vetëm shtrihen në baltë e hungërijnë...Nëse për derrin, kënaqësia është të hedhurit baltë mbi Sokratin, pak nga ajo balta që ia mbulon gjithë trupin, atëherë po, derri është i kënaqur, sepse kjo është forma e vetme me të cilën mund të shfryjnë ndjesitë negative që burojnë nga inferioriteti i madh që ndiejnë...duke hungërirë fjalë që Sokrati nuk i kupton, se nuk e flet gjuhën e derrave.

E nëse qëllimi i derrit ishte pikërisht ai që u shpreh më sipër, qëllimi i Sokratit, nuk është kurrsesi, të vlerësohet nga turma...Sepse vetë Sokrati, ka lindur për të menduar jashtë turmës. Kjo vërtetohet edhe me faktin që vetëm ata që mblaçiten vetë në baltë, duartrokasin derrat e tjerë që mblaçiten. Anjë Sokrat, nuk duartroket kur hungëret derri. Sokrati, duartroket vetëm për Sokratin. Po në fund të fundit është fati I Sokratëve ky, sepse fatkeqsisht, në botë ka dhe ka për të pasur gjithmonë më tepër derra ...

Ky është realiteti i hidhur e aspak i drejtë, në të cilin ne jetojmë. Jetojmë në një botë, ku një njeri i cekët e i paaftë, vlerësohet më tepër se një njeri me potencial, me aftësi, me talent dhe ide të reja. Kjo, sepse është tendenca natyrale e njerëzve, që të vlerësojnë atë që i përngjanë më shumë atyre dhe atë figurë ku ata e gjejnë më shumë veten... Është më e lehtë për një të paaftë, të duartrokasë për paaftësinë, sesa të ndryshojë e të përmirësohet. Kështu ka qënë, e kështu do jetë gjithmonë...Janë të rrallë ata njerëz me cilësi të veçanta e që ia vlen të vlerësohen, ndërkohë që injoranca dhe njerëzit e rëndomtë, shiten si të rëndësishëm, mes njerëzve të tjerë, po aq të rëndomtë...Epo, në fund të fundit, si asht vendi bahet kuvendi!

E për ta përmbyllur, asnjë nuk e thotë më bukur përmbajtjen e kësaj eseje, se At Gjergj Fishta, i cili me mjeshtërinë e tij, i dedikoi Ndoc Nikajt poezinë "Nakdomoncipedija", duke dënuar gjithë mosvlerësimin dhe padrejtësinë që shkrimtari mori, në këmbim të një vepre

të mrekullueshme për historinë e Shqipërisë...Duke dënuar popullin, turmën, që vlerëson derrat dhe jo Sokratët:

‘‘Po, athu e din, morr t'u ngjatet jeta!

Përse libr edhe gazeta,

E pse istore-e kanga arbnore

Sod me sod nder zogj t'shqyptarit

S'janë tue pasun kurrfar zarit

N'mos e dijsh, due me t'kallxue,

Por n'paq ngae ti m'ndigjue,

Zoti i lumë për njerzit mbarë,

Tue xan fill m'babën e parë,

E der m't'mramin-rend e rend,

Veç treqind derhema mend

Se ma teper s'u pat da.

Me kaq mend, tash, more vlla,

A mund t'mushen sa e sa koka

Qi per randë, i ka toka.’’

▪Tradita familjare shkodrane▪

Zenepe DIBRA

FAMILJA BEKTESHI⁹⁶

Në Shkodër ka patur familje që janë quajtur “të mëdha” apo “derë e madhe” nga pasuria apo nga forca e pushtetit apo nga numri i ofiqeve që merrnin në shërbim të sundimtarëve. Por kishte nga ato familje që këtë emër kaq të lartë ja jepte populli dhe që e meritonin nga patriotizmi kombëtar, nga mirësia njerzore, nga shkalla e kulturës dhe integritetit nga besa dhe burrëria. Janë të shumta të tilla familje në Shkodër si Bushatlinjtë, Suma, Sokolët, Kazazët, Boriçi, Lohja, Shiroka, Deda, Shantoja, etj. Por shumë prej këtyre familjeve akoma nuk e kanë të njohur biografinë e tyre, kontributet në disa fusha dhe luftën që kanë bërë për kulturë, emancipim dhe tolerancë fetare. Këto familje këto veti dhe kontribute i kanë manifestuar në disa fusha pa bujë e krenari për tu bërë pastaj një shembull i karakterit të shkodranit patriot, i respektuar dhe i kulturuar. Nëqoftëse shumë familje kanë tentuar të arsimojnë djemtë e tyre në shkolla të ndryshme, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë vendit, shumë prej tyre kanë qenë shumë refraktarë në arsimimin e vajzave, të nxitur nga morali i kohës, nga fanatizmi nga opinioni tepër frenues në këtë drejtim por edhe nga feja e kjo sidomos për komunitetin musliman. Por kishte edhe familje që e thyenin këtë tabu. Këtë shembull të emancipimit të vajzave në radhë të parë do ta jepte familja Bekteshi.⁹⁷

⁹⁶ Shumë të dhëna për këtë familje janë marrë nga Hamza Kazazi, nip i familjes Bekteshi me një histori të gjatë të persekutimit komunist.

⁹⁷ Per familjen “Bekteshi” autorja e këtij artikulli ka shkruar në librin “Fjalor Enciklopedik i hapësirës shkodrane”, vëll.I, Lezhë, 2015.



Fig. 1 Pjestarë të familjes Bekteshi në shtëpinë e tyre në Shkodër

Ishte kjo një nga ato familje të nderuara, që kurrë nuk i dha lavdi vehtes por jetoi e punoi “me erz e me nder” si i thojne shkodranet për familjet e mira, Po kush ishte ky burrë i nderuar, që e drejtoi familjen Bekteshi në rrugen e patriotizmit, zhvillimit dhe emancimit të anëtarëve të familjes së tij?



Fig. 2 HASAN BEKTESHI

Hasan Bekteshi, i njoftur dhe i respektuar në Shkodër dhe i thirur Hasan Efendi Bekteshi , lindi në vitin 1862 në një familje të hershme. I ati i vdiq kur ishte 14 vjeç duke i mbetur përgjegjësia e mbajtjes së familjes, kështu ai fillon aktivitetin tregtar heret fillimisht në qytetin e Korçës, ku i vunë emrin "gega i vogël". Në moshën 15 vjeçare shkoi në luftë kundër invazorëve malazezë dhe i vazhdoi përpjekjet për pavarësinë e Shqipërisë, duke mbajtur lidhje me figura të shquara të luftës për liri, si Isa Boletini, Hoxhë Kadria, Bajram Curri dhe me diasporën, prej ku në mënyrë klandestine i vinin gazetatat në gjuhën shqipe.

Edhe mbas shpalljes së Pavarësisë, Hasan Efendi Bekteshi e vazhdoi angazhimin e tij në jetën politike dhe ekonomike sociale të Shkodrës, duke u bërë anëtar i Këshillit Administrativ Lokal të ngritur nga austriakët në vitin 1914, kur Shkodra administrohej nga Komisioni Ndërkombëtar. Mbas ripushtimit të Shkodrës nga malazezët më 1915, ai arrestohet së bashku me veprimtarë të tjerë, përfshi Luigj Gurakuqin, Çerçiz Topullin, Hilë Mosin etj. dhe mbahet i burgosur në Podgoricë për pak muaj. Në prill të vitit 1917 ai qe pjesë e delegacionit prej 34 përfaqësuesish nga Shqipëria që u takuan me perandorin e ri të Austro-Hungarisë, Karli I, për ta falënderuar për autonominë që perandoria e Habsburgëve u kishte njohur trojeve shqiptare.



Fig. 3 Delegacioni shqiptar që shkoi në Austri në prill të v. 1917. Nga Shkodra: Musa Juka, Kolë Ujka dhe Hasan Bekteshi. Bajraktari i Shkrelit Vatë Marashi, Gjelosh Gjoka i Kastratit dhe Abdi Kola i Shalës

Hasan Efendi Bekteshi përkrahu politikën e Austro-Hungarisë pse ishte antisllav duke mbrojtur vendin tonë. Ai mbante lidhje me shumë patriotë shkodranë por edhe jashtë Shkodrës dhe ishte tepër i interesuar për çështjen shqiptare, për bashkimin dhe lidhjen në mes shqiptarëve duke anashkaluar shumë ndarjet. Në një leter që i ka çue, përfaqësuesi i kolonisë shqiptare të Turqisë në Konferencën e Paqes në Paris, dibrani patriot Fuat Zembraku Dibra del se Hasan Bekteshi i ka pase dhurue Hoxha Kadrise 10.000 korona per vazhdimin e perpjekjeve per njoftjen e Shqiperise prej Fuqive të Europes. Letra që mban datën 11 shtator 1919, (e perkthyer nga origjinali në turqisht), është një thirrje që ky patriot i bën Hasan Bekteshit duke besuar në integritetin dhe patriotizmin e tij që ai sa të mundet të bashkojë shkodranët muslimane dhe katolikë ashtu sic po bënin perpjekje të bashkoheshin në Konferencën e Paqes në Paris (1919-1920) të gjithë shqiptarët që vinin nga përfaqësime të ndryshme

PERFAQESIA E KOLONISE SHQIPTARE TE
TURKISE NE KONFERENCEN E PAQES
11 Shtator 1919

PARIS

Hasan Efendi Bekteshit, Notabel
Shkodra

Uderueshmi 20m

J kam marrë me pozim dy letrat tuaja, e para shqip me date 21 Maj dhe e dyta turqisht me 27 Korrik 1919. Ju falenderoj për se teperimi për simpatinë e shfaqur kamëra meje përtej sa e meritoj. Për ma fort me lea larmë mirënjohës lajmi: dhunës së dhjetëmitë koronave të Valentit Hoxhe Kadri Efendisë. Lajmet që vijne këtu tregojnë se shqipëria e shkuarë e jona asht bërë sheshi: gjithëfarë propagandave. Pritet prej jush, si të sqerim që jeni me ndërrë e me atdhetdashmëri me bashkëru myslimanët e të krishterët për me shpërfytyrë kështu propagandën që jone fua hapë armiq të shekullit të shqiptarëve me pellim që neqer këtu dasi të përtërijnë anarshi në shqipëri dhe t'i tregojnë botes së shqiptarët nuk kanë të drejtë proritje. Përfaqsimat këtu, të gjitha kanë llojë bese për me dale të bashkëru përpara botes. të tane bashkëruisht që punojnë shkur të mos ishtë: mallkëruimi që jmet do ma shkojolin ma në prapull. Jety njeri asht lajme për ngatresë e për intriga. Praq që jn luteri: mos i jepni shkakë dasisë e ngatresave. Mëndohem me themelue një armori që të jn vije për dorë në mos të myslimanëve e të krishterëve. Asht një detyrë ma e madhe atdhetare me u gjete të bashkëru ndër këto llojë që asht tue u çelitur fati i shqipërisë. Tue jn lute që të mos e kusëni simpatinë t'nejt ndaj meje, jn parapes ndërrimet e mija.

M. F. Zembraku
pej Dibre

F.S. Puna për të cilën do të përpisim ma fort asht mos me larmë të s'illmë s'jete partizanët e Esat Pashës, ma të madhit e ma të poshtërit tradhtar të shqipërisë dhe me sqerim popullin që të mos vrehet neqer intrigat e t'i.

Fig.4 Letra e përkthyer nga origjinali turqisht, që Fuat Zembraku Dibra i dergon Hasan Bekteshit nga Konferenca e paqes, 11 shtator 1919 (Arkiv i familjes)

Një vlerësim real për Hasan efendi Bekteshin e ka dhënë edhe studiuesi Hamdi Bushati, në librin e tij “Shkodra dhe motet”⁹⁸ :” Hasan efendi Bekteshi ka qenë një figurë e njohur në jetën ekonomiko-shoqërore të Shkodrës në fund të shekullit të kaluar dhe fillim të këtij shekulli. Ai ka bashkëpunuar me patriotë dhe veprimtarë që luftonin për lirinë e kombit e përparimin e vendit. Është njohur pjesëmarrja e tij në Komitetin “Mbrojtja e Kosovës” dhe ndihma e pandërprerë për delegacionin shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Ka qenë arsimdashës dhe ka shkolluar jo vetëm bijtë por edhe bijat pa përfillur traditën e familjeve fanatike shkodrane”

⁹⁸ Hamdi Bushati “Shkodra dhe motete”, vëll.II, fq. 374, Shkodër, 1999

Hasan ef. Bekteshin e shqetësonte shumë edhe meskiniteti i disa shqiptarëve që vinin interesin personal mbi atë të përgjithshëm, e prekuponte edhe që shumë shqiptarë sidomos ato muslimanë për hir të mbrojtjes së interesave fetare pengonin mbrojtjen e çështjes kombëtare. Ai ishte liberal dhe demonstroi në shumë perpjekje të tij një tolerance fetare e dallueshme për kohen. Këtë ai e ka shprehur edhe në një bisede, botuar në gazetën “Përparimi”⁹⁹ ku në këtë organ shtypi ai përshkruhet si një personalitet shume i kthjellët që e din se ku çalon e ardhmja dhe zhvillimi i vendit, por edhe nje person inteligjent, zemer bardhe dhe fisnik. H. Bekteshi në atë bisedë tregon se e keqja e vendit është në pak njerës që janë shitur tek të huajt dhe mbahen prej tyre financiarisht. Aty ai i bën edhe analizë muslimanëve të ndershëm që mendojnë për familjen, dhe vendin por ka edhe nga ato që i hedhin pas shpine të mirat e këtij vendi.

Ai bëri përpjekje edhe për zhvillimin ekonomik të Shkodrës duke u angazhuar bashkë me një grup te tregtarëve të Shkodrës për thellimin e Bunës që të kishte një lundrim të sigurtë. Mendonte se është e domosdoshme të blihej një dragë që të pastronte Bunen. Për këtë së bashku me Tef Curanin shkuan për një marrëveshje me firmen gjermane Krup por që në fakt nuk pati sukses. Ai ka qënë njeri autodidakt, mësoi të shkruaj shqip, dhe turqisht si dhe gjuhë të huaj italishten dhe rregullat tregtare.

Është shumë e habitshme se si kjo familje krahas, emancipimit të anëtarëve të saj ka ushqyer nje tolerancë fetare me komunitetin katolik. Janë disa raste ku është shprehur kjo tolerancë. Së pari kryefamiljari i kësaj familjeje kishte miq shumë klerikë katolikë ndër to Dom Ndoc Niken dhe Padër Gjergj Fishten, por dhe të tjerë. Kjo bëri që Padër Gjergj Fishta t’i dedikoi edhe epitafin shkruar mbi varrin e tij. Po kështu kur me 1928 Hasan Bekteshi ishte në gjëndje të rëndë, në momentet e agonisë së tij, rastisën në dhomë Ipushkëvi dhe Popi, miq të tij, që i kishin shkuar për vizitë. Ata të dy i thanë, gruas së Hasanit, Habibes: “Zojë, a t’i a japim bekimin? Dhe ajo u përgjigj: “Posi, më vjen mirë. Na një Zot kena e ju jeni miq e kryetarë të dy besimeve të tjera”. Gjykoni mendimin përparimtar të një gruaje shkodrane të atyre viteve! Por ajo që do ta ngrinte H. Bekteshin në një nivel të lartë intelektual dhe largpamës ishte vlerësimi që ai kishte për arsimimin e fëmijëve të tij dy djemve dhe katër vajzave. Në atë kohë kishte familje muslimane që i dërgonin djemtë edhe në shkolla katolike bile edhe jashtë vendit por për vajzat rastet ishin tepër të rralla. Pa pasë paragjykime të religjionit por duke vlerësuar cilësitë dhe nivelin e shkollave të asaj kohe ai i dërgoi vajzat të arsimoheshin në shkollat katolike. Për kohen, për opinionin, për konservatorizmin e shoqërisë kjo ishte jashtë cdo parashikimi që mund t’i sillte edhe dëmtime imazhit të tij në ambientin e rrethit shkodran.

⁹⁹ “Përparimi”⁹⁹ (Vjeta VII, dhjetor, 1914, Numri XII),

Pavarësisht se ai kishte filluar arsimimin edhe privatisht duke i dhënë kulturë të përgjithëshme deri mësimet muzike, si dhe ushtrim edhe në instrumenta, por edhe gjuhë të hueja, por për të marrë një arsim më të kualifikuar i dërgoi në shkollën italiane të Murgeshave Saleziane “Bijat e Maries Ndhimtare. Edhe dy djemtë bënë Kolegjin Saverian (të jezuitëve) e studimet universitare në Austri për ekonomi Teofiku dhe në Itali për mjekësi prof. Selahedin Bekteshi, themelues i pediatriisë moderne në Shqipëri. Një rast tjetër tregon për këtë z.Hamza Kazazi, djali i Jup Kazazit dhe nipi i Hasan Bekteshit për tolerancën fetare midis dy komunitetev fetare në Shkodër ku respektohej religjioni i secilës palë. Kur vajza e Hasanit, Minirja ishte në shkollën e murgeshave dhe kur po fillonte mësimi, murgesha mësuese, i tha Minires: *Po ti pse nuk e bane kryqin?* Ajo u përgjigj: *Unë jam myslimane*. Mësuesja menjëherë i kërkoi falje. Minires nuk i erdhi keq dhe as nuk e foli në shtëpi. Megjithëse Minirja nuk kishte treguar në shtëpi, të nesërmen erdhi në shtëpi murgesha Drejtoreshë e shkollës. Ajo i kërkoi falje Habibes, nanës së Minires për çka kishte ndodhë, por ajo i tha se nuk ishte asgjë e nuk kishte pse të shqetësohej. Kjo ngjarje e vogël tregon shumë për vlerën e seriozitetin e shkollës dhe tolerance fetare të dy anshme të popullit shkodran.

E shoqja, e **Hasan Bekteshit, ishte Habibe (Çausholli) Bekteshi (1885-1967)**, një grua inteligjente, besimtare, që e kuptonte gjendjen e shkonte simbas kohës. Ajo kishte bërë “mejtepin”, shkolla turke e kohës dhe gati deri në vitet e fundit lexonte kuranin në arabisht çdo ramazan dhe u luste rregullisht. Përkrahu emancipimin e vajzave të saj pa paragjykimet e kohës, Ajo i dërgoi vajzat në shkollë, edhe pse shkolla ishte katolike e rëndësishme ishte që vajzat,të merrnin kulturë në disa drejtime. Në Shkodër Habibja njihej si një grua që përkrahte zhvillimin dhe përparimin e qytetit dhe në mënyrë të veçantë përparimin dhe emancipimin e femrës shkodrane. Kjo bëri që ajo të zgjidhej **kryetare nderi e shoqatës së parë të gruas në qytetin e Shkodrës të drejtuar nga Shaqe Marie Çoba**. Kjo shoqatë e krijuar në 4 gusht 1920 dhe e quajtur “Komiteti Gruaja Shqiptare”, nga gra të familjeve më të mira shkodrane, kishte statutin e vete dhe qëllimi kryesor i saj ishte mbledhja dhe ndarja e ndihmave për ushtrinë kombëtare në Luftën e Koplikut kundër agresorëve malazezë që kishin piksynim aneksimin e trojeve shqiptare. Po kështu kjo shoqatë nepërmjet revistës “Gruaja shqiptare” realizonte qëllimin tjetër kryesor emancipimin e gruas shkodrane dhe përparimin e saj në rrugen e

zhvillimit.^{100, 101} Dhe në këtë shoqatë roli i Habibes ishte domethënës me shembullin e saj që kishte treguar për vajzat e saj duke merituar me të drejtë kryetare nderi e kësaj shoqate.

Hasani pati katër vajza: Miniren, Adilen, Fahrijen e Nasiben si dhe dy djem Teofikun dhe Selaudin. Vajzat me kulturen që moren konsideroheshin në opinionin shkodran, si femra me intelekt e të kulturuara dhe shumë të emancipuara. Ato që kur ishin vajza shkonin me nënën e tyre për çdo verë në mal në Kolashin dhe në plazh në Ulqin, si pak kush në atë kohë. Fatkeqësisht leximi e shtimi i kulturës, ju mbaroi me fillimin e vuajtjeve e të persekutimit komunist. Një nga shkaqet ishte se ato u martuan me burra nga familjet më të mira e të njohura, jo vetëm në Shkodër.



Fig. 5 Katër vajzat e Hasan Bekteshit; Fahrije, Minire, Adile e Nasibe

Vajza e madhe **MINIRE (BEKTESHI) BUSHATI (1902-1978)**. Ishte vajza e parë myslimane në Shkodër që shkoi në shkollën italiane të Murgeshave Saleziane “Bijat e Maries Ndihmëtare”.. Në shkollë ajo bënte të gjitha lëndet e kulturës së përgjithshme kryesisht lëndët

¹⁰⁰ Zenepe Dibra ”*Fjalor Enciklopedik i Gruas Shqiptare*”, Shtëpia Botuese Camaj-Pipaj, Shkodër, 2009

¹⁰¹ Zenepe Dibra, “*Fjalor Enciklopedik i hapësirës shkodrane*”, vëll. I, Shkodër, 2015

humanitare, arithmetikë dhe punë dore si qëndisje e qepje, si dhe mësimin e gjuhës italiane Ajo vetëm nuk shkonte në kishë dhe nuk bënte orën e mësimin të besimit katolik..Me këtë kulturë të marrë në shkollë, ajo lexonte më tepër dhe njihte edhe vepra shkrimtarësh të mëdhej.

Minirja qe martuar me Maliq Bushatin (1890-1946) e familja e tij qenë trashëgimtarët direkt të pashallarëve Bushatlij. Maliq Bushati pati mbaruar Robert College në Stamboll, qe marrë me aktivitetet me Klubet shqiptare në Stamboll e Selanik, me 1914 me organizatën progresiste Krahu Kombëtar. Me 1913 luftoi kundër malazezëve kur rrethuan Shkodrën, me 1919 drejtues i gazetës Populli, qe shef i shëndetësisë e anëtar i Këshillit Bashkiak Shkodër. Gjatë Luftës së Koplikut qe anëtar i shtabit të luftës. Ai qe kundër Zogut dhe gjatë 1921-23 ishte me opozitën, Partinë Popullore; më 1925-37 deputet i saj. Gjatë pushtimit italian me 1939-41 qe ministër i brendshëm e me 1943, 3 muaj kryeministër. Zbulohet në Shkodër me tradhëti e me 14/02/1946 dënohet me vdekje bashkë me Patër Anton Harapin e Lef Nosin dhe pushkatohen.

Nuk patën fëmijë e Minirja qe larguar prej Maliqit që kur ishte ministër, por nuk patën bërë ndarje.



Fig. 6 Vajzat e dy familjeve të nderuara të Shkodrës familjes Bekteshi dhe Çausholli të cilat ishin edhe ne lidhje farefisnore. Nasibe, Adile, Hava (Shpuza) Vasqari,

Fahrije, Minire, Alije (Shpuza) Drishti Nga fotoja shihet eleganca, veshja moderne dhe me aksesore estetikë dhe të cmuar

Vajza e dytë ADILE (BEKTESHI) BOLETINI (1907-1978)

Adilja, si motrat, pati marrë mësimet private deri muzikë në shkollën e Murgeshave Saleziane, ku përveç mësimet të kulturës së përgjithëshme bënë edhe ekonomi shtëpije, qepje e qëndisje. Ajo kishte inteligjencë e talent të veçantë për gjuhët e hueja dhe i kapte në mënyrë të jashtëzakonshme e të shpejtë. Pati mësuar në shkollë italishten dhe vetë, frengjishten, me një shkallë mesatare, serbishten prej shkollarëve në Kolashin, Ulqin e në Kosovë tek njerëzit e të shoqit, kurse turqishten e fliste shume rrjedhshem

Adilja u martua me Adem Boletin (1896-1943), djali i heroit kombëtar Isa Boletini. Me 1912 Ademi 16 vjeçar shkoi me të atin me 400 kosovarët në Vlorë për pavarësinë e Shqipërisë dhe me Isain me 1913 shkoi në Londër, me delegacionin qeveritar me në krye Ismail Qemalin etj. Përfundoi gjimnazin në Vjenë-Austri me 1914 dhe Akademinë e Lartë Ushtarake në Modena-Itali me 1919. Me 1922-23 luftoi edhe kundër grekëve në jug. Ai qe me opozitën, me Lëvizjen e qershorit e me 30-31 maj 1924, togër i ri, komandoi direkt sulmin kundër prefekturës Shkodër. Gjatë pushtimit fashist ai pati gradën e n/kolonelit por jo funksione me rëndësi. U vra në një atentat para Kafes së Madhe në Shkodër nga komunistët. Vrasja e Adem Boletinit, djali i patriotit të madh Isa Boletini, ishte një nga vrasjet më të bujshme të asaj kohe ku pati reagime të ashpëra, por komunistët menjëherë kerkuan falje, bile nxorren edhe trakt për këtë dhe çuan edhe kunorë tek varri.



Fig. 7 a. Adile Bekteshi Boletini me kostum kombëtar; b. Familja e Adem dhe Adile Boletinit me dy djemtë e tyre.

Adilja ka qenë më gazmorja dhe më e shkathëta nga motrat. Ka qenë e aktivizuar në shoqatën “Gruaja Shqiptare” nën kryesinë e Shaqe (Marie)Çoba, ku ajo ishte në kryesi, në rolin e këshilltares.

Me vrasjen e të shoqit jeta e saj ndryshoi, sa shpesh thonte: “*bashkë me Ademin, kam vdekë edhe unë*”. Nuk i mjaftoi vrasja e burrit nga komunizmi, por e dënuan edhe atë me 5 vjet burg. Në moshë 39 vjeç e torturuan, me metodat më çnjerzore si dhe shumë të tjera, si Agime Pipen, Ana Dajen, Terezina Palin etj., të cilat kanë patur një vlerësim të respektuar për Adilin por edhe ajo i ka dashtë, vlerësuar e këshilluar. Ajo i ka pasë cilësuar si vajza të mbrekullueshme që vuanin.¹⁰²

Adilja me Ademin patën dy djem, Enisin e Isa Boletinin e 2-të Ajo me djemtë erdhi në Tiranë tek i vllai Prof. Selahedin Bekteshi. Deri me 1962 nuk përmendej Isa Boletini dhe atë vit, për 50 vjetorin, i ftuan në Vlorë. Ju vazhdoi lufta e klasave por me ndërhyrjen e Prof. Bekteshit, e me letër E. Hoxhës, ai dha urdhër dhe ju pastruan “biografinë”.

Enis Boletini (1927-2007) ishte mjek, Doktor i shkencave mjekësore. Lindi në Shkodër, ku kreu mësimet e para dhe mbaron gjimnazin e shtetit. Ka luajtur futboll me Vllazninë ku u hoq për efekt biografije sepse nana e tij, Adilja kishte qenë në burg dhe babai, Ademi I vrrarë. Por edhe kur shkoi ushtar luajti me Partizanin. Kur u transferua në Tiranë, për arsye politike nuk iu dha e drejta për të vazhduar studimet universitare dhe punoi si elektrikist në Kombinatin e Tekstileve, në Tiranë. Vazhdon studimet pa shkëputje nga puna në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në degën e Kimisë. Më vonë, me ndihmën e dajës, Prof. Selaudin Bekteshi, arriti të hyjë në Fakultetin e Mjekësisë, ku dhe kreu studimet me sukses. Më 1964 u emërua mjek në Laboratorin Biokimik të Mjekësisë, në Tiranë. Më pas u transferua në Krujë, ku dhe krijoi Laboratorin Biokimik. Nga viti 1972 punoi si drejtues i Laboratorit të Kimisë Klinike në Spitalin Universitar të Pediatrisë, në Tiranë. Për veprimtarinë e tij studimore, shkencore dhe botuese ka marrë gradën “Doktor i Shkencave Mjekësore”. Gjithashtu, veprimtaria e tij akademike është vlerësuar nga Medical College Georgia ku bashkëpunoi me Prof. Dr. Titius H.J.Huisman Regents, Prof Department of Biochemistry and Molecular Biology, ku emërohet efektiv i këtij departamenti me titullin “Reachs Fellou”. Ka shumë studime për Thalasseminë në Shqipëri dhe Europë, duke ndihmuar në lehtësimin e sëmundjes për personat e prekur. Ka qenë i pari që përdori diagnozën prenatale aq të domosdoshme në sëmundjet që prekin zonat mesdhetare. Dr. Boletini ka qenë anëtar i kryesisë së Shoqatës Kombëtare të Mjekësisë, si dhe konsulent për botimet mbi Hemoglobinopatinë në Europë dhe Mesdhe. Gjithashtu ka qenë lektor në disa Universitete të Italisë, anëtar i grupit të DNA-së si dhe ka marrë pjesë në bashkëbisedim në Departamentin e Biologjisë Molekulare të Kolegjit

¹⁰² Për Adile (Bekteshin) Boletinin ka shkruar Fatbardha Saraçi në librin “Saga e dhimbjeve”, Tiranë, 2018 ku ka treguar gjithë vuajtjet e saj se çfare ajo ka kaluar nën torturat komuniste

Medikal, në Augusta (Georgia) SH.B.A. Ai ka bashkëpunuar edhe me Prof. Rossi - Milano-hematolog i njohur në Itali. Punën studimore - shkencore e vazhdoi në shumë vende të botës, deri në fund të jetës së tij. Enisi u martua me **Antonietta Sheldia**, pediatre, vdekur më 2003. Enisi ka dy vajza **Keti e Silva**. **Keti** studioi në Milano dhe është mjeke në spitalin San Raffaele, një ndër më të njohurit në Europë. **Silva** mbaroi liceun artistik në Tiranë e bëri konservatorin në Milano. Qe violiniste në orkestrën Giuseppe Verdi, u njoft me një koleg amerikan, të dy instrumentista në Baltimora USA.

Djali tjetër ishte **Isa Boletini (1929-2014)**. Ai punoi mësues në katundet e Kavajës, pastaj në Tiranë marangoz e filloi sportin si atlet. U bë disa herë kampion e rekordmen dhe mori titullin Mjeshtër Sporti. Mbaroi Institutin e Fiskulturës, punoi mësues e qe arbitër ndërkombëtar i volejbollit. Ai u martua me Adlije Spahia, mësuese, e patën dy fëmijë, **Ardiani** që ka dy djem e **Melisa**, një djalë.

Vajza e tretë FAHRIJE BEKTESHI ULQINAKU (1909-1968)

Edhe Fahrija pati rininë si motrat, ku kulturën iu dha i ati, duke e dërguar në shkollën e Murgeshave. Aty ajo mësoi italishten, mori kulturë të përgjithshme si dhe punë të ndryshme dore. U martua me Qazim Ulqinakun (1900-1978) një nga tregtarët më të njohur jo vetëm në Shkodër. Kur vdiq i ati, nuk i pati lënë ndonjë pasuri. Ai filloi tregtinë që i ri, që i zoti dhe për disa vjetë arriti të jetë nga më të pasurit në Shqipëri.



Fig. 8 Mapoja “Ulqinaku” dhe Vula e Magazinës Ulqinaku, Vllëzërit Sali Mehmeti

Ata patën dy fëmijë: **Lejla Ulqinaku Shehi (1929-2000)** e **Firdeus (1942)**. **Mbas mbarimit të gjimnazit Lejlanë** e caktuan mësuese në fshatin Rrenz 1 vit e pastaj e çuan në Llakatund të Vlorës. Atje shkuan si familje e Qazimi punoi punëtor në fermë. Në Vlorë ishte emëruar edhe dr. Hasan Shehi me të cilin kishin miqësi familjare dhe u martuan e patën një djalë, Ridvanin, i shkëlqyer në shkollë por që e drejta e studimit i doli për veterinari..

Firdeusi mbaroi veterinari, e patën caktuar në fermën e Kotës – Vlorë. Ka vite që me të shoqen Shqipe Vuthi, inxheniere ndërtimi (i ati me origjinë kosovar) e dy fëmijët Gladiola e Ergys janë në Detroid Sh.B.A. ku janë sistemuar.

Vajza e katërt NASIBE BEKTESHI KAZAZI (1915-1982)



Fig 9 Nasibe Bekteshi Kazazi; dhe në foton e dytë me kostum kombëtar

Nasibja bëri shkollën e murgeshave saleziane të “Bijave të Marijes Ndhmëtare”. Pati marrë privatisht si motrat edhe mësimë muzike etj. Qe jashtëzakonisht mirë me mësimë, lexonte e fliste shumë mirë italishten e kishte talent për pikturë e punë dore. Pati marrë prej shkollës fletë lavdërimi dhe një të rëndësishme prej Ministrisë së Jashtme të Italisë.



Fig. 10 Menzione d'onorevole (vleresim nderi) dhënë Nasibe Bekteshit nga Ministria e Jashtme italiane me propozim të shkollës si dhe fletë lavdërimi nga shkolla “Figlie di Maria Ausiliatrice (Bija e Maries Ndhmëtare) dhënë Nasibe Bekteshit



Fig. 11 Medalja e marrë nga Nasibe Bekteshi nga drejtoria e shkollës saleziane “Bijat e Marijes Ndhimëtare

Ajo u martua me Jup Kazazin me 1938. Dy familjet kishin miqësi e baballarët Muharremi e Hasani ishin miq e bashkëluftarë krah në krah kundër malazezve. Qenë çift i lumtur. Nasibja thonte se pamvarësisht si shkoi jeta më vonë, ajo kishte marrë burrin më të mirë që kishte Shqipëria dhe se ai e ka dashtë e respektuar. Ai e ka trajtuar pa superioritet si burrë, kanë pasë konfidencë e diskutonin të gjitha problemet. Jupi njihet e vlerësue si personalitet për veprën e sakrificën për liri e demokraci të vendit tonë. Është Dekoruar me Medaljen e Artë të Shqiponjës më 2017 nga Presidenti i Republikës.

Jupi me vllazër kanë pasë mundësinë me ikë jashtë katër herë prej të cilave dy edhe me familje, por ai që i vendosun me ndejë në Shqipëri e me u përpjekë për liri e demokraci. Nasibja i pati thënë: *“Burrë i dashtun, po rrezikon jetën tande të re e mendo edhe për mue e kryesisht fëmijët”*. Ai i u përgjigj: *“E dashtun grue, po rrezikoj për ty e kryesisht për fëmijët, që të rriten e gëzojnë një Shqipëri të lirë e demokratike*. Me 25 nëntor partia komuniste shpalli dënimin me vdekje të Jupit me 4 vllazër dhe ata morën pushkët e dolën në mal. Nasiben e patën rekomanduar të bënte ndarje **formale** me burrin e pati thënë: *“pranonj të vuaj e burrin që kam pasë nuk e ndaj kurr mbas vdekjes”*

Të nesërmen e vetvrasjes të Jupit, kriminelin i sigurimit Zoj Themeli thirri Nasiben për të pasë kënaqësinë me i komunikue zyrtarisht vdekjen e të shoqit. Ajo me kurajo i tha atij: *“Ju po vritni njerëzit ma të mirë që ka Shqipnia. Ju nuk dini çka bani!”*

Prej 25 nëntorit 1944 ajo nuk e pa ma Jupin. Qe vetëm lajmi për vetvrasjen heroike të tij me 17 shtator 1946 i rrethuar prej komunistave në shtëpinë e dajave Rifat e Shyqyri Kopliku. Ajo pati kurajo e vitet qe i mbetën i kaloi me koken lart, edhe pse i rekomanduan të ndante burrin por ajo nuk pranoi.

Nasiben edhe në v. 1943 fashistët italianë deshën ta internonin në Itali me djalin 2 vjeç megjithese ishte edhe shtatzanë. Kjo për arsye të antifashizmit që kishte treguar Jupi dhe për të cilen ishte dënuar edhe ajo. Nasibja ka ndejë e fshehur tek Qazim Ulqinaku derisa kanë ikë italianët. Ata nuk kanë ditë se ishte shtatzanë, megjithate ishte rasti i parë që do të internonin në Itali grua vetëm me një fëmijë Por masi u mor vesh atë nuk munden ta internojnë.

Një dimension tjetër i Nasibes ishte edhe sakrifica, guximi dhe mudi i pafalshëm që hoqi duke mbajtur dy kunetërit në burg jo vetëm moralisht por mbrenda mundësive edhe materjalisht të dy kunetrit. Zeneli 18 vjet në burgun e Burrelit e Hamidi 10 vjet, pak në Shkodër, në Burrel, kamp të Maliqit e 23 vjet internim. Vazhdimisht ju shkruante letra. Letrat e saj ishin shumë të bukura dhe kishte aftësi të veçantë e i shkruante letrat si duke folë me tjetrin. Fëmijët i vente rregullisht me “ju shkruet letër axhave”. Zeneli e Hamidi thonin qe letrat i kishin mbajtur edhe më shumë se ushqimet. Zeneli e ka thënë disa herë, se ajo ka qenë konsideruar “*heroina e Burgut të Burrelit*” pse nuk dimë grua tjetër me ndjekë e sakrifikue për dy kunetërit.

Nasibja qe denuar të vuaj si grua e Jup Kazazit e të vuaj persekutimin. Bëri punët më të rënda edhe për burra, si në tulla, në bujqësi në fermë dhe më e lehta qe në zhuga, e rëndë e në prezencë sode kaustike.

Ajo pati dy fëmijë, djalin **Hamza (1941)** e vajzën **Lirije (1943)**. Djali ka qenë ndër nxanësit që e konsideronin të rrallë të gjimnazit të Shkodrës. Kërkoj për vite të tëra t’i jepnin të drejtën e studimit por i thonin se “atij nuk i takonte”. Nuk i jepnin as punë të rëndë si puntor në ndërtim etj. edhe duke ju drejtuar autoriteteve të Shkodrës, por vetëm në fermë. Për fat patën dajë të mbrekullueshëm e me kurajo të jashtëzakonshme si prof. Selaudin Bekteshi.

Djemtë e Hasan Bekteshit ishin **Teofiku dhe Selaudini**, dy intelektualë të shquar që i lanë Shkodrës nder e lavdi,



Fig. 12 TEOFIK BEKTESHI (1905-1965)

Ekonomist. I lindur në Shkodër, shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Kolegjin Saverian të Shkodrës. Vazhdon gjimnazin real të Gracit dhe pas tij kryen Akademinë Tregtare në Vjenë(1924-1927). Më 1928 mbaron fakultetin e Shkencave Ekonomike në Salsburg. Në vitin 1928 jep provimin e doktoratures ne Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike të Universitetit të Strasburgut France (1927-1928).

Gjatë jetës studentore në Austri merr pjesë në shoqërinë “*Albania*” dhe shkruan në revistën “*Djalëria*”. Veprimtaria e tij në Shkodër fillon më 1929, kur në zgjedhjet bashkiake zgjidhet anëtar i Këshillit , duke kontribuar aktivisht në jetën ekonomike, kulturore dhe sportive të qytetit të Shkodrës. Zgjidhet kryetar i Bashkisë së Elbasanit (1942-1943); ishte anëtar i këshillit të shtetit. Është marrë me studime ekonomike sidomos në fushën e politikës agrare. Më 1946 i dorëzon një prememorje proteste gjeneralit anglez Hodgson, në emër të opozitës intelektuale shkodrane për të cilën arrestohet dhe dënohet me 5 vite burg dhe pas daljes nga burgu përsëri persekutohet dhe internohet 5 vite në Kuç të Vlorës, por që lirohet pas një viti e gjysëm.

Për kontributin e tij në drejtimin e qytetit të Elbasanit, i jepet në vitin 1998 titulli “Qytetar Nderi i Elbasanit”. Ka qenë i martuar me Lumni Pipen, (vdekur më 2007) një ndër bijat e farmacistit Seit Pipa të emëruar me punë në Shkodër, e që vinte nga një familje e shquar libohovite. Lumnija kishte mbaruar me rezultate të shkëlqyera Institutin Femëror “Nana Mbretëreshe” dhe në vitin 1947 ishte punësuar në Ndërmarrjen Shtetërore të Botimeve në Tiranë, në sektorin e përkthimeve të gjuhës frenge, për t’u pushuar shumë shpejt me motivacionin “*Për qëndrim te keq politik ndaj Pushtetit*” si rezultat i dënimit të Teofikut

Ka patur një djalë Hasan Bekteshi (familjarisht i thirrur Hans) që mbas mbarimit të studimeve të larta dhe diplomimit inxhiner elektrik, ka punuar në disa rrethe të Shqipërisë, kryesisht në sektorin e industrisë minerare, e më vonë në disa institucione e dikastere qendrore.

I martuar me Irmen, mjeke psikiatre dhe pedagoge në Fakultetin e Mjekësisë. Kanë nje djale, Juri, që mbas përfundimit të studimeve në universitetet prestigjoze te ekonomisë, “Bocconi” ne Milano dhe “London School of Economist” në Londër, punon në sektorin bankar të Londrës.



Fig. 13 SELAHEDIN BEKTESHI (1917-2003)

Mjek peditër, profesor, akademik, themelues i hematologjisë peditrike në Shqipëri. I lindur në Shkodër, kreu Kolegjin Saveriane. Ndoqi studimet e larta dhe u specializua për peditri në Torino (1937-1944). Ishte një nga mjekët që institucionalizoi shërbimin peditrik. Konsiderohet themeluesi i hematologjisë në vendin. Nga 1945-1948, ishte përgjegjës i sektorit të Mbrojtjes së Shëndetit të nënës dhe fëmijës në Ministrinë e Shëndetësisë, përgjegjës i pavionit të peditrisë në Spitalin Civil të Tiranës (1948-1960), drejtor i Spitalit të Peditrisë në Tiranë (1960-1969). Ndërkohë që përgjegjës i klinikës universitare të peditrisë (1956) dhe përgjegjës i katedrës së peditrisë në Fakultetin e Mjekësisë të UT (1959-1988). Është ndër 10 të parët që morën titullin profesor, dhe ndër dy mjekët e parë në krijimin e Akademisë së Shkencave. Ka lënë qindra artikuj shkencorë, tekste, monografi, duke përdorur dhe një gjuhë të thjeshtë për pacientët e tij dhe familjet e tyre. Ka qenë i pari studiues në Shqipëri që ka shkruar për gjenetikën në revisten “Shëndeti”. Është kjo arsyeja që Akademia e Shkencave të Shqipërisë u përfaqësua me studimet e prof. Bektshit në Kongresin Ndërkombëtar të Gjenetikës që u zhvillua në Rodos të Greqisë. Ka qenë i ftuar disa herë në kongreset ndërkombëtare të peditrisë në Itali ku ka referuar tema studimore shkencore. Me shumë vlerë praktike, i kërkuar edhe në ditët e sotme, është libri “Fëmija ynë”, që fillon me këshillat e udhëzimet qysh para lindjes për nënën e me rritjen e fëmijës. Ka punuar për luftimin e sëmundjes së fruthit në Shqipëri gjë që e ka paraqitur në monografinë “Fruthi” (1974) . Si rezultat edhe i punës së tij impenjative, për fruthin, Shqipëria është prej vendeve të parë në botë që eliminuan fruthin. Botoi monografitë “Puerikultura”, (1948), “Probleme të demografisë në Shqipëri” (1960), tekstin “Peditria” (1974, dy vëllime). Ka punuar me seriozitet dhe humanizëm për përgatitjen e mjekëve të Spitalit Peditrik të Tiranës. Ka marrë Çmimin e Republikës së shkallës së parë. Spitali i Fëmijëve pranë Qendrës Spitalore "Nënë Tereza" mban emrin e tij. .

Një dimension tjetër i Prof. S. Bektshit ishte solidariteti i tij human për të ndihmuar dy motrat Adilen dhe Nasiben dhe fëmijët e tyre por edhe fëmijët e të vëllaut Teofikut mbas persekutimit komunist që pësuan familjet dhe bashkëshortet e tyre . Prej tij shpëtuan fëmijëte Nasibes dhe Jup Kazazit: Hamzai dhe Lirija fëmijët e Adiles dhe Adem Boletinit, si Enis e Isa Boletini që arriti edhe të ju mbylli çështjen e biografisë si nipat e heroit Isa Boletini, deri sa shkoi çështja tek “diktatori”. Jeta e tyre shkoi mirë. Po ashtu Hasanit, djali i Teofikut, që mbaroi e punoi si inxhener elektrik.

Ai me një guxim të rrallë për kohën e diktaturës, që mund ti rrezikonte karrieren por me një dashuri dhe mirësi për gjakun e tij, i mori pranë familjes së tij në Tiranë, i mbrojti, i ndihmoi për t'u sistemuar, i punësoi fëmijët e tyre dhe u ndejti pranë në momentet më të vështira të

jetës. Kjo qe një gja shumë e rrallë dhe një shembull i lartë njerzor dhe human që bëri vëllau për motren . Asht thanë në tregimet tona popullore por edhe në eksperiencat e jetës që cfarë ban motra për vëllanë por rasti i prof. Selaudinit tregoi cfarë ban vëllau për motren kur në shpirtin e tij është rrënjosë dashuria njerëzore për familjen, sakrifica, guximi dhe perkushtimi i tij për familjen..

Selahedini u martua me Eftali Papa, nga Vlora, me profesion mësuese. Patën tre fëmijë. I madhi **Erald** (1969) mbaroi mjekësi në Tiranë ku u caktua në psikiatri-nevrologji, U martua me një angleze dhe sot ndodhet në Londer ku kanë dy fëmijë. I dyti **Mervil** (1970-2000) ka vdekë 30 vjeç me arrest kardiak. I treti **Edgar** (1972), mbaroi mjekësi dhe sot jeton me bashkëshorten në Phoenix – Arizona (Amerikë)

▪Filateli▪

Besnik FISHTA

Qarkullimet postare në kampet fashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore

Qëllimin ekspansionist për krijimin e “Italisë së madhe” edhe në drejtim të Ballkanit, fashizmi italian e filloi para Luftës së Dytë Botërore me sulmin ndaj Shqipërisë, më 7 prill 1939. Në logjikën fashiste, objektivi ishte që Italia të rifitonte hegjemoninë në Mesdhe, të cilën e pat humbur që nga rënia e Perandorisë Romake (Fig.1 dhe 2). Por italianët e kuptuan shpejt se popullsia në këto vende nuk do të pajtohej me këto aneksime. Me veprime urgjente do t’iu duhej të izolonin kundërshtarët politikë, kryesisht nga grupe të tilla si nacionalistë, komunistë dhe hebregj. Këtij qëllimi do t’i shërbente edhe ndërtimi me shpejtësi i kampeve të internimit brenda territoreve të pushtuara. Sipas projektit fashist këto kampe do të shërbenin edhe si pikë tranziti për një moment të dytë për internimin akoma më të largët përtej Adriatikut. Vendndodhja në Porto Romano vetëm 5 km në veri të qytetit të Durrësit, nga regjimi fashist italian shënohet si territori më strategjik, pasi aty do të ishte e pamundur çdo përpjekje për t’u arratisur nga brenda apo tentativë e armatosur për të liruar të internuarit nga jashtë. Kampi fashist në Porto Romano kufizohej nga ana perëndimore me detin me një mur 3 metër të lartë dhe gjatësi 250 metra. Në pjesën ku kampi kufizohej nga rruga e cila e lidhte me Durrësin u rrethua me gardhe me tela me gjemba. Në pjesët e tjera arratisja ishte e pamundur, pasi kodra kishte një rrëpirë të fortë që përfundonte në det. Brenda territorit u ndërtuan fortifikime dhe kulla të larta vrojtimi të pajisura me mitraloz e me projektor ndriçimi për tërë natën. Gjithçka brenda kampit vrojtohej nga OVRA-s, spiunazhi italian, që kishte agjentët e tij, madje edhe në radhët e të internuarve. Ende sot, në atë vend gjenden pamje rudimentare me mure të lartë, kulla rojesh, fortifikime, kapanone, qeli etj. Ato qëndrojnë si dëshmi e ekzistencës së atij që historia e njeh si kampin më të madh shumëkombësh ballkanik me mbi 1200 të internuar shqiptarë (përfshirë dhe ata të territorit kosovar), malazezë, serbë, boshnjakë, kroatë, maqedonas dhe grekë. Nëpërmjet publicistikës, librave, kujtimeve e deri dhe filma artistik janë treguar ngjarje nga ferri i vërtetë i këtij kampi famëkeq fashist (Fig 3, 4, 5 dhe 6). Kampi i Porto Romanos u mbyll me 25 korrik 1943, në prag të kapitullimit të Italisë fashiste.

Sot, ky vend i mbuluar nga shkurret dhe e ferrat është lënë në harresë. Këtu të vetmit vizitorë janë zogjtë apo edhe kafshët e tjera të egra. Megjithëse i vlerësuar si monument me

rëndësi të veçantë i Rezistences antifashiste ballkanike, mungesa e vëmendjes së institucioneve që lidhen me trashëgiminë historike është e dukshme (Fig 7). Në të kundërt të kësaj situatë, aty do të mund të imagjinohej një panoramë e ndjeshme me efekt edukativ, patriotik dhe mjaft i kërkuar për udhërrëfyesit turistikë.



Fig 1. Kufizuar me portokalli tregon kufirin e territoreve të “Italisë së Madhe” në brigjet e Mesdheut dhe me të gjelbër, të gjitha territoret e pushtuara nga Italia gjatë Luftës së Dytë Botërore.



Fig.2 “Shqiperia e madhe” nën protektoratin fashist(1943).



Fig.3 Roman i shkruar nga një ish i internuar, pasqyron ngjarjet në kampin fashist Porto Romano.



Fig.4 Skenë nga filmi i Kinostudios Shqipëria e re (1980), “Skëterrë ‘43”. Subjekti i filmit pasqyron ngjarjet në kampin e Porto Romanos.



Fig.5 Një fletë e gazetës së të internuarve që qarkullonte fshehurazi në kamp.



Fig.6 Dorëshkrime të kujtimeve nga ish i internuari Idris Fishta.



Fig.7 Pamja e pjesshme sot e ish Kampit fashist të përqëndrimit Porto Romano, Durrës.

Parashkrimi mësipër i rrethanave historike që lidhen me kampet fashiste të internimit, do të ketë pasqyrim në kohë reale, të drejtëpërdrejtë dhe të saktë, natyrisht, nëpërmjet dokumentacionit që ofron edhe historia postare. Duhet pohuar që në studimet e filatelistë shqiptare, pavarësisht zhvillimeve të vrullshme të saj gjatë viteve të fundit, nuk e kanë prekur deri më tani, qoftë dhe perciptazi këtë tematikë. Pavarësisht ekzistencës së një regjimi të egër fashist, ligjet italiane të kohës “i lejonin” komunikimet postare të lidhura me kampet e përqendrimit. Lejohej pa kufizim qarkullimi i artikujve filatelike vetëm brenda territoreve të Perandorisë së shpallur fashiste si në Itali, Shqipëri, Etiopi, Tunizi, Libi, Mbretërinë e Malit të Zi dhe pjesërisht në Kroaci. Kjo liri në qarkullimin e letrave ishte shprehur si garanci për robërit dhe të internuarit e luftës të parashikuara nga Konventa e Gjenevës e vitit 1929, por që do të nëpërkëmbej në shumicën e herës nga fuqitë nazi-fashiste.

Në rastin e territoreve shqiptare, për Kampin e Përqendrimit Fashist te Porto Romanos kemi një korrespondencë të ruajtur shumë mirë me Kartë postare dhe Karta letër të qarkulluar gjatë vitit 1943 deri më 8 shtator të po këtij viti, që përkon me kapitullimin e Italisë fashiste (Fig.8 dhe 9). Hulumtimi i kësaj korrespondence natyrisht shoqërohet me ndjesi emocionale që lindin nëpërmjet historive familjare të lidhura me to. Por veçmas kësaj janë dhe emocionet e kënaqësisë së interesit studimor dhe interpretativ të veçantive filatelike të tyre.



Fig.8 Karta postare dhe Karta letër të qarkulluara gjatë vitit 1943 ne kampet fashiste italjane.




Fig.9 Pjesa prapme e kartave të lexueshme gjatë qarkullimit postar.

Duke marrë në studim dhe vlerësuar veçoritë në këto karta postare dhe karta letër, fillimisht bëjmë një ndarje në dy grupe. Kjo ndarje do të përcaktojë dhe disa ndryshime thelbësore mes tyre.

Në grupin e parë do të veçojmë kartat postare që kanë qarkulluar në kahen nga të internuarit për në destinacione jashtë kampit të përqëndrimit. Mesa njihet deri më tani, këto duket se janë jashtëzakonisht të rralla dhe të papara në koleksione apo në literature filatelike. Këto karta postare të prodhuara në Itali ishin të dedikuara të përdoren vetëm nga forcat ushtarake dhe kishin përshkrimin: "Cartoline postale per le forze armate". Çdo njëra prej tyre shoqërohej në pjesën e sipërme të kartës me një shprehje fashiste propogandistike të Musolinit. Ky tip kartash qarkullonte vetëm nëpërmjet postës ushtarake dhe, në asnjë rast nuk ka afrankim me një pullë poste. Vula e postës ushtarake ishte rrethore në mesin e së cilës shënohej data e vulës dhe, buzë perimetrit rrethor të saj, shkruhej "Posta Militare 402" (Fig.10). Posta ushtarake me numër 402 filloi si zyrë për shërbimet territoriale në repartet ushtarake të Marinës dhe

Aviacionit italian në zonën e Durrësit që më 10.04.1939 dhe u mbyll me kapitullimin e Italisë fashiste. Kartat postare të të internuarve, çdo rast, merrnin vulën e çensurës së vetë kampit të përqëndrimit. Kjo vulë me konture drejtkëndëshi kishte brenda saj përshkrimin: "Verificato per censura campo "O" P.M. 402". Simboli "O" nënkuptonte shkronjën e parë të fjalës italisht "Ostaggio", e cila në gjuhën shqipe është e barasvlefshme me fjalën "Peng". Simbolet e shkronjave P. M. janë shkurtime të shprehjes italisht "Posto Militare". Të gjitha vulat janë me ngjyrë të zezë (Fig.11 dhe 12).




Fig.10 Vula e postës ushtarake e kampit të përqëndrimit.



Fig.11 Vula e postës ushtarake shoqërohej me vulën e e çensurës ushtarake të kampit të përqëndrimit.



Fig.12 Kartë e qarkulluar nga Porto Romano për në qytetin Shkodër.

Në tipin e dytë përfshihen karta postare jo ushtarake dhe karta letër, të cilat kanë qarkulluar vetëm në kahen nga jashtë kampit për brenda tij, dhe me përshkrim të të dhënave të tyre në gjuhën shqipe (Fig.13).

Edhe këto karta postare kanë rrallësi të lartë, me qenë se një e vetme është parë deri më tani në ekspozimet tona. Afrankimi tek këto kryhet nëpërmjet postës civile me një pullë poste me tarifë 10 qindarka (Fig.14), dhe në rastin e Kartës letër vlera e pullës është 15 qindarka në përputhje me afrankimin e këtij artikulli postar brenda vendit (Fig.15). Ky tip dallohet nga tipi i parë, sepse ato marrin dy vula çensure. Së pari vulën e çensurës civile sipas shënimit “Verificato per censura” dhe, më pas në momentin e hyrjes në kampin e përqëndrimit, marrin vulën e dytë, atë të censurës ushtarake të vetë kampit (Fig.15). Veçmas vulosjes dyfishte nga censura, në kartë postare kemi dhe një vulë te vogël rrethore brenda së cilës vendosej numri censurës civile (Fig.16). Ngjyra e vulave ndryshon duke qenë më së shumti e zezë dhe më rrallë blu.



Fig.13 Kartë postare e qarkulluar nga qyteti Prizrenit në Kampin Porto Romano, Durrës.



Fig.14 Kartë postare e qarkulluar nga Prizreni për në Porto Romano.



Fig.15 Kartë letër e udhëtuar nga qyteti Prizren për Porto Romano.



Fig.16 Vula e vogël me numrin 4 të çensurës civile.

Në përfundim duhet të nënvizohet që studimi i kësaj tematike të historisë sonë postare është e nevojshme të zgjerohet, sepse lindin disa pyetje që e nxisin kërkimin e mëtejshëm. Këto pyetje mund të jenë:

1.A ekziston një qarkullim i tillë produktesh filatelike edhe në të tjera kampe fashiste italiane brenda territorit shqiptar?

2.A ka një qarkullim postar të ngjashëm edhe në kampet gjermane të internimit?

Këto dhe pyetje të tjera dhe, sidomos gjetja e analiza e dokumentacionit arkivor përkatës do të bënte të mundur të arrihet të plotësohet pjesa e munguar e historisë sonë postare, që lidhet me qarkullimet postare në kampet fashiste të përqendrimit.

Shënim.

1. Çdo e dhënë më sipër, në lidhje me kampin fashist Porto Romano dhe rrethanat përkatëse historike, mbështeten në dorëshkrimet e ish të internuarit Idris Fishta.

2. Ilustrimet e kartave janë pjesë e koleksioneve filatelike të familjes "Fishta".

▪ Recension ▪

Gjovalin ÇUNI

Gulielm Pistulli, “Gjuhadoli. Pjesë e randësishme e qytetit të Shkodrës” (bot.II)

Gulielm Pistulli, autori i librit ishte një emër i njoftun jo vetëm në Gjuhadol por dhe në ambientet diturake të qytetit. Ai ishte një punëtor i zellshëm në fushën e dijeve filologjike dhe në atë të përkthimeve me tematikë historike, të lëna në dorëshkrim.

Në pjesën më të madhe të jetës ai dhe motra e tij Margerita Çeka (Pistulli) u gjendën pranë nxanësve të cilëve ju përkushtue tanësisht, si mësues e drejtues shkollash, e mbas daljes në pension në vitin 1982, ai mendoi, që prap mundet me kenë i dobishëm.

Plot me energji ju vu punës me hjedhë në letër ditunitë e fitueme, me ja lanë, si trashëgimi e dije të tjerëve. Fillimisht i daktilografuem, e më vonë shtypun në vitin 2006, në vitin 2023, libri: “Gjuhadoli. Pjesë e rëndësishme e qytetit të Shkodres: Historik i shkurtë”, u ribotue.

Duhet me thanë që problematika e trajtueme prej Gulielmit ka ekzistue edhe më parë. Njerëz të njoftun e të vlerësue edhe prej tij, ishin mundue me bërë ekskursionë njohëse të qytetit, e lagjeve të veçanta, por çdo gjë kishte mbetur e ndrydhun në faqe fletorësh, me kopertina zakonisht të forta e të trasha, që ruheshin me fanatizëm ndër sirtare nga hartuesit, aq sa për ndonji mendohej, se shënimet kishin edhe humbur, me kalimin e tyre në amshim.

Gjithsesi fermenti i gjatë personal, bazue në të dhana të llojeve të ndryshme, bisedat me kushrini, motrën e pleqtë e Gjuhadolit, e ndihmuan atë, me në dhanë një libër mjaft interesant, krejt të veçantë në llojin e tij, mjaft të vlerësue jo vetëm në Shkodër, por edhe më gjerë. Kujtoj se kjo është dora e tretë e botimit, dy të parat siç thohet në Shkodër “*ikën si pa u ndie*”. E nuk ka si të ndodhte ndryshe. Autori me këtë libër ishte i vetdijshëm se po lente “*testamentin e vet shpirtnuer*”, tek kalonte, siç shkruante edhe vetë ai, *vjetët e fundit, të jetës*.

I lidhun fort me lagjen ku kishte lindë e jetonte, Gulielmi me këtë libër, i bani shërbimin më të mirë Gjuhadolit tuj e perjetësue totalisht me gjithshka që ndodhet në tokë, e nëntokë, me gjana të pashpirta por që flasin, me histori jetësh, më së pari njerëzish të thjeshtë, punëtorë zanatçij që punojshin e pijshin ndonji gotë raki në mejhanet e shumta të lagjes, e me shtëpijake, zota shpije që rritshin fëmijë, gatuejshin, e punonin në tezgjah; me klerikë e njerëz

të pasun e të rëndësishëm, që nën pendën e Gulielmit barazoheshin me të tjerët, me titullin më të naltë të krijuem nga ai: “*banorë të lagjes*”.

Përpyjekjet me evidentue me imtësi tanë lagjen, me depërtue në çdo ambient e botë shpirtnore, autori e quante, « *autencitet që i përgjigjet së vertetës* », ndërsa lexuesi që e merr përduersh librin, mundet me e vlerësue si “*sprovë e parë*”, e një lloji të veçantë të shkrimit letrar, një narrativë e vështirë me u përcaktues saktësisht, në etnografi, etnologji në studime sociale, kulturore e fetare.

Zanë vend të randësishëm në libër *historia e krijimit të shoqatave të mirëfillta shkencore*, si klubi “*Gjuha e Shqipe*”, e vitit 1908 e riorganizime me 8 shkurt 1912, e cila qëllim kryesor pati, “*të mësuemit e gjuhës shqipe*” e të botuemit e librave në shtypshkronjën Nikaj, që ndodhej aty ; “*t’çlunit e t’mbajtunit e një saloni leximi*”, që tuj ju referue prof. Aurel Plasarit, ishte përpjekja e parë për krijimin e një biblioteke publike. Libri është i mbushun me të dhana personale të njerëzve diturakë, që me veprimtarinë e tyre fetare, politike, shkencore, letrare, artistike, karrierën ushtarake dhe diplomatike, por edhe me hobitë e tyre, si filatelist, muzikantë e sportista lanë gjurmë edhe në historinë kombëtare.

Vargu i tyre është mjaft i gjatë, e të ndertit lexues i këshilloj t’u njohin përmes leximit të librit. Tuj kërkue mirëkuptim, po ceku vetëm disa sýnesh, si Filip Kraja, Luigj Gurakuqi, Dom Ndoc Nikaj, Dom Ndre Mjeda, Atë Gjergj Fishta, Mati Logorecin, Cuk Simonin, Ernest Koliqin, Kardinal Mikel Koliqia, Kolë Idromeno, Gjush Sheldia, Kolë Gurashia etj.

Një tjetër histori identitare, tregues i përparimit në kohë të Gjuhadolit, ishte edhe prania shoqërive kulturore-sportive, krahas atyne të karakterit shkencor të krijueme mbi bazën e traditës të hershme të banorëve të kësaj lagje, në ahengjet e festave familjare e fetare, në shfaqjet teatrale të fillueme në skenat e improvizueme të oborreve, e deri te përpjekjet e para për organizime shoqërore fillimisht minore, e më vonë me krijimin e shoqënieve të mëdha kulturore me statute, rregullore e antarësim, si në tanë vendet e Europës, siç ishin shoqnia Antoniane, Rozafat, Bijat e Zojës etj.

Krijimi i këtyne shoqënieve është një histori kontributesh të mëdha njerëzore, të amatorëve të shumtë, që ishin thujse në t’ana shpijat gjuhadolase. Ata ishin të mbajtura, jo vetëm prej klerit, por edhe prej disa familjeve të kamuna shkodrane, që cilësoheshin në atë kohë “gerant gjegjës”. Në shërbim të këtyne shoqënieve kanë kenë 2 salone, ai i Françeskanëve të Gjuhadolit me 300 vende, dhe motrave Stigmatine 250 vende, e pak më tej k’atë kenë edhe saloni i Rozafatit me 300 vende.

Gulielmi, qysh në të gjallët e tij ishte i bindun se të tjera sprova shkrimore për Gjuhadolin kishin me ardhë mbas librit të tij. Dhe kështu ndodhi, por ai nuk shqetësohej,

përkundrazi, pa kurrfarë xhelozie inkurajonte të tjerët, tuj i nxitë edhe me e korrigjue apo edhe për me saktësue ndonjë gjâ që atij mund t'i kishte ikë.

Libri i Pistullit cilësohet pa dyshim libër retrospektiv. Nga ana strukturore libri paraqitet me pak kapituj kryesor, dhe me mjaft nënkapituj të vegjël, të një bote në të cilën jetonte ajka e shoqënisë shkodrane e lëvizte ajka e shoqënisë shqiptare. Fatkeqësisht në ditët e sotme, pak nga mosdija, pak nga mosinteresimi, shumë edhe nga emigrimi, Gjuhadoli nuk është më ai i kohës së Gulielmit, ndaj ribotimi i këtij libri, por edhe publikimi pjesë-pjesë në rrjetet sociale, siç asht tuj bâ, është një mënyrë që kjo zonë, siç vëren Stefan Çapaliku, *të mos humbin ma tej identitetin*.

Libri, nëse prerifrazojmë Koliqin, asht: *“histori me drita dhe hije që vlen të njifet per me lidhë stinë me stinë, breznin me brezni”*.

Ofshama e grues të lodhun, e ardhun nga shtëpiat pranë Kalasë *“Oh, më duel g'juha me ardhë deri këtu”*, është dëshmi për një gjëndje të caktueme. Ishte ofshma që sipas gojëdhanave i dha emnin lagjes, qysh prej fundit të shekullit XVIII, e më vonë kjo lagje e qytetit kishte me pasë emertesa të tjera, kryesisht personazhesh perandorake e politikanësh të huej, si Franz Ferdinandi, Justin Godar, për me vijue me emnin e dëshmorit Branko Kadija, e për me u kthye në ditët e sodit me emnin e thjeshtë, të shekujve më parë.

Gjuhadoli, na tregon autori, nuk asht rruga e pak a shumë e drejtë, që fillon nga Serreqi deri te rruga e Dugajëve të reja. Gjuhadoli, përmbledh një varg rrugicash të drejta e gjarpnueshe, dredhina e qoshke, mure të nalta; oborret me lule e kopshtijet, kullat e sanës, pusi e kova, lugu e pirajka, oxhakët e guzhinat, deri te *“drita e ngjyrave të jetës”*, brandavekë e fes tanuza, japanxhe e dergermi.

Mendja e secilit shkon edhe te shtëpi që gumëzhitshin *“tanë ditën e lume”*. Te rezet e dyerve që pritshin ardhjen e burrave prej Pazarit, e të fëmijëve prej shkollave, të kushërijve për emna e festa fetare e kombëtare (*të shpërndamë tashma në katër anët e Botës*), e ma pas të zaneve metalike të grave që bërtitshnin nga thëllësitë e guzhinave: *“Lepe, e kush je?”*

Librat e Gulielmit Pistullit, Alfred e Stefan Çapalikut, Gjovalin Stefës, të Gjush Sheldisë, Cuk Simonit e Simon Rrotës etj., të bëjnë me kuptue se është detýra e secilit prej nesh me shkruë, së paku ndonji rrjesht për ata kohë të kalueme, gjithnji tuj mbajtë parasysh, *“që të mos guxohet të thuhet diçka e rrejshme, por edhe mos të guxohet të heshtet e verteta”* Libri i marrun në një shikim analitik, është siç e shkruajti Gulielm Pistulli, i kalon caqet e një studimi pjesor të një lagjeje. Ai pa dyshim mund të cilësohet një pjesë e *“biografisë së qytetit”*.

